BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI ZYRTAR

vëllimi 10 numër 10 dhjetor 2008

Data e botimit 20.01.2009

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 84, datë 11.12. 2008 "Për miratimin e përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 87, datë 24.12.2008 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes" 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 88, datë 24.12.2008 "Për miratimin e Dokumentit të Politikës Monetare për periudhën 2009 -2011" 7
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 24.12.2008 "Për publikimin e dokumentit të vrojtimeve të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve" 8
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 91, datë 24.12.2008 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare"" 9
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 92, datë 24.12. 2008 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e një veprimtarie financiare shtesë nga banka Credins sh.a.." 24
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 93, datë 24.12. 2008 "Për dhënien e miratimit paraprak për transferimin (ndryshimin) e pjesëmarrjes influencuese në kapitalin aksioner të Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a., nga Z. Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese S.c.p.a tek Veneto banca Holding S.c.p.a" 25
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 94, datë 24.12. 2008 "Për dhënien e Miratimit paraprak për rritjen e përqindjes të pjesëmarrjes influencuese të aksionerit Aleksandër Pilo në kapitalin aksioner të Bankës Credins sh.a." 26
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 95, datë 24.12. 2008 "Për miratimin e metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare " 27
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 97, datë 24.12. 2008 "Për një ndryshim në rregulloren "Për kredinë njëditore"" 186

11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 1, Janar 2008 187
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 2, Mars 2008 187
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 3, Prill 2008 188
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 4, Prill 2008 188
15. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 5, Qershor 2008 188
16. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 6, Korrik 2008 188
17. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 7, Tetor 2008 189
18. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 8, Tetor 2008 190
19. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 10, Numër 9, Nëntor 2008 190

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 84, datë 11.12. 2008

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT NGA BANKAT TË REZERVËS SË DETYRUAR NË LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, nenit 20, nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; të nenit 11, pika 2 të rregullores "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat" miratuar me vendimin nr. 43, datë.16.07.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të lejojë bankat dhe degët e bankave të huaja të përdorin çdo ditë, deri në 40 (dyzet) për qind të shumës së rezervës së detyruar në lekë.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin menjëherë të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 44, datë 16.07.2008 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 24.01.2009.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 87, datë 24.12.2008

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 6, 25 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta).

2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 88, datë 24.12.2008

PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR PERIUDHËN 2009 -2011

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Dokumentin e Politikës Monetare për periudhën 2009 - 2011", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare dhe strukturat e tjera të Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin dhe për dërgimin e kësaj deklarate në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet e tjera përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 90, datë 24.12.2008

PËR
PUBLIKIMIN E DOKUMENTIT TË VROJTIMEVE TË BESIMIT TË BIZNESEVE DHE TË KONSUMATORËVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; bazuar në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë publikimin çdo 3 (tre) muaj të Dokumentit të Vrojtimeve të Besimit të Biznesit dhe atij të Konsumatorit.

2. Të miratojë publikimin e serive kohore, shpjegimeve metodologjike, kalendarit të publikimit dhe pyetësorëve të Vrojtimit të Besimit të Biznesit dhe Vrojtimit të Besimit të Konsumatorit.

3. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 91, datë 24.12.2008

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË TË MJEDISEVE NË TË CILAT KRYHEN VEPRIMTARITË BANKARE DHE FINANCIARE"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja"c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sigurimit dhe të Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, udhëzimi "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës të subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 102, datë 28.12.2005, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

RREGULLORE

"PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË TË MJEDISEVE NË TË CILAT KRYHEN VEPRIMTARITË BANKARE DHE FINANCIARE"

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave minimale për kushtet teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare nga subjektet e kësaj rregulloreje, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 70, pika 1 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të neneve 57 pika 2, 58 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja, zyrat e këmbimit valutor, subjektet financiare jobanka që kryejnë veprimtari me sportel, si edhe agjentët e tyre.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "kushte teknike dhe të sigurisë" janë:

i. kushtet për mbrojtjen e paprekshmërisë fizike, për mbrojtjen me personel dhe mbrojtjen elektronike të mjediseve ku zhvillon veprimtarinë subjekti, si dhe mbrojtjen e personave që i përdorin këto mjedise,
ii. kushtet për mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; si dhe
iii. kushtet për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë operacionale të subjektit;

b) "zona e arkëtarëve" - është ambienti i subjektit, i cili shërben si vendqëndrim i arkëtarëve;

c) "sportel" - është vendi në ambientet e subjektit, ku klientët komunikojnë me zonën e arkëtarëve, për derdhje të hollash, tërheqje të hollash, këmbim valutor etj.;

d) "superbanak" - është një pjesë e ngritur mbi lartësinë e tavolinës, në mënyrë që të bëjë të mundur krijimin e një distance sigurie midis klientit dhe arkëtarit të bankës;

e) server – është një pajisje qendrore informatike;

f) ATM (Automated Teller Machine) - është një pajisje elektromekanike, e cila bën të mundur tërheqjen ose depozitimin e parasë *cash*, pagesa të shërbimeve, transferim fondesh ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie etj.. ATM operojnë si në regjim *online*, ku baza e të dhënave aksesohet në kohë reale, ashtu edhe në regjim *offline*.

g) DVR- është pajisje e veçantë dixhitale për regjistrimin e imazheve të përftuara nga telekamera;

h) "sigurimi i jashtëm" - është shërbimi që realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" si edhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij;

i) "sigurimi i brendshëm" - është shërbimi që kryhet nga punonjësit e sigurimit të brendshëm të bankës ose degës së bankës së huaj, ose nga punonjësit e SHRSF-së;

j) SHRSF - (Shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike) - është shoqëria e krijuar, e licencuar dhe që funksionon sipas kërkesave të ligjit nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar.

KREU II
KËRKESAT PËR KUSHTET TEKNIKE DHE TË SIGURISË PËR BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

Neni 5
Procedurat dhe aktet e brendshme

1. Banka ose dega e bankës së huaj harton dhe miraton procedura për kushtet teknike dhe të sigurisë, të cilat minimalisht, duhet të përfshijnë:

a) procedurat e realizimit të mbrojtjes së ambienteve të saj;
b) procedurën dhe standardet e përzgjedhjes së ambienteve ku vendoset, për të kryer veprimtarinë si dhe sigurimin e tyre;
c) mënyrën e ruajtjes me anë të personelit dhe me anë të pajisjeve elektronike të sigurisë, të administrimit të vlerave monetare fizike dhe të sigurimit të këtyre vlerave;
d) marrëdhëniet me institucione dhe subjekte të tjera, për plotësimin e kuadrit të mbrojtjes së ambienteve;
e) njësitë përgjegjëse për realizimin e këtyre procedurave dhe mënyrën e veprimit të tyre, në kushte normale dhe në raste të thyerjes së kushteve të sigurisë si dhe mënyrën e bashkëveprimit mes tyre;
f) procedurat e administrimit të vlerave monetare;
g) procedurat për transportimin fizik të vlerave monetare;
h) procedurat e veprimit në mjediset e administrimit të vlerave monetare dhe në dhomën e serverave;
i) procedurat e administrimit të dokumentacionit që lidhet me mbrojtjen e veprimtarisë;
j) personat përgjegjës, linjat e raportimit dhe të njoftimit si edhe procedurat e kryerjes së kontrolleve periodike.

2. Banka ose dega e bankës së huaj, në strukturën e saj organizative përcakton një njësi të veçantë për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e procedurave për kushtet teknike dhe të sigurisë.

3. Në degët dhe agjencitë bankare caktohet një punonjës, përgjegjës për zbatimin e kushteve teknike dhe të sigurisë.

4. Politikat, procedurat dhe aktet e ndryshme, të miratuara në fushën e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë, janë pjesë e programit/ve njohëse dhe të trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve të bankës ose degës së bankës së huaj.

5. Banka ose dega e bankës së huaj, rishikon në mënyrë periodike dhe përditëson procedurat për kushtet teknike dhe të sigurisë.

Neni 6
Kërkesa të përgjithshme teknike për mjediset e punës së bankës dhe degës së bankës së huaj

1. Banka ose dega e bankës së huaj, ushtron aktivitetin në ambiente, të cilat plotësojnë parametrat e mëposhtëm:

a) të jenë të sigurta nga ndërhyrjet e paautorizuara në të gjithë perimetrin dhe sipërfaqen e tyre të jashtme;
b) të jenë lehtësisht të arritshme nga njësitë e specializuara të sigurisë dhe të mbrojtjes, në raste të mosrespektimit të rregullave të sigurisë fizike ose në raste të rënies së zjarrit;
c) të ofrojnë kushtet e nevojshme të hapësirës, të temperaturës, të dritës dhe të lagështisë për punonjësit, për klientët, për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe të vlerave monetare fizike;
d) në sipërfaqen e brendshme të jenë qartësisht të ndara:

i. zona e pritjes së klientit,
ii. zona e arkëtarëve,
iii. zona e administrimit dhe e ruajtjes së vlerave monetare fizike (dhoma kasafortë, ambientet ku përpunohet *cash*-i etj.),
iv. zona ku është vendosur personeli;

e) të jenë të pajisura, në varësi të sipërfaqeve, me hidrantë dhe materiale të tjera ndihmuese ose me fikëse zjarri;

f) të jenë të pajisura me një burim të dytë, të vazhdueshëm të energjisë elektrike (si motorgjeneratorë, inverter ose burime të tjera alternative energjie).

2. Banka ose dega e bankës së huaj, në rastin kur ushtron aktivitetin brenda qendrave të mëdha tregtare, për të siguruar një burim të dytë të energjisë elektrike, nënshkruan marrëveshje për furnizimin me energji elektrike me qendrën tregtare.

3. Bankat dhe degët e bankave të huaja njoftojnë komisariatin e policisë në rrethet ku do të hapen degët dhe/ose agjencitë e reja.

Neni 7
Kërkesa për zonën e arkëtarëve

1. Zona e arkëtarëve e bankës ose degës së bankës së huaj vendoset në një ambient të veçantë, të kufizuar. Hyrja në këtë zonë bëhet me portë me krah mekanik, e cila gjatë orarit të punës qëndron gjithnjë e mbyllur dhe ka mundësi hapjeje vetëm nga brenda.

2. Vlerat monetare, në zonën e arkëtarëve, mbahen të vendosura në minikasaforta ose sirtarë të posaçëm. Sasia e vlerave në to të jetë e kufizuar, si edhe të jetë e pamundur lëvizja (hapja apo zhvendosja) e paautorizuar e tyre.

3. Ndarja me anë të sportelit, në varësi me nivelin e parashikuar të rrezikut, të bëhet me xham të fortë ose me superbanak të tavolinave, duke siguruar largësinë e duhur të sigurisë nga klienti.

Neni 8
Kërkesa për zonën e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare fizike për degën e bankës

1. Zona e administrimit dhe e ruajtjes së vlerave monetare fizike për degën e bankës, përfaqësohet nga dhoma kasafortë në të cilën vendosen vlerat monetare.

2. Dhoma kasafortë është e izoluar me material të fortë, me qëllim mbrojtjen në mënyrë uniforme nga depërtimet dhe ndërhyrjet fizike.

3. Në rast të mungesës së dhomës kasafortë, krijohet një ambient i veçantë për vendosjen e kasafortës, që plotëson këta parametra:

a) të jetë në brendësi të ambienteve të degës, mundësisht në një vend të fshehtë dhe kryesisht të izoluar;
b) të jetë e ndërtuar me material të fortë;
c) dera e hyrjes për në këtë ambient të jetë me çelës dhe me kontakte magnetike, si dhe fortësia e saj të jetë e barabartë me fortësinë e mureve;
d) të instalohen sensorë sizmikë, sensorë lëvizjeje, sensorë zjarri si dhe telekamera, për të monitoruar dhomën nga brenda dhe hyrjen e jashtme.

4. Në rast të mungesës së ambienteve, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, kasaforta e vlerave monetare mund të vendoset edhe në një vend të veçantë brenda sporteleve, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) të vendoset në një vend të fshehtë që nuk shihet nga klientët;
b) të jetë e kufizuar me mur tulle dhe me portë të veçantë me çelës.

5. Kasaforta të ketë mbrojtje të plotë nga ndërhyrja dhe depërtimi fizik, dhe të plotësojë karakteristikat e mëposhtme:

a) të jetë me peshë jo më të vogël se 600 kg;
b) të ketë mbyllje me çelës dhe me kombinacion të koduar, me një numër të mjaftueshëm kombinacionesh;
c) të ketë hapje me faza, ku secila fazë është plotësuese e tjetrës dhe i caktohet personave të ndryshëm të autorizuar.

Neni 9
Kërkesa për zonën e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare fizike për agjencinë bankare

1. Zona e administrimit dhe e ruajtjes së vlerave monetare fizike në agjencinë bankare plotëson parametrat e mëposhtëm:

a) krijohet në një ambient të sigurt dhe të fshehtë, në një vend ku nuk mund të shihet nga klientët;
b) dera e hyrjes të jetë me çelës ku të vendosen edhe kontakte magnetike;
c) të instalohen sensorë sizmikë, sensorë lëvizjeje, sensorë zjarri si dhe telekamera për të monitoruar dhomën nga brenda dhe hyrjen e jashtme;
d) kasaforta të ketë mbrojtje të plotë nga ndërhyrja dhe depërtimi fizik me këto karakteristika:

i. të jetë me peshë jo më të vogël se 400 kg;
ii. të ketë mbyllje me çelës dhe me kombinacion të koduar, me një numër të mjaftueshëm kombinacionesh;
iii. të ketë hapje me faza, ku secila fazë është plotësuese e tjetrës dhe i caktohet personave të ndryshëm të autorizuar.

2. Në raste të mungesës së ambienteve, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, kasaforta e vlerave monetare mund të vendoset edhe në një vend të veçantë brenda sporteleve, të ndarë deri në tavan, të fshehtë dhe që nuk shihet me sy të lirë nga klientët.

Neni 10
Kërkesa për vendosjen e ATM-ve

1. Banka ose dega e bankës së huaj, në instalimin e ATM-ve, plotëson këto kritere për kushtet teknike dhe të sigurisë:

a) instalon telekamera për të vëzhguar e regjistruar veprimet në ATM; dhe
b) në rastin kur ATM-të vendosen në godinat publike ose private, të ndryshme nga qendrat e mëdha tregtare dhe të biznesit, ambienti mbrapa ATM-së është i mbyllur me mur dhe me derë me çelës.

2. Procedura e furnizimit të ATM-së të kryhet nga dy punonjës të bankës.

Neni 11
Kërkesat për sistemin e mbrojtjes me anë të pajisjeve elektronike

1. Sistemi i mbrojtjes elektronike të bankës ose degës së bankës së huaj, përbëhet nga:

a) sistemi i vrojtimit,
b) sistemi i mbrojtjes me sensorë,
c) sistemi i sinjalizimit.

2. Sistemi i vrojtimit përbëhet nga qarku i mbyllur televiziv si dhe nga:

a) telekamerat, të cilat filmojnë në mënyrë të pandërprerë:

i. hyrjen në mjediset e përgjithshme,
ii. sportelin nga brenda dhe nga jashtë,
iii. dhomën kasafortë ose ambientin ku është vendosur kasaforta dhe hyrjen nga jashtë,
iv. ambientet ku janë vendosur serverat e sistemit të teknologjisë së informacionit,
v. ATM në rast se ka,
vi. motorgjeneratorin ose burimet e tjera alternative të energjisë,
vii. pjesën e jashtme të ambienteve, kur janë fasada me xham ose kur kanë hapësira të ndryshme, si dritare, hapësira ajrimi etj.;

b) regjistratori/ët për regjistrimin e pamjeve të marra nga telekamerat, me këto karakteristika dhe funksione:

i. të jetë një pajisje e veçantë dixhitale (DVR) ose një kompjuter i veçantë për sistemin elektronik,
ii. të vendoset në një ambient të veçantë, në mënyrë që të mos dëmtohet në rast abuzimi apo të grabitet,
iii. të mos vendoset në ambientin e administrimit të vlerave monetare fizike,
iv. mund të vendoset në ambientin e serverave, si dhe
v. koha e ruajtjes së regjistrimeve, të jetë jo më pak se 60 ditë;

c) monitorët për vëzhgimin e pamjeve të të gjitha telekamerave, të jenë të instaluar në zyrën e drejtuesit të degës ose të agjencisë. Këta nuk instalohen nëse është i mundur shikimi me sy të lirë i të gjitha sipërfaqeve të ambienteve të punës.

3. Sistemi i mbrojtjes me sensorë, përbëhet nga:

a) sensorë lëvizjeje, të instaluar në të gjitha mjediset e brendshme;
b) sensorë sizmikë, të instaluar:

i. në dhomën kasafortë apo në muret rrethuese ku është vendosur

kasaforta kryesore e vlerave monetare,
ii. në ambientin e serverave;

c) sensorë të mbrojtjes së xhamave, në ato raste kur këta përbëjnë sipërfaqe të konsiderueshme fasade por edhe në ato raste kur ka dritare që duhet të jenë të pakapshme;

d) kontakte magnetike, të instaluara në:

i. dyert e dhomës kasafortë,
ii. derën e ambientit të serverit,
iii. si edhe në dritaret e pjesës së pasme të objektit nëse janë të lëvizshme (hapen dhe mbyllen);

e) sensorë të mbrojtjes nga zjarri dhe/ose pajisje dhe rrjete, të instaluara në të gjithë mjedisin e subjektit, që mundësojnë dërgimin e shpejtë të sinjalit të alarmit pranë njësisë së mbrojtjes kundër zjarrit dhe personave drejtues të bankës ose degës së bankës së huaj, gjatë 24 orëve;

f) sensorë lagështire, të cilët instalohen në rastet kur dega ose agjencia ka ambiente nën tokë.

4. Sistemi i sinjalizimit, përbëhet nga:

a) sirenë alarmi e brendshme dhe e jashtme;
b) butona (pedana) alarmi të instaluar në tavolinat e punës të punonjësve të sportelit, të zonës së administrimit të vlerave monetare fizike dhe në tavolinën e punës së drejtuesit;
c) centrali i alarmit për aktivizimin e alarmit;
d) kombinatori telefonik për dërgimin e sinjalit të alarmit në telefonat e drejtuesve të degës ose agjencisë, të sallës operative ose të drejtuesve të SHRSF që ruajnë subjektin, në qendrën operative të Komisariatit të Policisë së Shtetit si dhe në drejtorinë e bankës ose degës së bankës së huaj.

5. Banka ose dega e bankës së huaj, dërgon dhe verifikon alarmin e sistemit elektronik, në sallat operative të komisariateve të policisë ose në sallat operative të SHRSF-ve, që veprojnë në qytetin ku ndodhet dega ose agjencia, sipas marrëveshjes përkatëse të lidhur me këto të fundit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

6. Banka ose dega e bankës së huaj lidh marrëveshje me SHRSF, të cilat ofrojnë këtë shërbim me salla operative për 24 orë dhe disponojnë grupe të gatshme për marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit.

7. Banka ose dega e bankës së huaj, për mbajtjen në gatishmëri

të sistemeve elektronike të mbrojtjes të instaluar në degë dhe agjenci, kryen prova jo më pak se një herë në muaj. Në këto raste evidentohet data dhe ora e kryerjes së provës, difektet e konstatuara, masat e marra për eliminimin e tyre si dhe personat që kryjnë provën.

Neni 12
Kërkesat për mbrojtjen me personel

1. Ruajtja dhe sigurimi me personel i ambienteve të punës së bankës ose degës së bankës së huaj përfshin:

a) sigurimin e jashtëm;
b) sigurimin e brendshëm.

2. Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë orarit të punës, siguron mbrojtjen e ambienteve të brendshme të bankës, me anë të punonjësve të sigurimit të brendshëm ose punonjësve të SHRSF-së.

3. Punonjësi i sigurimit të brendshëm përveç pajisjeve të tjera duhet të kenë detektor metalik portativ, për rastet kur nuk ka të instaluar detektor metalik statik.

4. Pranë hyrjes së degës së bankës vendosen kasa me sirtarë metalikë me çelës për depozitimin e mjeteve të forta, të armëve të zjarrit e të atyre të ftohta.

5. Sigurimi i jashtëm, gjatë orarit të punës, bëhet me shërbim të punonjësve roje të SHRSF-së, të licencuar nga Ministria e Brendshme për kategoritë "a" dhe "b", në zbatim të ligjit nr. 8770, datë 19.04.2001 " Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar.

6. Punonjësi i shërbimit të SHRSF-së është i pajisur sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" si edhe të akteve të miratuara në zbatim të tij.

7. Banka ose dega e bankës së huaj, për mbrojtjen me personel të degëve, realizon sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm.

8. Banka ose dega e bankës së huaj, për mbrojtjen me personel të agjencive bankare, në varësi të nivelit të perceptuar të rrezikut realizon sigurimin e brendshëm dhe/ose të jashtëm.

Neni 13
Kërkesat për trajtimin e vlerave monetare fizike

1. Banka ose dega e bankës së huaj, merr masa që të mos mbajë në sportelet e saj dhe/ose në dhomën e administrimit të mjeteve monetare, sasi të vlerave monetare fizike, që tejkalojnë në mënyrë të pajustifikueshme sasitë që i nevojiten gjatë ditës së punës, për nevojat e saj në marrëdhëniet me klientët.

2. Banka ose dega e bankës së huaj, kryen sigurimin e vlerave monetare fizike në gjendje stoku dhe/ose në udhëtim, në përputhje me procedurat që zbatojnë shoqëritë e sigurimit, të licencuara dhe të autorizuara për të ofruar shërbimin e sigurimit të vlerave monetare.

3. Banka ose dega e bankës së huaj, merr masa që të transportojë në mënyrë të sigurtë vlerat monetare fizike.

4. Shoqërimi, gjatë transportimit të vlerave monetare fizike, realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar, si edhe të akteve të miratuara në zbatim të tij.

5. Banka ose dega e bankës së huaj, për trajtimin e vlerave monetare fizike, mban në ambientet e saj dokumentacionin e mëposhtëm:

a) marrëveshjen e lidhur me SHRSF-në;
b) kopje të licencës të kategorisë "C", të SHRSF-së me të cilën është lidhur marrëveshja;
c) listën e punonjësve të shërbimit të SHRSF-ve, të miratuar nga drejtoritë e policisë së qarqeve dhe lejet e mbajtjes së armatimit;
d) kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e makinave të blinduara;
e) licencën për ngritjen dhe shfrytëzimin e një sistemi të pavarur radiokomunikacioni, me të cilën SHRSF-të pajisen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve;
f) kontratën e sigurimit të vlerave monetare fizike, të lidhur me shoqërinë e sigurimit.

6. Shoqërimi i vlerave nga SHRSF-të, në bazë të destinacionit, bëhet si më poshtë:

a) për lëvizjet jashtë qytetit, me mjet të blinduar për transportimin e vlerave monetare dhe me mjet të posaçëm për eskortën e shoqërimit;

b) për lëvizjet brenda qytetit, me mjet të blinduar për transportimin e vlerave monetare dhe me mjet të posaçëm për eskortën e shoqërimit.

7. Punonjësit e shërbimit që bëjnë shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, nuk lejohet të udhëtojnë e të qëndrojnë në automjetet që transportojnë vlerat monetare.

Neni 14
Kërkesat për mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

1. Banka ose dega e bankës së huaj, për zhvillimin normal të veprimtarisë, harton politika dhe procedura për ruajtjen fizike dhe nga ndërhyrjet në rrjet, të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke i vendosur këto të fundit në një dhomë të veçantë me derë të fortë dhe me sistem mbrojtjeje, si edhe për rivendosjen në punë të tyre, në kushtet e cënimit të veprimtarisë normale nga ngjarje të jashtëzakonshme.

2. Procedurat e ruajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit, duhet të synojnë identifikimin dhe mbrojtjen nga aksesimi i paautorizuar, në mënyrë fizike dhe/ose nga penetrimi në rrjet, minimalisht të:

a) arkitekturës së rrjetit të teknologjisë së informacionit;
b) serverave dhe mjediseve të vendosjes së tyre, pajisjeve kompjuterike dhe mediave të *backup*-it, të *softeve* që do të përdoren dhe të vlerësimit të përshtatshmërisë së tyre;
c) planit të veprimit në raste të jashtëzakonshme;
d) mënyrave të lidhjes *online* me degët dhe agjencitë, dhe linjat dytësore për lidhjet me to;
e) përshkrimeve të punës së personave që do të merren me administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit;
f) procedurave dhe të pajisjeve të ruajtjes së të dhënave;
g) programit të sigurisë së sistemit;
h) strategjisë së zhvillimit të sistemit të teknologjisë së informacionit;
i) procedurave të mbështetjes teknike të degëve dhe të agjencive;
j) vlerësimit të rrezikut në lidhje me teknologjinë e informacionit;
k) procedurave të administrimit të ndryshimeve të sistemit;
l) proceseve të monitorimit të sistemit;
m) kontratave me ofrues të jashtëm të shërbimit të teknologjisë së informacionit;
n) elementeve të tjera, që subjekti i gjykon të nevojshme.

Neni 15
Kërkesat për kryerjen e veprimeve operacionale

Banka ose dega e bankës së huaj, për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë operacionale në kushte normale, siguron pajisjet e mëposhtme:

a) kompjutera, printera dhe aksesorët e tyre;
b) programe informatike në mbështetje të veprimtarisë së parashikuar;
c) tryeza pune;
d) telefon;
e) faks/teleks;
f) makina sortuese dhe makina të numërimit të parave;
g) makina dhe pajisje të verifikimit të parave;
h) tabela të shfaqjes për publikun të niveleve të normave të interesit, të komisioneve, të kursit të këmbimit, informacione të ndryshme;
i) modularët për veprimet në sportel;
j) lajmërimet përmbledhëse dhe fletëpalosjet informuese;
k) të tjera, që subjekti i gjykon të nevojshme.

KREU III
KËRKESAT PËR KUSHTET TEKNIKE DHE TË SIGURISË PËR ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR, SUBJEKTET E TJERA FINANCIARE JOBANKA QË VEPROJNË ME SPORTEL, DHE AGJENTËT E TYRE

Neni 16
Kërkesa për mbrojtjen e ambienteve

1. Zyrat e këmbimit valutor, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka që veprojnë me sportel dhe agjentët e tyre, duhet të vendosen në ambiente të veçanta, të ndara fizikisht (kufizuara) në të gjithë perimetrin e tyre. Muret perimetrale duhet të jenë të forta dhe në ato raste kur fasada dhe dera e jashtme janë me xham, përpara tyre vendoset qepen metalik.

2. Në rast se zyrat e këmbimit valutor ose subjektet e tjera financiare jobanka janë brenda ambienteve publike si hotele, qendra tregtare apo biznesi, aeroporte etj., kabinat e tyre, të cilat kanë vetëm zonën e sportelit si ambient të kufizuar, të jenë të sigurta.

3. Ambientet e zyrave të këmbimit valutor, si dhe subjekteve të tjera financiare jobanka që veprojnë me sportel dhe agjentëve të tyre, përbëhen nga dy zona: zona e sportelit dhe zona e klientit. Zona e sportelit është ndarje e veçantë dhe e mbyllur, me xham të

fortë dhe derë me çelës, e cila është në brendësi të ambientit të subjektit, ndërsa zona e klientit është në hyrje të tij.

4. Brenda zonës së sportelit vendoset kasafortë metalike, ku ruhen dhe administrohen vlerat monetare. Kasaforta duhet të jetë e betonuar në bazamentin e saj. Kur kasaforta është mbi 100 kg nuk betonohet. Kasaforta duhet të jetë e sigurtë, me dy çelësa ose me një çelës dhe një kod.

5. Zyrat e këmbimit valutor, dhe subjektet e tjera financiare jobanka që veprojnë me sportel dhe agjentët e tyre, si rregull instalojnë telekamera të brendshme dhe të jashtme, që të mbulojnë me vëzhgim gjithë sipërfaqen e ambientit ose instalojnë sistemin e sinjalizimit, me qëllim përcjelljen e sinjalit në qendrat (sallat) operatore të SHRSF-ve, me të cilat duhet të kenë lidhur marrëveshjen përkatëse. Imazhet e telekamerave ruhen në një afat kohor prej 30 ditësh në kompjuter ose DVR.

Neni 17
Kërkesat për kryerjen e veprimeve operacionale

1. Zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet e tjera financiare jobanka që veprojnë me sportel dhe agjentët e tyre, për zhvillimin e veprimtarisë normale, pajisen në varësi të veprimtarisë që kryejnë, siç përcaktohet në nenin 15 të kësaj rregulloreje, përjashtuar shkronjën "j" si dhe vendosin një tabelë të jashtme në të cilën shënohet sipas rastit "Zyra e këmbimit valutor", "Subjekti financiar jobankë", "Agjent i subjektit financiar jobankë" e shoqëruar me emërtimin ligjor (sipas formatit të licencës dhe regjistrimit në QKR).

2. Zyrat e këmbimit valutor, për qëllim të raportimit në Bankën e Shqipërisë instalojnë një nga mjetet e komunikimit, të përcaktuara në nenin 15, shkronjat "d" dhe "e" të kësaj rregulloreje.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Mbikëqyrja

1. Inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe specialistët e Departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes pranë Bankës së Shqipërisë, realizojnë verifikimin e zbatimit të kërkesave kësaj rregulloreje.

2. Në fillim të çdo viti kalendarik, bankat ose degët e bankave të huaja, informojnë Bankën e Shqipërisë për:

a) SHRSF-të me të cilat kanë lidhur marrëveshje për ruajtjen fizike, për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje dhe për dërgimin e verifikimit të sinjalit të alarmit;

b) automjetet e blinduara për sigurimin e lëvizjes së vlerave monetare, targat, tipin, drejtuesin e automjetit të blinduar si dhe një kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për këto automjete;

c) listën e punonjësve të shërbimit të SHRSF-ve, të miratuar nga drejtoritë e policisë së qarqeve dhe lejet e mbajtjes së armatimit;

d) licencën për ngritjen dhe shfrytëzimin e një sistemi të pavarur radiokomunikacioni, me të cilën SHRSF-të pajisen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Neni 19
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 20
Dispozitë kalimtare

Subjektet e kësaj rregulloreje si dhe degët ose agjencitë e tyre, të licencuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 92, datë 24.12. 2008

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMTARIE FINANCIARE SHTESË NGA BANKA CREDINS SH.A..

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronjat "c" dhe "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenit 23, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga banka Credins sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë si më poshtë:
   "Faktoringu dhe financimi i transaksioneve tregtare".
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në formatin e aneksit të licencës të bankës Credins sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 93, datë 24.12.2008

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR TRANSFERIMIN (NDRYSHIMIN) E PJESËMARRJES INFLUENCUESE NË KAPITALIN AKSIONER TË BANKËS ITALIANE TË ZHVILLIMIT SH.A., NGA Z. FRANCESCO MARIANO MARIANO DHE BANCA POPOLARE PUGLIESE S.C.P.A TEK VENETO BANCA HOLDING S.C.P.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, të pikës1, shkronja "gj", pikave 3 dhe 4 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.71, datë11.09.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për transferimin e pronësisë të 76.83 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksioner të Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a., nga aksionerët ekzistues, zoti Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese S.c.p.A. tek Veneto Banca Holding S.c.p.A..
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 94, datë 24. 12.2008

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR RRITJEN E PËRQINDJES TË PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONERIT ALEKSANDËR PILO NË KAPITALIN AKSIONER TË BANKËS CREDINS SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, të pikës 1, shkronja "h", të pikave 3 dhe 4 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.71, datë 11.09.2002 të Këshillit Mbikëqyrës, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për rritjen e pjesëmarrjes influencuese të aksionerit Aleksandër Pilo, nga 15.1525 për qind në 23.64 për qind të aksioneve, në kapitalin aksioner të Bankës Credins sh.a..
2. Ngarkohet aksioneri Aleksandër Pilo që brenda 3 (tre) muajve nga miratimi i këtij vendimi të depozitojë në Bankën e Shqipërisë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shlyerjen prej tij të detyrimeve tatimore, për burimet e fondeve të përdorura për rritjen e pjesëmarrjes influencuese, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 95, datë 24. 12.2008

PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RAPORTIMIT DHE
PËRMBAJTJEN E RAPORTEVE FINANCIARE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, gërma "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar , të nenit 47, pika 4 dhe nenit 49, pika 3, shkronja "a" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Dispozitat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të cilat i referohen Manualit të Kontabilitetit Bankar të shfuqizuar, do t'i referohen "Metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare", sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

METODOLOGJIA E RAPORTIMIT DHE PËRMBAJTA E RAPORTEVE FINANCIARE

PJESA 1. Lista e llogarive dhe parimet e përgjithshme

HYRJE. Paraqitja e metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare

Pjesa 1.1. Plani i llogarive
Seksioni 1. Paraqitja e sistemit të llogarive
Seksioni 2. Lista e llogarive

Pjesa 1.2. Parimet e përgjithshme kontabël dhe dokumentacioni kontabël
Seksioni 1. Parimet kontabël
Seksioni 2. Parimet e përgjithshme të regjistrimit dhe dokumentacionit kontabël

PJESA 2. Skemat kontabël

Pjesa 2.1: Paraqitja e veprimeve bazë bankare
Seksioni 1 - Veprimet e thesarit dhe transaksionet ndërbankare
Seksioni 2 - Veprimet me klientelën
Seksioni 3 - Veprimet me letrat me vlerë
Seksioni 4 - Interesa pjesëmarrës dhe filialet
Seksioni 5 - Mjetet e trupëzuara dhe të patrupëzuara
Seksioni 6 - Ndihmat
Seksioni 7 - Burimet e përhershme dhe fondet rezervë për rreziqet dhe shpenzimet
Seksioni 8 - Mjete dhe detyrime të tjera
Seksioni 9 - Veprimet me normën e interesit
Seksioni 10 - Transaksionet valutore
Seksioni 11 - Veprimet me qira (leasing-u)
Seksioni 12 – Faktoringu
Seksioni 13 - Transaksionet e konsorciumit
Seksioni 14 - Procedurat në mbyllje të inventarit
Seksioni 15 – Konsolidimi

Pjesa 2.2: Paraqitja e regjistrimeve bazë kontabël

Lista e veprimeve

Seksioni 1: Arka (monedha e vendit)
Seksioni 2: Veprimet me klientët në monedhën e vendit
Seksioni 3: Sistemi bankar i brendshëm
Seksioni 4: Tregu i brendshëm i parasë
Seksioni 5: Valuta
Seksioni 6: Degët
Seksioni 7: Mjetet e qëndrueshme të bankës
Seksioni 8: Veprimet jashtë bilancit
Seksioni 9: Fitimi dhe humbja
Seksioni 10: Ndihma dhe dhurata nga organizatat publike

PJESA 3. Raportet financiare

Pjesa 3.1: Raportet financiare vjetore
Pjesa 3.2: Raportet financiare periodike

PJESA 1

Lista e llogarive dhe parimet e përgjithshme

HYRJE: Paraqitja e metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare

Pjesa 1.1: Plani i llogarive

Seksioni 1: Paraqitja e sistemit të llogarive
Seksioni 2: Lista e llogarive

Pjesa 1.2: Parimet e përgjithshme kontabël dhe parimet e përgjithshme të regjistrimit dhe dokumentacionit kontabël

Seksioni 1: Parimet kontabël
Seksioni 2: Parimet e përgjithshme të regjistrimit dhe dokumentacionit kontabël

HYRJE. PARAQITJA E METODOLOGJISË SË RAPORTIMIT DHE PËRMBAJTJES SË RAPORTEVE FINANCIARE

Metodologjia e raportimit dhe përmbajtjes së raporteve financiare (si më poshtë Metodologjia) është e ndarë në katër pjesë:

Pjesa 1: Lista e llogarive dhe parimet kontabël;
Pjesa 2: Skemat kontabël;
Pjesa 3: Raportet financiare;
Pjesa 4: Format e raportimit në Bankën e Shqipërisë.

Pjesa 1 jep kuadrin kontabël që duhet të respektohet nga bankat tregtare. Ajo përbëhet nga:

- një tabelë që paraqet klasat kontabël,
- një listë llogarish për t'u përdorur,
- parimet e përgjithshme të kontabilitetit, të mbajtjes së llogarive dhe të dokumentacionit kontabël.

Pjesa 2, jep një listë të parimeve për veprimet kryesore bankare dhe një seri shembujsh të veprimeve bankare më të zakonshme, së bashku me regjistrimet kontabile korresponduese.

Pjesët 3 dhe 4, *i referohen informacionit që duhet t'u paraqitet investitorëve dhe klientëve (raportet financiare) ose t'i dërgohet Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrje bankare (formularët e raportimit në Bankën e Shqipërisë).

** Pjesa 4 (Formularët e raportimit në Bankën e Shqipërisë) nuk përfshihet në këtë libër, pasi miratimi i tij është kompetencë e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.*

Metodologjia është një dokument referimi për bankat të cilat duhet të vënë në veprim sistemin e tyre të kontabilitetit në përputhje me rregullat e paraqitura në Metodologji. Ai shërben si një gjuhë e përbashkët për bankat, aksionerët, investitorët dhe autoritetet qeveritare.

PJESA 1.1: PLANI I LLOGARIVE

Seksioni 1: Pamje e përgjithshme e sistemit kontabël

1. Regjistrimi

Sistemi kontabël regjistron të gjitha veprimet bankare të kryera nga një bankë tregtare.

Nëse këto operacione janë kryer ato regjistrohen në *bilanc*.

Nëse ato do të kryhen në të ardhmen ose nëse janë angazhime, ato regjistrohen *jashtë bilancit*.

Nëse ato i referohen të ardhurave ose shpenzimeve, regjistrohen në *llogaritë e fitimit dhe të humbjes*.

2. Kodifikimi

Kodifikimi i llogarive bazohet në elementet e mëposhtme:

a. Kodifikimi bazohet në ndarjen e informacionit në 9 klasa në përputhje me standardet ndërkombëtare.
b. Lista e Llogarive numëron 5 shifra:

Shifra e parë: Klasa
Shifra e dytë: Rubrika
Shifra e tretë: Grupi
Shifra e katërt: Llogaria
Shifra e pestë: Nënllogaria.

c. Bankat kanë të drejtë të përdorin edhe nënshifra sipas gjykimeve të tyre për të regjistruar të tjera informacione si rezidenca, monedha, sektorizimi etj..

d. Në të kundërt, bankat nuk lejohen të ndryshojnë emërtimin e një llogarie ose të krijojnë një llogari edhe kur numri korrespondues nuk është në përdorim. Vetëm autoritetet qeveritare, Banka e Shqipërisë dhe organizmat profesionalë kanë të drejtë për të krijuar rubrika, grupe, llogari ose nënllogari të reja.

e. Plani i Llogarive mendohet të regjistrojë veprimet kryesore të kryera nga bankat tregtare. Ai, gjithashtu, lejon shtimin e veprimeve të reja sapo të nevojitet.

3. KLASIFIKIMI

Veprimet ndahen në 9 klasa:

- bilanci: 5 klasa (klasa 1 deri në klasën 5)
- jashtë bilanci: 1 klasë (klasa 9)
- fitimi dhe humbja: 2 klasa (klasa 6 dhe klasa 7).

Veprimet e klasifikuara sipas kritereve të ndryshme:

- sipas natyrës së palës tjetër (klasat 1, 2 dhe 4).
  - Klasa 1 për veprimet midis bankave.
  - Klasa 2 për veprimet me klientët, përfshi Qeverinë Shqiptare dhe administratën publike.
  - Klasa 4 për veprimet me palët e treta, përfshi veprimet me degët dhe llogaritë pezull ose të rregullimit, cilado qoftë natyra e veprimit, përveç letrave me vlerë.

- sipas natyrës së veprimit (klasat 3, 6, 7 dhe 9).
  - Letrat me vlerë regjistrohen në klasën 3 veçmas nga letrat me vlerë të përshtatshme për rifinancim nga Banka Qendrore, të paraqitura në klasën 1.

- sipas natyrës së përdorimit (klasa 5).
  - Klasa 5 regjistron mjetet dhe detyrimet e përdorura nga banka për veprime.

4. EMËRTIMI I KLASAVE

Klasa 1: Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare.
Klasa 2: Veprimet me klientët.
Klasa 3: Veprimet me letrat me vlerë.
Klasa 4: Mjetet dhe detyrimet e tjera.
Klasa 5: Mjetet e qëndrueshme dhe burimet e përhershme.
Klasa 6: Llogaritë e shpenzimeve.
Klasa 7: Llogaritë e të ardhurave.
Klasa 9: Llogaritë jashtë bilancit.

5. PAMJE E PËRGJITHSHME E LISTËS SË LLOGARIVE

BILANCI				
Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5
Veprimet me sektorin bankar	Veprime me klientët	Letrat me vlerë	Mjete dhe detyrime të tjera	Mjetet e qëndrueshme dhe burimet e përhershme
11-Arka dhe Banka Qendrore	20-Hua standarde 21-Hua të pakthyera në afat	31-Letra me vlerë me të ardhura fikse	41-Mjete të tjera	51-Interesat pjesëmarrës
12-Letra me vlerë për rifinancim	22-Hua në ndjekje	32-Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	42-Detyrime të tjera	52-Filialet
13-Llogaritë rrjedhëse	23-Hua nënstandarde	33-Borxhe të përfaqësuara nga letra me vlerë	43-Veprime si agjent	53-Mjetet e qëndrueshme (fikse)
14-Depozitat në banka	24-Hua të dyshimta	34-REPO	44-Degët	54-Ndihmat dhe financimi publik
15-Kredi dhënë bankave	25-Hua të humbura	35-Kolaterali për transaksionet me letrat me vlerë	45-Llogaritë pezull	55-Fondet rezervë
16-Depozita nga bankat	26-Administrata publike	36-Primet për instrumentet financiare	46-Tatimi i vlerës së shtuar	56-Borxhi i varur
17-Huamarrje nga bankat	27-Llogari rrjedhëse			57-Kapitali i aksionerëve
18-Llogari të tjera me bankat	28-Llogari të tjera të klientëve			58-Fitimet (humbjet) e pashpërndara
- kur ndodh një ngjarje e jashtëzakonshme ose e spikatshme e cila e bën të nevojshëm ndryshimin, me qëllim që të pasqyrohet më mirë kjo ngjarje në pasqyrat financiare të bankës;
- ndryshimi në rregullat kontabël dhe tatimorë.

Ndryshimet në politikat kontabël mund të paraqiten në pasqyrat financiare në mënyra të ndryshme. Politika e re mund të zbatohet:

- për pasqyrat financiare aktuale dhe të ardhme. Kur është praktike, jepet informacion shtesë në një formë standarde për të treguar se cili do të kishte qenë efekti në të ardhurat e periudhave paraardhëse nëse do të ishte zbatuar që atëherë politika e re;

- në mënyrë prapavepruese, sikur të ishte gjithmonë në përdorim. Kur një politikë e re zbatohet në mënyrë prapavepruese, pasqyrat e paraqitura për të ardhurat për të gjitha periudhat rregullohen për të pasqyruar politikën e re; ose

- duke paraqitur si një zë të vetëm në pasqyrën e të ardhurave për periudhën aktuale, sasinë e ndikimit kumulativ në fitimet e pashpërndara në fillim të periudhës në të cilën janë bërë ndryshimet. Informacioni standard zakonisht paraqitet për të treguar se cili do të ishte ndikimi në të ardhurat e periudhave paraardhëse, nëse politika e re do të ishte përdorur qysh atëherë.

Ndikimet e ndryshimeve të parimeve kontabël normalisht regjistrohen si një e ardhur e jashtëzakonshme, në përputhje me parimin e mosrregullimit (moskorrektimit) në mbyllje të vitit.

Të gjitha ndryshimet në politikat kontabël, metodat e vlerësimit dhe standardet e raportimit duhen raportuar si duhet në njoftimin që shoqëron raportet financiare.

1.5. PËRLLOGARITJA (ACCRUAL)

Në bazë të këtij parimi, të ardhurat dhe shpenzimet pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato fitohen ose shkaktohen (dhe jo patjetër kur merret ose paguhet fizikisht paraja) dhe regjistrohen në raportet financiare të periudhës së cilës ato i përkasin. Për shembull, një shpenzim qiraje paguar në dhjetor n, për periudhën dhjetor n deri në janar n + 1 duhet të rregullohet për fundin e vitit. 50% e shpenzimit do të stornohet dhe do të debitohet si shpenzim i n + 1.

Raportet financiare të përgatitura në bazë përllogaritjeje (rrjedhëse) i japin përdoruesit informacion jo vetëm për transaksionet e kaluara që janë shoqëruar me pagesë dhe hyrje fizike të parasë, por edhe me detyrimet për të paguar para në të ardhmen dhe burimet që përfaqësojnë para që do të merret në të ardhmen.

Kur në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet bazë kontabël të përmendura më sipër, nuk kërkohet shpjegimi i këtyre parimeve. Nëse nuk është zbatuar një parim bazë kontabël, ky fakt duhet të shënohet së bashku me arsyet që kanë çuar në moszbatimin e tij.

1.6. PAPREKSHMËRIA E BILANCIT TË ÇELJES

Sipas këtij parimi, bilanci i çeljes duhet t'i korrespondojë bilancit mbyllës të periudhës së mëparshme. Për pasojë, është e pamundur të përfshihen në kapitalin e vet të aksionerëve të periudhave paraardhëse çdolloj e ardhur dhe shpenzim, edhe nëse ato kanë lidhje me këto periudha.

1.7. MOSKOMPENSIMI I MJETEVE DHE DETYRIMEVE, TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Sipas këtij parimi:

- mjetet dhe detyrimet duhet të paraqiten veçmas në bilanc; dhe
- kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve që paraqiten në bilanc, i të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave si dhe kompensimi i zërave jashtë bilancit, përgjithësisht nuk lejohet nëse nuk ekziston një e drejtë ligjore për këtë kompensim. Për shembull, një hua (ana e mjeteve) dhe një depozitë (ana e detyrimeve) që kanë të bëjnë me të njëjtin klient nuk mund të kompensohen.

1.8. PARAQITJA E BESUESHME DHE PLOTËSIA

Sipas këij parimi, pasqyrat financiare duhet të paraqesin një informacion të besueshëm dhe të plotë për të gjitha transaksionet e spikatshme ose ngjarjet e tjera të konsiderueshme, në kufi të të qenurit i konsiderueshëm.

1.9. TË QENURIT I KONSIDERUESHËM (MATERIALITY)[2]

Që të jetë i vlefshëm, informacioni duhet të përmbushë nevojat e përdoruesve në procesin e marrjes së vendimit. Se sa i përmbush nevojat ky inforrmacion, kjo do të varet nga natyra dhe nga fakti se sa i konsiderueshëm është ai. Në disa raste vetëm natyra e informacionit është e mjaftueshme për të përcaktuar përkatësinë e tij. Informacioni është i konsiderueshëm (material) nëse harresat ose shtrembërimet mund të ndikojnë në vendimin ekonomik të marrë nga përdoruesit, në bazë të raporteve financiare. Ky faktor varet nga madhësia e elementit ose e gabimit të gjykuar sipas rrethanave të veçanta në të cilat ai është harruar ose shtrembëruar. Kështu, në këtë mënyrë përcaktohet një prag ose pikëprerje (kufi) dhe jo thjesht një karakteristikë cilësore të cilën duhet ta ketë informacioni nëse duhet të jetë i dobishëm.

1.10. NDREQJA E GABIMEVE

Ndreqja e gabimeve mund të rezultojë nga zbatimi jo si duhet i metodave kontabël ose gabimeve të konsiderueshme (materiale), të bëra gjatë zbatimit të metodave.

Ndikimi i ndreqjeve kontabilizohet në pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës së veprimit të korrektuar. Kështu, ato kontabilizohen ose në të ardhurat dhe shpenzimet nga veprimtaria bankare ose në të ardhurat dhe shpenzimet e jashtëzakonshme.

Gabimet është e domosdoshme të ndreqin vitin financiar gjatë të cilit u zbuluan (dhe jo vitin financiar gjatë të cilit ato u bënë).

[2] *materiality - cilësia e të qenurit i konsiderueshëm, pra mjaft i madh për të ndikuar në vendime.*

SEKSIONI 2: PARIMET E PËRGJITHSHME TË MBAJTJES SË LLOGARIVE KONTABËL DHE DOKUMENTACIONI KONTABËL

2.1. PARIMET E PËRGJITHSHME

Banka duhet të mbajë dokumentet e mëposhtme kontabël:

- ditarin kronologjik të regjistrimeve kontabël;
- librin e madh;
- bilancin vërtetues;
- librin e inventarit.

Të gjitha veprimet kontabël janë regjistruar në ditar në mënyrë kronologjike. Ditarët duhet të përmblidhen në Librin e Madh çdo ditë. Si rezultat, Libri i Madh duhet të pasqyrojë të gjitha detajet e regjistrimeve në llogaritë kontabël nga kontabiliteti. Çdo transaksion duhet të justifikohet nga një dokument i cili konfirmon ekzistencën e transaksionit.

Bilanci vërtetues përmbledh tepricën e çdo llogarie dhe përdoret për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Ekzistenca dhe vlera neto e mjeteve dhe detyrimeve duhet të kontrollohet të paktën një herë në vit nëpërmjet inventarit. Inventar do të thotë verifikim periodik i mjeteve dhe detyrimeve. Libri i madh më pas përditësohet në rast mospërputhjesh midis regjistrimeve kontabël dhe realitetit.

2.2. KONTABILITETI ME SHUMË MONEDHA

Transaksionet e kryera në monedha të huaja duhet të regjistrohen në ditarët që mbahen në monedhat përkatëse. Ashtu si edhe transaksionet në Lekë, këta ditarë duhet të përmblidhen në Librin e Madh të Valutave. Bilanci vërtetues për monedhat e huaja përdoret për të përgatitur pasqyrat financiare.

Në rastin e operacioneve të këmbimit valutor (për shembull, një hua prej 1000 dollarë amerikanë duke përdorur llogarinë rrjedhëse në Lekë), transaksionet regjistrohen në dy librat e lidhur duke përdorur llogaritë lidhëse ose të pozicionit ("Kundërllogaritë e valutave – dollarë amerikanë", "Kundrallogaritë e valutave - LEK").

Parimet që kanë të bëjnë me transaksionet në valutë dhe konvertimin në Lekë të bilancit vërtetues të valutave detajohen në kapitullin IV - Pjesa 1("Transaksione në valuta") dhe kapitulli IV - pjesa 6 ("Veprime inventari në mbyllje") për veprimet me valutat e paraqitura në kapitullin 3 - pjesa 9.

2.3. DOKUMENTACIONI KONTABËL PËR POLITIKAT DHE PROCEDURAT

Politikat dhe procedurat kontabël duhen përshkruar dhe miratuar nga drejtuesit dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohen rregullisht; procedurat përfshijnë një përshkrim të organizimit të kontabilitetit dhe të proceseve të mëposhtme kontabël:

* *Proceset e vlerësimit kontabël*. Proceset që pasqyrojnë gjykime, vendime dhe zgjedhje të ndryshme në përgatitjen e pasqyrave financiare (për shembull, vlerësimin e vlerës së kuotës për fondin e amortizimit për mjetet e nxjerra jashtë përdorimit porqë ruhen (mbahen) për t'u shitur, përcaktimin e kuotës së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë, përcaktimin e vlerës reale of diclosures);
* *Përpunimet rutinë të të dhënave*. Teknikat kontabël që përpunojnë të dhënat financiare çdo ditë në mënyrë rutinë (informacion i detajuar për transaksionet) të regjistruara në libra dhe regjistra (për shembull, depozitimet dhe tërheqjet, transaksionet në llogaritë e klientëve, pagat e punonjësve);
* *Përpunimet jorutinë të të dhënave*. Përpunimet e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare kohë pas kohe (për shembull, llogaritja e "kostos ose e vlerës më të ulët të tregut" të rregullimeve për letrat me vlerë të mbajtura për shitje, llogaritja e shpenzimeve për tatimin mbi të ardhurat).

Procesi kontabël duhet të organizohet në një mënyrë të tillë që të sigurojë një provë kontrolli, domethënë:

- të mund të ruhet rendi kronologjik i transaksionit;

- të mund të justifikohet çdo informacion kontabël me dokument origjinal me anë të të cilit i tërë procesi që të çon në pasqyrat financiare dhe e anasjellta, të mund të jenë të gjurmueshme;

- lëvizjet midis gjendjeve në fund (tepricave mbyllëse) të llogarive të mund të shpjegohen nëpërmjet regjistrimit të lëvizjeve të cilat kanë prekur zërat kontabël.

PJESA 2: SKEMAT KONTABËL

PJESA 2.1: PARAQITJA E VEPRIMEVE BAZË BANKARE

Seksioni 1 - Veprimet e thesarit dhe transaksionet ndërbankare
Seksioni 2 - Veprimet me klientelën
Seksioni 3 - Veprimet me letrat me vlerë
Seksioni 4 - Interesa pjesëmarrës dhe filialet
Seksioni 5 - Mjetet e trupëzuara dhe të patrupëzuara
Seksioni 6 - Ndihmat
Seksioni 7 - Burimet e përhershme dhe fondet rezervë për rreziqet dhe shpenzimet
Seksioni 8 - Mjete dhe detyrime të tjera
Seksioni 9 - Veprimet me normën e interesit
Seksioni 10 -Transaksionet valutore
Seksioni 11 -Operacionet me qira (lizingu)
Seksioni 12 -Faktoringu
Seksioni 13 -Transaksionet e konsortiumit
Seksioni 14 -Procedurat e inventarit në mbyllje
Seksioni 15 -Konsolidimi

Pjesa 2.2: Paraqitja e regjistrimeve bazë kontabël.

Lista e veprimeve.

Seksioni 1 - Arka (monedha e vendit)
Seksioni 2 - Veprimet me klientelën në monedhën e vendit
Seksioni 3 - Sistemi bankar i vendit
Seksioni 4 - Tregu i parasë i vendit
Seksioni 5 - Veprimet në monedhë të huaj
Seksioni 6 - Veprimet me degët
Seksioni 7 - Mjetet e qëndrueshme të bankës
Seksioni 8 - Veprimet me llogaritë jashtë bilancit
Seksioni 9 - Fitimi dhe humbja
Seksioni 10-Ndihmat dhe dhuratat nga organizatat publike

PJESA 2.1: Paraqitja e veprimeve bazë bankare

SEKSIONI 1: VEPRIMET E THESARIT DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE

1.1. FUSHA E ZBATIMIT

Veprimet e thesarit dhe transaksionet ndërbankare pasqyrojnë veprimtarinë e "Bankës" në lidhje me veprimet e arkës, veprimet me bonot e thesarit dhe bonot e tjera të pranueshme për rifinancim dhe veprimet me bankën qendrore, bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare të cilat përfshijnë:

- llogaritë rrjedhëse;
- depozitat e dhëna ose të marra;
- hua të dhëna dhe të marra;
- veprime të tjera siç janë llogaritë e garancisë dhe llogaritë e bllokuara për garanci.

Institucionet financiare përkufizohen si njësi që kryejnë biznes bankar, që nënkupton aktivitetin e pranimit dhe mbledhjes së depozitave nga publiku, dhënien e huave dhe paradhënieve ndaj klientëve dhe shpërndarjen e instrumenteve të pagesave për klientët, duke siguruar që ato të respektojnë fushën e veprimtarisë bankare dhe legjislacionin e ngjashëm. Institucionet financiare përfshijnë bankat dhe institucionet e tjera financiare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj..

Grupi përkatës i llogarive është:

BILANCI

1	1	Arka dhe bankat qendrore
1	2	Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim nga banka qendrore
1	3	Llogaritë rrjedhëse në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare
1	4	Depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare
1	5	Hua dhënë bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare
1	6	Depozitat nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare
1	7	Huamarrjet nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare
1	8	Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare
1	9	Llogari për t'u arkëtuar të klasifikuara si të dyshimta me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare

ZËRAT JASHTË BILANCIT

9	0	Angazhimet për financim
9	1	Garancitë
9	3	Veprimet me valuta
9	4	Angazhime të tjera

Plus llogaritë kundërparti jashtë bilancit

PASQYRA E TË ARDHURAVE

6	0	1	1	Shpenzime për interesa për veprime me thesarin dhe transaksionet ndërbankare
7	0	1	1	Të ardhura nga interesa për veprime me thesarin dhe transaksionet ndërbankare
7	0	2	1	Të ardhura nga bonot e thesarit
6	0	3	1	Shpenzime për komisione për veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare
7	0	3	1	Të ardhura nga komisionet për veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare
7	0	6		Të ardhura nga veprimet valutore

1.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

1.2.1 ARKA

Arka përfaqëson kartëmonedhat, monedhat metalike dhe çeqet e udhëtarit në Lekë dhe në monedha të huaja, të zotëruara fizikisht nga banka dhe që janë menjëherë të disponueshme. Kjo llogari përdoret çdo herë që ka lëvizje fizike të parasë dhe historiku i lëvizjeve të parasë mbahet në "ditarin e arkës"

Teprica e llogarisë duhet rakorduar me gjendjen fizike në arkë, në fund të çdo dite.

Numizmatikat dhe metalet e çmuara nuk klasifikohen tek "Arka". Ato trajtohen si rezerva (inventar) dhe kalohen në llogaritë e rezervave (412).

1.2.2 BANKA QENDRORE

Llogaritë në bankën qendrore përfshijnë:

- llogaritë rrjedhëse;
- rezerva të detyruara, të depozituara në Bankën e Shqipërisë,
- llogaritë e depozitave në dhe nga banka qendrore;
- huatë e marra dhe të dhëna bankës qendrore;
- llogari të pakthyera në afat me bankën qendrore,
- llogari të tjera.

Kur për llogaritë në bankën qendrore paguhet interes, llogaritja e interesave bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, normës së interesit dhe shumës emërore që merret parasysh.

Bazuar në këtë llogaritje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë në bazë të fluksit në kohë. Interesat e llogaritur, por që nuk u ka ardhur afati i pagimit, kalohen në llogarinë e të ardhurave dhe njihen si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesa të përllogaritur".

Llogaria për interesat e përllogaritur krijohet për çdo lloj llogarie që siguron të ardhura të tilla ose shkakton shpenzime të kësaj natyre.

Në mungesë të ligjit, kërkesave rregullatore, kontratave, marrëveshjeve ose praktikave të zakonshme bankare, asnjë e ardhur nga interesat nuk duhet të konsiderohet si e tillë deri sa të mos jetë arkëtuar. Në të tilla rrethana shpenzimet për interesa duhet të konsiderohen si të tilla, nëse janë më të mëdha mundësitë që ato do t'i paguhen të tretëve.

1.2.3 BONOT E THESARIT DHE BONO TË TJERA TË PRANUESHME PËR RIFINANCIM NË BANKËN QENDRORE

Bonot e thesarit dhe bonot e tjera të pranueshme për rifinancim përfaqësojnë tituj për t'u arkëtuar. Ato trajtohen në këtë grup llogarish, në bazë të natyrës së tyre ligjore për t'u arkëtuar. Megjithatë, shpesh ato tregtohen si letra me vlerë dhe në këtë kuptim, ndiqet i njëjti parim si i letrave me vlerë (shih pjesën 3).

1.2.4 LLOGARITË RRJEDHËSE

Llogaritë rrjedhëse zakonisht përdoren për veprime rrjedhëse (ditore) me bankat e tjera si pastrimi i marrëdhënieve për çeqet, transfertat dhe të gjitha shumat që vihen në dispozicion ose paguhen në mënyrë të pandërprerë, në një veprim depozite ose huaje me institucionin. Shuma e mbajtur në llogarinë rrjedhëse vihet në dispozicion ose shpenzohet menjëherë.

Llogaritë rrjedhëse me bankat dhe institucionet e tjera financiare përfaqësojnë ose llogaritë e "Bankës", të çelura në banka dhe institucionet e tjera financiare (llogaritë "Tona") ose llogaritë e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të çelura në Bankë (llogaritë "Tuaja"). Këto llogari çelen në bazë të një marrëveshjeje llogarie që përcakton mënyrën se si funksionon llogaria rrjedhëse.

Për çdo llogari të të tretëve mund të përcaktohet një kufi.

Për çdo të palë të tretë dhe çdo monedhë duhet të çelen nënllogari.

Kur për llogaritë rrjedhëse paguhet interes, llogaritja e interesit bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e nisjes dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe shumën (sasinë) që merret parasysh. Llogaritja e interesit për llogaritë rrjedhëse për të cilat paguhet interes, zakonisht bazohet në tepricën ditore dhe mbi të zbatohet norma e ndryshueshme në shitje për llogaritë pa afat (overnight).

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë në bazë të fluksit në kohë. Interesat kalohen në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse interesat nuk janë llogaritur çdo ditë dhe nuk janë regjistruar drejtpërdrejt në llogarinë rrjedhëse, interesat e llogaritur kontabilizohen në llogarinë korresponduese "llogaria e interesit të përllogaritur".

Në mungesë të ligjit, kërkesave rregullatore, kontratës, marrëveshjes ose praktikës së zakonshme bankare, asnjë e ardhur nga interesat nuk duhet të njihet si e tillë deri sa të mos jetë arkëtuar. Megjithatë, në këto rrethana, shpenzimet për interesa mund të konsiderohen si të tilla nëse janë më të mëdha mundësitë që ato do t'i paguhen të tretëve.

1.2.5 DEPOZITA NË/NGA BANKA

Depozitat përfaqësojnë shumat e depozituara në bankat e tjera (llogaritë nr. 14) ose të marra nga bankat e tjera (llogaritë nr. 16) për të cilat është rënë dakord të kenë një datë shlyerjeje dhe një normë interesi.

Depozitat në/nga banka ndahen në dy kategori në varësi të afatit fillestar të tyre:

- depozita pa afat, kur depozitat kanë afat maturimi më të vogël se një ditë pune;
- depozita me afat kur depozitat kanë afat maturimi më të madh se një ditë pune.

Depozitat kontabilizohen në datën e fillimit si një aktiv ose detyrim. Në datën e maturimit depozitat shlyhen (zakonisht nëpërmjet llogarisë rrjedhëse) dhe tepricat korresponduese bëhen zero.

Llogaritja e interesave bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e fillimit dhe përfundimit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe sasinë emërore që merret në konsideratë.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit kalohen në llogarinë e fitimit dhe të humbjes dhe njihen si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesa të përllogaritur".

Depozitat nuk mund të disponohen ose të përftohen përpara datës së maturimit.

1.2.6. HUATË

Huatë (llogaritë nr. 15) duhet të jenë gjithmonë objekt i kontratave, të cilat përcaktojnë karakteristikat e huasë (shuma, periudha e maturimit, datat, afatet e shlyerjes, pagesat e interesave, komisionet etj.). Regjistrimet kontabël duhet të pasqyrojnë kushtet e kontratës.

Huatë për institucionet financiare grupohen në tre kategori, në varësi të afatit fillestar dhe karakteristikave fillestare të tyre:

- huatë pa afat, kur huatë kanë periudhë maturimi më të vogël se një ditë pune;
- huatë me afat, kur huatë kanë periudhë maturimi më të madhe se një ditë pune;
- huatë financiare, janë hua për të cilat palë e tretë është një institucion financiar jorezident por përfituesi përfundimtar i huasë është një institucion tregtar. Kjo llogari zakonisht përdoret për veprimet e eksportit ose financimit të investimeve jashtë.

Letra tregtare janë dëftesa premtimi private të vendosura nga bankat ose të shitura nëpërmjet tregtarëve për të siguruar fondet. Parimet e përgjithshme të kontabilitetit ndjekin të njëjtat parime si letrat me vlerë (shih seksionin 3).

Angazhimet financiare

Kur fondet nuk lëvrohen menjëherë, angazhimi i kreditit duhet të pasqyrohet jashtë bilancit. Shuma e kontraktuar regjistrohet në llogaritë e mëposhtme:

Debi: 9011 Angazhime të dhëna në favor të kreditit të institucionit
Kredi: 90811 Angazhime të dhëna në llogarinë e kundërparti

Regjistrimet kontabël stornohen kur fondet disbursohen

Lëvrimi i fondeve

Shuma e regjistruar në fillim në llogari përfaqëson kryegjënë (borxhin kryesor) e lëvruar dhe të akorduar institucioneve të tjera financiare.

Shlyerja e huave

Gjatë periudhës së huasë, shlyerjet e kapitalit i zbriten kryegjësë ose shumës bruto. Garancitë e marra në rastin e parapagesave regjistrohen në të ardhurat e veprimtarisë në kohën e parapagesës.

Njohja e të ardhurave

Llogaritja e interesave bazohet në kushtet kontraktore në lidhje me datën e fillimit dhe të fundit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe shumën emërore që merret në konsideratë.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit kalohen në llogarinë e fitimit dhe të humbjes (nr. 7011) dhe njihen si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesa të përllogaritur" (nr. 1519, 1529, 1539).

Komisionet e marra për huatë regjistrohen si të ardhura (nr. 7031) në momentin kur shërbimi konsiderohet plotësisht i përfunduar.

1.2.7. HUAMARRJET

Parimet e kontabilitetit për huamarrjet (nr. 17) janë të ngjashme me parimet e kontabilitetit të përshkruara më sipër për huatë. Interesat e përllogaritur, por që ende nuk u ka ardhur afati i maturimit, regjistrohen në llogarinë e fitimit dhe humbjes (nr. 6011) dhe si një detyrim në lidhje me llogarinë "interes i përllogaritur" (nr. 1719, 1729, 1739).

Komisionet e paguara për huamarrjen regjistrohen si shpenzime (nr. 6031).

1.2.8. LLOGARITË E TJERA

Llogaritë e tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare përfshijnë llogaritë e garancive dhe llogaritë e bllokuara për garanci me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare.

Gjendja e llogarive të bllokuara për garanci, përfaqëson shuma monetare të bllokuara deri në përfundimin e një veprimi ose mbarimin e veprimit të një rreziku.

Llogaritë e garancisë përfaqësojnë shuma të depozituara nga ose në "Bankë" për të garantuar veprimet me bankën, institucionin e kreditit ose institucionin financiar. Garancia e cila nuk nënkupton një transferim paraje (garanci të nënshkruar) regjistrohet jashtë bilancit.

1.2.9. LLOGARITË E PAKTHYERA NË AFAT DHE TË DYSHIMTA

Kur një këst nuk është paguar pjesërisht ose tërësisht, shuma e papaguar duhet automatikisht të riklasifikohet në llogarinë e të pakthyerave në afat. Kjo vepron për të gjitha bankat përfshi edhe bankën qendrore (për bankën qendrore, shumat duhet të regjistrohen në llogarinë nr. 1127).

Shumat e pakthyera në afat (për huatë, depozitat ose llogaritë rrjedhëse) nga një bankë, institucion kredie ose një institucion tjetër financiar nuk konsiderohen se përfaqësojnë një rrezik *apriori*. Për pasojë, nuk duhet regjistruar asnjë fond rezervë për llogaritë e pakthyera në afat. Vetëm kur periudha e kalimit të afatit kalon një masë të caktuar ose nëse një llogari për t'u arkëtuar, përfaqëson rrezik për të mos u shlyer kështu që llogaria për t'u arkëtuar riklasifikohet në "llogarinë për t'u arkëtuar në status të dyshimtë". Pastaj regjistrohet fondi rezervë për amortizim në bazë të mundësisë për moskthimin e fondeve.

Për analogji me kontabilizimin e rrezikut për llogaritë e arkëtueshme me klientët, kjo llogari mund të ndahet në bazë të shkallëve të ndryshme të rrezikut si:

- në ndjekje;
- nënstandarde;
- e dyshimtë;
- e humbur.

Në këtë rast fondi rezervë duhet të llogaritet në bazë të kritereve të njëjta që përshkruhen në seksionin 2 (Veprimet me klientelën).

1.2.10. ANGAZHIMET DHE GARANCITË JASHTË BILANCIT

Angazhimet e regjistruara jashtë bilancit përfaqësojnë kontratat (pa transferim parash) të lidhura midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare. Kontrata të tilla në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me angazhime ose garanci financimi. Ato përfaqësojnë një detyrim për të bërë diçka nga një ose të dyja palët, gjatë ose brenda një periudhe kohe të caktuar. Këto angazhime regjistrohen jashtë bilancit kur lind detyrimi.

Në rastin e garancive, ato regjistrohen jashtë bilancit në të njëjtën kohë kur operacionet e bilancit, të cilat ato i garantojnë, regjistrohen në llogaritë e bilancit.

Angazhimet jashtë bilancit zakonisht shpërblehen nga një komision që synon mbulimin e rrezikut të shkaktuar nga banka.

Shuma që duhet regjistruar jashtë bilancit i korrespondon shumës së garantuar ose shumës së angazhimit të përcaktuar në kontratë. Në datën e maturimit, regjistrimi stornohet.

Garancia e marrë ose e dhënë në formë pronësie (e llojit të ndryshëm nga paraja) duhet vlerësuar me vlerën e tregut në datën e mbylljes.

Angazhimet e financimit të dhëna ose të marra në valutë duhen vlerësuar me normën e mbylljes.

Angazhimet e dhëna nuk mund dhe nuk duhet të kompensojnë angazhimet e marra.

Kur angazhimet ose garancitë e dhëna përfshijnë një rrezik të mundshëm për bankën për të paguar me qëllim përballimin e detyrimit të saj, duhet krijuar edhe një fond rezervë për të mbuluar rrezikun. Fondi rezervë regjistrohet në anën e detyrimeve të bilancit (llogaria 55).

1.3. RASTE TË VEÇANTA

1.3.1. KREDIA LOMBARD

Kredia lombard është një hua e garantuar me letra me vlerë.

Kur jepet, huaja kontabilizohet si "hua për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare".

Garancia në fjalë regjistrohet si zë jashtë bilancit nën emërtimin "letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose rifinancim".

Interesat për kredinë lombard regjistrohen në përputhje me parimet e përmendura më sipër.

Në datën e maturimit, shlyerja e kredisë zbritet nga kryegjëja dhe zërat jashtë bilancit anulohen si letra me vlerë dhe i kthehen përsëri garantuesit.

1.3.2. KREDITË E DHËNA NGA INSTITUCIONET FINANCIARE NDËRKOMBËTARE OSE BANKAT E HUAJA PËR NJËSITË TREGTARE

Disa hua jepen nga institucionet financiare ndërkombëtare (për shembull: Banka Botërore) ose një institucion i huaj krediti për institucionet tregtare shqiptare. "Banka" e cila vepron në emër të institucionit merr fondin nga institucioni i huaj i kreditit dhe më pas ia jep huanë një institucioni tregtar të caktuar.

Në këtë rast duhen regjistruar veçmas dy veprime:

1. banka duhet të njohë detyrimin e saj kundrejt institucionit të huaj të kreditit dhe e kontabilizon atë si një "huamarrje financiare jorezidente" (1723). Për këtë hua të marrë do të zbatohen ato parime të kontabilitetit që zbatohen dhe për çdo hua tjetër;

2. banka do të regjistrojë një hua (aktiv) kundrejt klientit dhe do të ndjekë parimet e kontabilitetit në lidhje me huatë dhënë klientëve (2). Nëse huaja bëhet hua me probleme dhe nëse ajo është plotësisht e garantuar nga një palë e tretë (institucioni ndërkombëtar), atëherë huaja nuk duhet të hiqet nga kategoria e huave standarde për në klasat e huave "me rrezik" (nr. 22, 23, 24, 25). Megjithatë, shumat e pakthyera në afat duhet të regjistrohen në llogaritë e pakthyera në afat (nr. 21).

SEKSIONI 2: VEPRIMET ME KLIENTELËN

2.1 FUSHA E ZBATIMIT

Veprimet me klientelën përfaqësojnë të gjitha llojet e veprimeve të kryera nga "Banka" me klientët. Këto përfshijnë veprime të tilla si:

Me klientë kuptohen të tretët të cilët nuk janë banka, institucione krediti ose institucione të tjera financiare (shih seksionin 1). Lista e llogarive përcakton dy grupe llogarish për klientët:

Llogaritë në grupet 20 deri në 25 dhe 27:

Këto llogari kanë të bëjnë me 5 llojet kryesore të klientëve:
- individët;
- njësitë tregtare dhe industriale private;
- njësitë tregtare dhe industriale publike (më shumë se 50% e kapitalit zotërohet nga shteti);
- punonjësit e bankës;
- të tjera (siç janë organizmat fetarë, organizatat joqeveritare, institucionet ndërkombëtare jofinanciare, ambasadat e huaja, klientët financiarë jodepozitues si fondet e përbashkëta etj.).

Llogaritë e grupit 26:

Llogari të veçanta (grupi 26) përdoren për veprime me Qeverinë Shqiptare dhe ministritë e saj si dhe administratën tjetër publike shqiptare (siç janë administrata e sigurimeve shoqërore etj.).

Veprimet me klientët përfshijnë:

- veprimet me para fizike:
  - depozitime dhe tërheqje të parave fizike në llogaritë rrjedhëse;
  - pagesat me çeqe dhe dëftesa të tjera pagese dhe depozitimi në llogaritë rrjedhëse;
  - transferim parash.

- veprime krediti:
  - depozita me afat;
  - hua dhe paradhënie; *paradhënie në para fizike, *kredi vepruese (paradhënie në para fizike, letra tregtare të skontuara, llogari për t'u paguar).

*huatë sezonale;
*financimi i tregtisë me jashtë;
*huatë e investimit;
*huatë konsumatore;
*huatë hipotekare.

- veprime angazhimi dhe garancie:
  - angazhime financimi;
  - angazhime garancie (kolaterali);
  - garanci.

Llogaritë që i përkasin këtij grupi janë:

Bilanci

2.0 Huatë dhe paradhëniet standarde për klientët
2.1 Huatë dhe paradhëniet e pakthyera në afat për klientët
2.2 Huatë në ndjekje
2.3 Huatë nënstandarde
2.4 Huatë e dyshimta
2.5 Huatë e humbura
2.6 Qeveria Shqiptare dhe organizatat publike
2.7 Llogaritë rrjedhëse të klientëve dhe detyrimet për depozitat
2.8 Llogaritë e tjera të klientëve
2.9 Llogari për t'u arkëtuar nga klientët në status të dyshimtë të ndryshëm nga huatë

Zërat jashtë bilancit

9.0 Angazhime financimi
9.1 Garancitë
9.3 Transaksionet në valutë
9.4 Angazhime të tjera

Plus llogaritë kundërparti jashtë bilancit

Pasqyra e të ardhurave

6.0.1.2	Shpenzime interesi që i përkasin transaksioneve me klientelën
6.0.3.2	Shpenzime për komisione për transaksionet me klientelën
6.0.3.6	Shpenzime për komisione për shërbimet bankare
6.5	Humbjet nga llogaritë për t'u arkëtuar të pakthyeshme dhe shpenzimet për fondet rezervë
7.0.1.2	Të ardhura nga interesat prej veprimeve me klientelën
7.0.3.2	Të ardhura nga komisionet prej veprimeve me klientelën
7.0.3.6	Të ardhura nga komisionet prej shërbimeve bankare

2.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

2.2.1. HUATË STANDARDE DHËNË KLIENTËVE

Huatë dhënë klientëve duhet gjithmonë të justifikohen nga një kontratë e cila përcakton karakteristika të tilla siç janë shuma, periudha e maturimit, normat, datat, kushtet e shlyerjes, pagesa e interesit,

komisionet etj., Kontabiliteti për kreditë duhet të përfaqësojë kushtet e kontratës.

Angazhimi i kredisë

Kur fondet nuk lëvrohen menjëherë, angazhimi i kredisë duhet të pasqyrohet jashtë bilancit. Shuma e kontraktuar regjistrohet në llogaritë e mëposhtme:

Debi: 9012 Angazhime të dhëna në favor të klientëve
Kredi: 90812 Angazhime të dhëna në llogarinë e palës së tretë

Regjistrimet kontabël stornohen kur fondet lëvrohen dhe në shumat që ato lëvrohen.

Lëvrimi i fondeve

Shuma e regjistruar në aktiv përfaqëson shumën emërore të kontratave.

Huatë mund të klasifikohen në kategori të ndryshme në varësi të cilësisë së rrezikut të kredisë, llojit të klientit, afatit fillestar të huasë ose objektit të saj.

Në fillim, të gjitha huatë klasifikohen si standarde (shih më poshtë për klasifikim në lidhje me rrezikun e kredisë) dhe pastaj në varësi të afatit fillestar të tyre klasifikohen si më poshtë, me përjashtim të huave hipotekare të cilat jepen veçmas.

Afati fillestar	
*afatshkurtër	më pak se një vit
*afatmesëm	midis 1 dhe 5 vjet
*afatgjatë	mbi 5 vjet

Atëherë huaja klasifikohet në nënllogarinë e duhur në varësi të natyrës së klientit;

Natyra e klientit

Grupi i llogarive 21

*individët
*njësi tregtare dhe industriale private
*njësi tregtare dhe industriale publike (më shumë së 50% e kapitalit posedohet nga qeveria)
*punonjës banke
*të tjera (siç janë organizmat fetarë, organizatat joqeveritare, institucionet ndëkombëtare jofinanciare, ambasadat e huaja, klientët financiarë që nuk pranojnë depozita etj.)

Grupi i llogarive 26
*Qeveria Shqiptare dhe administrata publike

Rezidenca dhe monedha

Përveç këtyre ndarjeve parësore, mund të jetë e nevojshme të krijohen nënllogari për ndarjen e sipërpërmendur, për të marrë parasysh të qenurit rezident ose jorezident të klientit dhe nënllogari, për të ndarë huatë e dhëna në Lekë nga ato në monedha të huaja.

Për shembull, një hua afatshkurtër standarde dhënë një individi rezident në Lekë do të regjistrohet në llogarinë 201111 si më poshtë:

2	Veprime me klientelën
2.0	Hua standarde
2.0.1	Hua afatshkurtra
2.0.1.1	Individët
2.0.1.1.1	Rezidentë
2.0.1.1.1.1	Në Lekë

Shlyerja e huave

Gjatë periudhës së huasë, shlyerjet e kapitalit zbriten nga kryegjëja ose shuma bruto. Garancitë e marra në rast të parapagesave regjistrohen në të ardhurat e veprimtarisë në kohën e parapagimit.

Njohja e të ardhurave

Llogaritja e interesave bazohet në kushtet e kontratës së huasë në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe shumën emërore që do të merret parasysh.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit kalohen në llogarinë e të ardhurave dhe njihen si aktiv në llogarinë "interesa të përllogaritur".

Komisionet e marra nga huaja regjistrohen si të ardhura (nr. 7032) sapo shërbimi të konsiderohet plotësisht i kryer.

Të ardhura të parapaguara

Kur interesi parapaguhet, shuma emërore mund të tejkalojë shumën e lëvruar nga banka. Në këtë rast, interesi i parapaguar regjistrohet në një llogari të veçantë në pasiv në llogarinë e klientëve të tjerë (numri i llogarisë 286). Interesi i llogaritur për periudhën njihet si e ardhur dhe zbritet nga shuma e interesit të parapaguar.

Huatë standarde të pakthyera në afat

Kur një kést nuk paguhet pjesërisht ose tërësisht dhe nuk parashikohet asnjë rrezik mosshlyerjeje (për shembull, huaja është plotësisht e garantuar), shuma e papaguar (në afat) duhet automatikisht të riklasifikohet në llogarinë e huave standarde të pakthyera në afat.

Huatë e pakthyera në afat, *apriori*, nuk përfaqësojnë rrezik. Vetëm kur periudha e kalimit të afatit arrin një kohë të caktuar dhe/ose huaja përmban rrezikun e mospagimit, llogaria për t'u arkëtuar klasifikohet në llogaritë e ndryshme të "llogarive për t'u arkëtuar me rrezik" (shih seksionin "Shqyrtimi i cilësisë së rrezikut të kredisë", paragrafi 2.2.2). Në këtë rast, krijohet fondi rezervë për mbulimin e humbjes bazuar në probabilitetin e moskthimit të fondeve.

2.2.2. SHQYRTIMI I CILËSISË SË RREZIKUT TË KREDISË (HUA NË NDJEKJE, HUA NËNSTANDARDE, HUA TË DYSHIMTA, HUA TË HUMBURA)

Praktika aktuale kërkon që rreziku që shoqëron huanë të shqyrtohet të paktën çdo tremujor. Fondet rezervë për kryegjënë e huasë shqyrtohen dhe rillogariten çdo tre muaj. Megjithatë, kjo nuk duhet ta pengojë bankën që të riklasifikojë huatë kur shfaqen probleme në shlyerjen e tyre, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara më poshtë.

Me qëllim që edhe të përcaktojmë dhe kufizojmë rrezikun e kreditit, bankat duhet të klasifikojnë kreditë e tyre në një nga pesë kategoritë e mëposhtme:

- standarde;
- në ndjekje;
- nënstandarde;
- të dyshimta;
- të humbura.

Klasifikimet e mësipërme do të bëhen duke marrë parasysh forcën dhe aftësinë financiare të huamarrësit për të shlyer borxhin. Rregulli Nr. 1384, më 29 prill 1998, jep një përshkrim të secilit prej këtyre klasifikimeve siç përcaktohet më poshtë:

Hua standarde (përfshi huatë standarde të pakthyera në afat)

Huatë standarde janë huatë të cilat banka i konsideron se janë:

1. të garantuara mirë, gjendja financiare e huamarrësit është e shëndoshë dhe pagesa parashikohet të jetë në përputhje me afatet e huasë. Në të njëjtën kohë, ka fakte që gjendja financiare e huamarrësit nuk do të ndryshojë;
2. të garantuara plotësisht nga një palë e tretë e cila është në gjendje të përmbushë detyrimet nëse lind nevoja. Kjo është e

vërtetë për huatë plotësisht të garantuara nga një institucion ndërkombëtar.

Kur një këst nuk paguhet pjesërisht ose plotësisht dhe nuk parashikohet asnjë rrezik për moskthim (huaja është plotësisht e garantuar), shuma e papaguar duhet automatikisht të riklasifikohet në llogarinë e huave standarde të pakthyera në afat. Huatë e pakthyera në afat, *apriori*, nuk përfaqësojnë rrezik.

Huatë e ristrukturuara nuk do të konsiderohen standarde nga bankat në varësi të performancës.

Hua në ndjekje

Huatë në ndjekje janë huatë të cilat:

1. gjendja financiare e huamarrësit është aktualisht e mjaftueshme por dobësitë potenciale ekzistojnë dhe nëse nuk korrektohen, do të rezultojnë në një dobësim të pozicionit të kreditit të bankës në një datë të ardhme.
2. Në rastin e huave me këste, kryegjëja dhe interesi janë të pakthyera në afat për 30 - 90 ditë.
3. Në rastin e huave jo me këste (kur huatë nuk shlyhen sipas një plani këstesh), shlyerja nuk kryhet në datën e maturimit dhe e tejkalon atë për 31 - 90 ditë.

Hua nënstandarde

Huatë nënstandarde janë huatë të cilat përmbushin një nga kushtet e mëposhtme:

1. ato nuk janë të siguruara në mënyrë të mjaftueshme nga vlera e tregut e kolateralit;
2. gjendja financiare e huamarrësit është më pak se e kënaqshme. Në thelb, burimet parësore të shlyerjes janë të pamjaftueshme për të kënaqur borxhin dhe banka duhet të drejtohet tek burimet dytësore për shlyerje;
3. paaftësia për të shlyer borxhin ka rezultuar në nevojë për ta ristrukturuar atë;
4. në rastin e huave me këste, një këst nuk është paguar në afat për 90-180 ditë;
5. në rastin e huave që nuk shlyhen me këste, shlyerja nuk bëhet në datën e maturimit për 31 deri në 90 ditë.

Hua të dyshimta

Mjetet e dyshimta paraqesin të gjitha dobësitë e treguara më sipër për huatë nënstandarde dhe një nga kushtet e mëposhtme:

1. një shqyrtim i gjendjes financiare të huamarrësit paraqet një mundësi të dallueshme që huamarrësi nuk do të jetë i aftë të shlyejë plotësisht detyrimin ndaj një huaje ose borxhi tjetër të

detyruar nga banka;
2. ekziston një rrezik real për huamarrësin që të deklarohet me paaftësi paguese;
3. në rastin e huave me këste, njëri nga këstet e ka kaluar afatin e kthimit për 180 - 360 ditë;
4. klienti nuk ka paguar huanë në afat për 90 - 180 ditë, në rastin e huave jo me këste;
5. huatë janë ristrukturuar më shumë se dy herë.

Hua të humbura

Mjetet e klasifikuara si të humbura, trajtohen si të pambledhshme dhe vazhdimësia e tyre si mjete bankare nuk është e justifikueshme. Përveç pasjes së karakteristikave të huave të dyshimta, ekzistojnë dhe kushtet e mëposhtme:
1. gjendja financiare e huamarrësit tregon në mënyrë të qartë paaftësi për të përmbushur plotësisht afatet e borxhit ndaj bankës;
2. huamarrësi përfshihet në një proces likuidimi dhe ekziston një rrezik real për disa kreditorë që të mbeten të pakënaqur;
3. në rastin e huave me këste, një nga këstet e ka kaluar afatin e kthimit për më shumë se 360 ditë;
4. klienti nuk ka paguar huanë në afat për 90 - 180 ditë, në rastin e huave jo me këste.

Huatë e klasifikuara si të humbura trajtohen të pambledhshme dhe me kaq pak vlerë, saqë vazhdimi i mbajtjes së tyre si mjete bankare nuk është i justifikuar. Klasifikimi si të humbura nuk do të thotë që mjeti nuk ka absolutisht vlerë të mbetur ose kthimi. Deri sa të jenë kaluar gjithë procedurat ligjore, kjo hua klasifikohet e humbur.

Riklasifikimi i kategorisë së huasë

Në rastin kur një hua riklasifikohet nga njëra tek një tjetër prej këtyre kategorive, teprica gjithsej e huasë dhe të gjitha shumat që lidhen me të (kryegjëja, interesi i përllogaritur, interesat me pagesë të vonët, penalitetet, komisionet) duhet të kalohen në një kategori të re, cilado qoftë humbja e mundshme dhe, edhe nëse një hua e tillë është e siguruar dhe jo thjesht shumë e kërkueshme.

Njohja e të ardhurave

Kur huatë klasifikohen si nënstandarde, të dyshimta ose të humbura, nuk duhet të llogaritet më interes. Si rregull, kjo vlen kur pagesat e kanë kaluar afatin mbi 90 ditë.

Fonde rezervë statistikore për huatë standarde dhe në ndjekje

Fondi rezervë për rrezikun statistikor llogaritet për huatë standarde dhe huatë në ndjekje.

Fondi rezervë duhet të dokumentohet dhe të llogaritet në bazë të statistikave të cilat përcaktojnë shumën e humbjeve të mundshme që do të shkaktohet në popullsinë e këtyre huave, e cila në tërësi mund të trajtohet si përfaqësuese e rrezikut.

Krijimi i fondit rezervë statistikor do të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Popullsia e studjuar përfshin një numër të madh elementesh të një natyre të ngjashme, vlerësimi i rrezikut të të cilave rast pas rasti do të ishte i kushtueshëm.
- Mendohet se arsyet për të pësuar humbje të mundshme janë homogjene për popullsinë e studiuar.
- Dihen arsyet për humbjet dhe humbja e mundshme është vlerësuar duke u bazuar në studimin e të dhënave historike të vëzhguara me të vërtetë dhe të përditësuara shpesh.
- Asnjë element i popullsisë nuk do të çonte në një humbje të konsiderueshme në lidhje me popullsinë në tërësi ose rezultatet e njësisë.
- Fondi rezervë për humbjet statistikore regjistrohet në bilanc në grupin e fondeve rezervë të paraqitura në anën e detyrimeve (5513).

Fondi rezervë statistikor regjistrohet në bilanc në llogarinë e fondeve rezervë të paraqitura në anën e detyrimeve (5513).

Fondet rezervë për humbjet nga huatë kërkohen me qëllim që të mbahet një gjendje minimale e rezervës me një shumë të barabartë me:

* Huatë standarde (përfshi huatë e pakthyera në afat):	1%
* Huatë në ndjekje:	5%

Fondi rezervë minimal i përcaktuar më sipër llogaritet si për kryegjënë dhe për interesin e përllogaritur.

Fonde rezervë për amortizim të huave nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura

Fonde rezervë për amortizimin kontabilizohen çdo herë që banka sheh se ka rrezik lidhur me arkëtimin tërësor ose pjesor të një huaje. Norma e përcaktuar për fondin rezervë do të mbulojë të gjitha humbjet e identifikuara potenciale aktuale dhe të ardhme. Ajo bazohet në vlerësimin e rrezikut, historinë e kredisë së klientit, gjendjen e tij financiare aktuale dhe të parashikuar, vlerën dhe mundësinë për të vënë dorë mbi garancinë dhe kolateralin dhe çdo fakt tjetër që mund të merret në konsideratë në vlerësimin e rrezikut të mospagimit.

Vlerësimi i nivelit të mjaftueshëm të nevojshëm të fondeve rezervë duhet të kryhet në çdo datë mbyllje.

Kryegjëja

Fondet rezervë për kryegjënë për mbulimin e humbjeve nga huatë kërkohen me qëllim që të mbahet një gjendje minimale e rezervës. Fondet rezervë në bazë të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë llogariten sipas normave minimale të mëposhtme

Huatë nënstandarde:	20%
Huatë e dyshimta:	50%
Huatë e humbura:	100%

Interesi i përllogaritur

Për interesat e përllogaritur të huave nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura, duhet të krijohet fond rezervë në masën 100%.

Siç u përmend më sipër, kur huatë klasifikohen nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura, nuk duhet të llogaritet më interesi. Ky rregull zbatohet kur pagesat kanë kaluar 90 ditë.

Fondet rezervë kontabilizohen si zhvlerësim i mjeteve (në bilanc) kundrejt llogarisë së humbjes në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve. Në rast shlyerjeje ose kur fshihet nga bilanci, ky veprim stornohet.

Bilanci

2381 fond rezervë për amortizimin e huave nënstandarde - kryegjëja
2382 fond rezervë për amortizimin e huave nënstandarde - interesi
2481 fond rezervë për amortizimin e huave të dyshimta - kryegjëja
2482 fond rezervë për amortizimin e huave të dyshimta - interesi
2581 fond rezervë për amortizimin e huave të humbura - kryegjëja
2582 fond rezervë për amortizimin e huave të humbura - interesi

Fitimi dhe humbja

6523 shpenzimet për amortizimin e huave nënstandarde
6524 shpenzimet për amortizimin e huave të dyshimta
6525 shpenzimet për amortizimin e huave të humbura
7523 stornim(transferim) i fondit rezervë për amortizimin e huave nënstandarde
7524 stornim (transferim) i fondit rezervë për amortizimin e huave të dyshimta
7525 stornim (transferim) i fondit rezervë për amortizimin e huave të humbura

Huatë e humbura

Nëse shlyerja përfaqëson pagesën e fundit për huanë (ose një grup huash) dhe nëse janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore, llogaritë e kryegjësë, interesit dhe fondit rezervë mbyllen. Të gjitha fondet rezervë të regjistruara për këto shuma do të stornohen.

Huaja do të fshihet duke debituar llogaritë:

* 656.. Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme.

Fondet rezervë debitohen duke kredituar llogaritë:

* 75.. Transferim nga fondet rezervë.

Nëse huatë e humbura rifinancohen ose garantohen nga institucione ndërkombëtare, të ardhurat që vijnë nga shlyerja që bën institucioni ndërkombëtar duhen kredituar në llogarinë 762 "Të ardhura nga shlyerja e huave të humbura prej palëve të treta".

Nëse nuk janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore, huaja klasifikohet tek huatë e humbura dhe për të krijohet fond rezervë në masën 100%.

Shlyerja e huave për të cilat është regjistruar fondi rezervë

Shlyerjet e huave për të cilat janë regjistruar fonde rezervë së pari shkojnë për shlyerjen e tepricës së interesit dhe pastaj të kryegjësë. Të gjitha fondet rezervë për këto shuma do të stornohen kundrejt pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve.

Shlyerja e huave të regjistruara si hua të humbura

Shlyerjet e huave të cilat janë konsideruar si të humbura, dhe për pasojë janë fshirë nga bilanci, regjistrohen në llogarinë:

* 761 Shlyerja e huave të regjistruara si hua të humbura

2.2.3. LLOGARITË RRJEDHËSE

Llogaritë rrjedhëse të klientëve regjistrojnë depozitimet dhe tërheqjet, çeqet e mbledhura ose të lëshuara, transfertat e marra ose të bëra dhe të gjitha transaksionet në para, të kryera me çdo mjet në përfitim të klientit dhe në ngarkim të tij. Gjendja e llogarisë rrjedhëse është e disponueshme ose e prekshme brenda 24 orëve nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe.

Kur për llogaritë rrjedhëse paguhet interes, llogritja e interesit bazohet në kushtet e kontratës në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe shumën emërore që do të merret parasysh. Llogaritja e interesave për llogaritë rrjedhëse për të cilat paguhet interes zakonisht bazohet në gjendjen ditore mbi të cilën zbatohet norma e ndryshueshme pa afat (gjatë natës) në shitje.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse interesat nuk llogariten çdo ditë dhe nuk kalohen drejtpërdrejt në llogarinë rrjedhëse, interesat e përllogaritur kontabilizohen në llogarinë korresponduese "interes i përllogaritur".

Në mungesë të ligjit, kërkesave rregullatore, kontratës, marrëveshjes ose praktikës së zakonshme bankare, asnjë e ardhur nga interesat nuk duhet të njihet si e tillë deri sa të mos jetë paguar. Megjithatë, në këto rrethana, shpenzimet për interesa mund të konsiderohen si të tilla nëse janë më të mëdha mundësitë që ato do t'i paguhen të tretëve.

Për çdo klient duhet përcaktuar një kufi në lidhje më tepricën maksimale të autorizuar debitore të klientit. Ky kufi duhet të ndjekë të njëjtën procedurë si autorizimi i një kredie.

2.2.4. DEPOZITAT NGA KLIENTËT

Depozitat përfaqësojnë shumat e depozituara në "Bankë" nga klienti me një datë shlyerjeje dhe një normë interesi të pranuar.

Depozitat kontabilizohen në datën fillestare të tyre si detyrim. Në datën e maturimit depozitat shlyhen ose (zakonisht nëpërmjet llogarisë rrjedhëse) rinovohen për një tjetër periudhë të pranuar.

Llogaritja e interesit bazohet në kushtet e kontratës së huasë në lidhje me datën e fillimit dhe të përfundimit të llogaritjes së interesit, normën e interesit dhe shumën emërore që do të merret parasysh.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit kalohen në llogarinë e të ardhurave dhe njihen si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesa të përllogaritur".

Depozitat nuk mund të disponohen ose preken para datës së maturimit nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe.

2.2.5. QEVERIA SHQIPTARE DHE ORGANIZATAT PUBLIKE

Veprimet me Qeverinë Shqiptare dhe organizatat publike ndahen si më poshtë:

- qendrore: kjo llogari ka të bëjë me veprimet me Qeverinë Shqiptare,
- rajonale: kjo llogari ka të bëjë me veprimet me autoritetet rajonale,
- lokale: kjo llogari ka të bëjë me veprimet me autoritetet lokale
- administrata publike shqiptare: kjo llogari ka të bëjë me veprimet me pjesën tjetër të administratës publike, siç është administrata e sigurimeve shoqërore etj..

Veprimet në lidhje me këta klientë kryhen me llogari rrjedhëse, depozita, hua dhe huamarrje. Rregullat kontabël janë të njëjtë si për klientët e tjerë për secilin lloj veprimi, duke përfshirë edhe fondet rezervë për amortizimin e huave nëse gjykohet e nevojshme.

2.2.6. LLOGARI TË TJERA TË KLIENTËVE

- Llogaritë për mbulimin e çeqeve.

Llogaritë për mbulimin e çeqeve përdoren për të mbuluar çeqet e lëshuara nga klienti ose banka në favor të përfituesit të përcaktuar nga klienti. Kjo shumë përdoret kundrejt pagesës kur çeku paraqitet për kompensim.

- Llogari garancie.

Llogaritë e garancisë përfaqësojnë shuma të depozituara në "bankë" si garanci e veprimeve të klientit. Garancitë të cilat nuk nënkuptojnë transferim parash (garanci e nënshkruar) regjistrohen jashtë bilancit.
(Shih pjesën 2.2.7)

- Llogari të bllokuara për garanci.

Gjendja e llogarive të bllokuara për garanci përfaqëson shuma të bllokuara momentalisht deri në përfundimin e një veprimi ose të një rreziku. Sasitë që lidhen me to regjistrohen në këtë llogari.

- Llogaritë e mbulimit të letërkredive.

Llogaritë e mbulimit të letërkredive përfaqësojnë shuma të bllokuara momentalisht deri në përfundimin e veprimit midis klientit dhe furnitorit të tij. Kjo shumë përdoret për t'i shlyer "Bankës" shumën që është paguar nëpërmjet letërkredisë për bankën korresponduese, ku furnitori është klient.

2.2.7 ANGAZHIMET JASHTË BILANCIT

Angazhimet e regjistruara jashtë bilancit pasqyrojnë kontrata (pa transferim parash) të përfunduara midis bankës dhe institucioneve të tjera financiare. Kontrata të tilla, në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me angazhimet ose garancinë e financimit. Ato përfaqësojnë një detyrim për të bërë diçka nga një ose të dyja palët gjatë ose brenda një periudhe kohe të dhënë. Këto angazhime regjistrohen kur krijohet detyrimi.

Për angazhimet jashtë bilancit zakonisht paguhet një komision që synon mbulimin e rrezikut të shkaktuar nga banka.

Shuma që do të regjistrohet jashtë bilancit i korrespondon shumës së garancisë ose shumës së angazhimit të shprehur në kontratë. Në datën e maturimit, regjistrimi stornohet.

Garancia e marrë ose e dhënë në formë prone (përveç parave fizike) duhet të vlerësohet me vlerën reale në datën e mbylljes.

Angazhimet e dhëna nuk mund dhe nuk duhet të kompensohen me angazhimet e marra.

Kur angazhimet ose garancitë e dhëna paraqesin një rrezik të mundshëm për bankën për të paguar, me qëllim që të përmbushë detyrimin, për mbulimin e rrezikut duhet regjistruar fondi rezervë. Ky fond regjistrohet në pasiv të bilancit (llogaria 55).

Angazhimet e dyshimta jashtë bilancit

Angazhimet e marra nga klientët, të regjistruara jashtë bilancit, gjykohen si të dyshimta kur duket se ka pak të ngjarë që ato të arkëtohen.

2.3. RASTE TË VEÇANTA

2.3.1. HUATË E RIFINANCUARA NGA NJË INSTITUCION NDËRKOMBËTAR OSE MINISTRITË

Huatë dhënë klientëve të rifinancuara nga një organizatë ndërkombëtare (siç janë Komuniteti Evropian ose Banka Botërore) ose nga Qeveria Shqiptare përfshijnë dy veprime: huanë dhënë klientit dhe huamarrjen nga organizata ndërkombëtare ose nga Qeveria Shqiptare. Regjistrimet kontabile janë si më poshtë:

- kredia për klientin regjistrohet si kredi e rregullt
- detyrimi regjistrohet në llogaritë 1723 ose 1713 kur jepet nga institucionet financiare, ose në llogaritë 26 kur jepet nga Qeveria Shqiptare.

Nëse huaja e dhënë nuk shlyhet nga klienti, banka duhet ta konsiderojë huanë si standarde meqenëse ajo është e garantuar plotësisht prej institucionit ndërkombëtar ose Qeverisë Shqiptare. Megjithatë, shumat e pakthyera në afat duhet të regjistrohen si hua standarde, të pakthyera në afat (21). Kjo vlen vetëm nëse banka është e sigurt që huaja është plotësisht e garantuar.

Nëse institucioni ndërkombëtar ose Qeveria Shqiptare pranon të garantojë humbjen nga huaja e pakthyeshme duke anuluar një pjesë të huamarrjes të kredituar në anën e detyrimeve të bilancit të bankës, regjistrimet kontabël duhet të paraqesin:

- regjistrimin e huasë së humbur si një "humbje nga huatë e pakthyeshme" (llogaria 656): Debitohet llogaria 656, kreditohet llogaria 2# (huaja);
- regjistrimin e të ardhurve të jashtëzakonshme "të ardhura nga

shlyerja e huave të humbura nga një palë e tretë" (llogaria 762): debitohet llogaria 2# (huamarrja), kreditohet llogaria 762.

2.3.2. HUATË E GARANTUARA NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Garancitë mund të marrin formën e një mbulimi të përgjithshëm (makro) ose të pjesshëm (mikro).

- Mbulimi i përgjithshëm (makro).

Nëse garancia është në formën e një mbulimi të përgjithshëm, banka mund ta përdorë këtë garanci për të financuar angazhimet afatshkurtra. Ajo e regjistron garancinë jashtë bilancit vetëm kur veprimi (veprimet) që ajo garanton regjistrohen në bilanc. Regjistrimet kontabël janë:

- Debitimi i llogarisë 9082
- Kreditimi i llogarisë 902.

Garancia regjistrohet në tërësinë e vet edhe nëse veprimet e garantuara i përkasin shumave inferiore kundrejt vetë garancisë.

- Mbulim i pjesshëm (mikro).

Nëse garancia merr formën e një garancie të pjesshme, ajo regjistrohet jashtë bilancit kur veprimet që ajo garanton regjistrohen në bilanc. Regjistrimet kontabël janë të ngjashme me ato të treguara më sipër. Megjithatë, çdo veprim huaje duhet të harmonizohet drejtpërdrejt me një pjesë të garancisë për të njëjtën shumë.

Nëse institucioni ndërkombëtar pranon të garantojë humbjen për huatë e pakthyeshme duke i paguar bankës shumën e detyrimit të klientit, regjistrimet kontabël përfshijnë:

- regjistrimin e huasë së humbur si "humbje nga huatë e pakthyeshme" (llogaria 656): Debitohet llogaria 656, kreditohet llogaria 2 ... (huaja);
- regjistrimin e mbulimit të huasë së humbur nga institucioni ndërkombëtar si e ardhur e jashtëzakonshme "të ardhura nga shlyerja e huave të humbura prej të tretëve" (llogaria 762): debitohet llogaria 1# (arka ose llogaria korente", kreditohet llogaria 762.

2.3.3. KREDI ME LLOGARI TË ZBULUAR

Bankat mund të regjistrojnë një kufi kredi për huanë dhënë në llogari të zbuluar. Regjistrimi do të bëhet në formën e një angazhimi jashtë bilancit në kohën kur miratohet. Angazhimi duhet të korrektohet sa herë që përdoret kredia dhe/ose rimbursohet ajo në përputhje me veprimet

të cilat janë regjistruar në bilanc. Në mbyllje, regjistrimet në angazhimin jashtë bilancit duhet të stornohen për të anuluar autorizimin e kredisë.

2.3.4. RISTRUKTURIMI DHE RISKADENCIMI I BORXHEVE

Huatë mund të jenë objekt i një ristrukturimi ose riskadencimi. Kushtet (shuma, norma e interesit, periudha e maturimit ...) pësojnë një ose disa ndryshime nisur nga vështirësitë financiare me të cilat është ballafaquar debitori. Modifikime të tilla janë rezultat ose i vendimit të gjyqit ose i shlyerjes së kontratës së re.

Një veprim i tillë duhet regjistruar si më poshtë:

1. banka do të fshijë (anulojë) huanë e mëparshme të konsideruar si me rrezik dhe do të përcaktojë huanë e re. Në përputhje me Rregullin Nr. 7/3, datë 26.02.1997, huatë e ristrukturuara nuk do të trajtohen si hua standarde nga ana e bankave duke e pezulluar gjendjen e kënaqshme. Kur ndryshimet përfshijnë uljen e shumës së detyrimit, humbjet e shkaktuara nga kryegjëja dhe interesat kalohen menjëherë në pasqyrën e të ardhurave si hua të humbura;
2. fondet rezervë duhet të shqyrtohen në përputhje me rrezikun e ri që i bashkëngjitet ristrukturimit.

Kur ristrukturimi synon vetëm modifikimin normës së interesit, interesi regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave në përputhje me kushtet e reja.

2.3.5. DEPOZITIMI I NJË ÇEKU NË VALUTË NË FAVOR TË NJË KLIENTI

Çeqet në valutë duhet të kontabilizohen në të njëjtën mënyrë si çeqet në monedhën e vendit me dallimin që regjistrimet do të bëhen në ditarët në valutë.

2.3.6. LETËRKREDIA

Në kontekstin e veprimeve të eksport-importit, banka mund të luajë rolin e bankës së importuesit ose bankës së eksportuesit. Veprimet që bëhen ndërmjet dy bankave janë si më poshtë:

A) Nëse banka shqiptare është banka e importuesit:

Hapi 1. Nënshkruhet kontrata e import-eksportit ndërmjet 4 palëve: eksportuesit, importuesit dhe dy bankave. Banka e importuesit bllokon llogarinë e paguar nga klienti duke:

- Debituar llogarinë rrjedhëse të klientit, 27;
- Kredituar llogarinë për mbulimin e letërkredive, 284.

Hapi 2. Midis dy bankave është pranuar që banka e eksportuesit do të bllokojë shumën që do të paguhet nga banka e importuesit. Regjistrimet në këtë rast janë:

- Kreditohet llogaria rrjedhëse e bankës, 13;
- Debitohet llogaria e garancisë paguar bankës, 1812.

Hapi 3. Kur banka e importuesit bën të vlefshme dokumentet e eksportuesit të marra prej bankës së tij dhe në datën kur duhet të bëhen pagimet, regjistrimet janë:

- Debitohet llogaria e mbulimit të letërkredive, 284;
- Kreditohet llogaria e garancisë paguar bankave.

B) Nëse banka shqiptare është banka e eksportuesit:

Hapi 1. Nënshkruhet kontrata e import-eksportit ndërmjet 4 palëve: eksportuesit, importuesit dhe dy bankave. Nuk bëhet asnjë regjistrim.

Hapi 2. Midis dy bankave është pranuar që banka e eksportuesit do të bllokojë shumën që do të paguhet nga banka e importuesit. Regjistrimet në këtë rast janë:

- Kreditohet llogaria rrjedhëse e bankës, 13;
- Debitohet llogaria e garancisë marrë bankës, 1823.

Hapi 3. Kur banka e importuesit bën të vlefshme dokumentet e eksportuesit të marra prej bankës së tij dhe në datën kur duhet të bëhen pagimet, regjistrimet janë:

- Debitohet llogaria e mbulimit të letërkredive marrë nga banka, 1823;
- Kreditohet llogaria rrjedhëse e klientit, 26.

Nëse në kontratën origjinale të nënshkruar midis katër palëve, banka e importuesit nuk angazhohet që të paguajë bankën e eksportuesit, duhet të bëhen regjistrimet jashtë bilancit (angazhimet e dhëna të financimit). Në mënyrë të ngjashme, nëse banka e eksportuesit e angazhon veten drejt klientit (eksportuesit) për ta paguar atë sipas të gjitha kushteve dhe për të siguruar fondet e marra, duhet të bëhen regjistrimet jashtë bilancit (garancitë e dhëna).

SEKSIONI 3: VEPRIMET ME LETRA ME VLERË

3.1 FUSHA E ZBATIMIT

Për qëllime të paraqitjes kontabël do të konsiderojmë letra me vlerë sa më poshtë:

- aksionet e emetuara në Shqipëri dhe vende të tjera;
- bonot e thesarit të emetuara në Shqipëri dhe vende të tjera;
- instrumente të tregut ndërbankar, në veçanti dëftesa premtimi të negociueshme, certifikata ndërbankare dhe instrumente të të njëjtit lloj të emetuara në vende të tjera;
- dhe, në përgjithësi, të gjitha të drejtat e përfaqësuara nga një letër me vlerë e negociueshme në treg.

Ka dy lloje letrash me vlerë:

- letra me vlerë me të ardhura të pandryshueshme;
- letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme.

Letrat me vlerë me të ardhura të pandryshueshme:

Letrat me vlerë me të ardhura të pandryshueshme janë letra me vlerë me normë interesi të pandryshueshme ose të ndryshueshme, në këtë rast ndryshimi varet nga parametëri i përcaktuar në kohën e emetimit, duke iu referuar normave të interesit në fuqi, në data të caktuara ose për periudha të caktuara, në një treg të specifik (siç janë obligacionet me normë të pandryshueshme, obligacionet me normë të ndryshueshme, obligacionet e konvertueshme etj.).

Letrat me vlerë me të ardhura të ndryshueshme:

Letrat me vlerë me të ardhura të ndryshueshme janë të gjitha letrat me vlerë të ndryshme nga letrat me vlerë me të ardhura të pandryshueshme (siç janë aksionet të cilat i japin të drejta të përftimit të dividendit, i cili është i ndryshueshëm etj.).

Kur letrat me vlerë japin të drejtë edhe në kapitalin e një ndërmarrjeje duke krijuar një lidhje për një kohë të gjatë me ndërmarrjen dhe duke synuar që të kontribuojnë në aktivitetet e institucionit, letrat me vlerë do të regjistrohen në llogaritë e mjeteve të qëndrueshme si filiale ose interesa pjesëmarrës (shih seksionin 4).

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

1.2 Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rifinancim nga banka qendrore
3.1 Letra me vlerë me të ardhura fikse
3.2 Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme
3.3 Borxhe që përfaqësohen nga letra me vlerë
3.4 Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes

Jashtë bilancit

9.2 Angazhimet në letrat me vlerë
9.2.1 Letra me vlerë për t'u dhënë
9.2.2 Letra me vlerë për t'u marrë
9.2.3 Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose një rifinancim
9.2.4 Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose një rifinancim
9.2.5 Letra me vlerë të marra hua
9.2.6 Letra me vlerë të dhëna hua
9.2.8 Angazhime në llogarinë kundërparti të letrave me vlerë

Pasqyra e të ardhurave

6.0.1.3 Shpenzime për interesa nga borxhet e përfaqësuara prej letrave me vlerë
6.0.1.4 Shpenzime për interesa nga borxhet e varura
6.0.1.5 Shpenzime për interesa nga letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes
6.0.2 Shpenzime dhe humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet e tjera financiare
6.0.2.1 Humbje nga bonot e thesarit dhe bonot e tjera të përshtatshme për rifinancim me bankën qendrore
6.0.2.2 Humbje nga veprimet me letrat e tjera me vlerë
6.0.2.7 Shpenzime të tjera për veprimet financiare
6.0.3.3 Shpenzime për komisione nga borxhet e përfaqësuara nga letrat me vlerë
6.0.3.4 Shpenzime për komisione nga borxhet e varura
6.0.3.5 Shpenzime për komisione nga letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes
7.0.1.5 Të ardhura nga interesat për letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes
7.0.2 Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprime të tjera financiare
7.0.2.1 Të ardhura nga bonot e thesarit
7.0.2.1 1 Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme
7.0.2.1 2 Të ardhura nga letrat me vlerë të vendosjes
7.0.2.1 3 Të ardhura nga letrat me vlerë të investimit

7.0.2.2 Të ardhura nga veprimet me letrat e tjera me vlerë
7.0.2.2 1 Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme
7.0.2.2 2 Të ardhura nga letrat me vlerë të vendosjes
7.0.2.2 3 Të ardhura nga letrat me vlerë të investimit
7.0.2.7 Të ardhura të tjera nga veprimet financiare
7.0.3.5 Shpenzime për komisione për letrat me vlerë të shitura `sipas marrëveshjeve të riblerjes

3.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Në bilancin e institucionit në lidhje me kohën e transferimit të pronësisë së letrave me vlerë do të bëhen regjistrimet kontabël të përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm.

Në rastin e letrave me vlerë me të ardhura fikse, transferimi i pronësisë mund të mos konsiderohet se është zhvilluar përpara datës së përdorur për përcaktimin e shumës së interesit të përllogaritur por të pamaturuar për shitësin.

Kur data e transferimit të pronësisë është më vonë se sa data e tregtimit, letrat me vlerë , përkohësisht, do të regjistrohen si zëra jashtë bilancit dhe do të vlerësohen në përputhje me kategorinë e letrave me vlerë në fjalë.

Sapo të jenë filluar veprimet me letrat me vlerë, banka do t'i regjistrojë ato në sistemet e informimit kontabël në përputhje me faktin nëse ato janë letra me vlerë të tregtueshme, letra me vlerë të vendosjes ose letra me vlerë të investimit si dhe sipas karakteristikave të tyre.

Çmimi i tregut që i referohet paragrafëve të mëposhtëm do të përcaktohet si më poshtë:

- letrat me vlerë të listuara, të përcaktuara në Lekë ose në valuta do të vlerësohen me çmimin më të fundit;
- letrat me vlerë të palistuara do të vlerësohen me vlerën e tyre të mundshme të tregtimit.

3.2.1 LETRA ME VLERË TË TREGTUESHME

Letrat me vlerë do të konsiderohen si letra me vlerë të tregtueshme kur ato përftohen ose shiten që në fillim, me synim për t'u rishitur ose riblerë për një periudhë afatshkurtër, dhe kur:

- ato janë të negociueshme në një treg, likuiditeti i të cilit mund të konsiderohet si i siguruar, në veçanti nga prezenca e institucioneve që dominojnë tregun dhe që sigurojnë kuotime të vazhdueshme çmimi në blerje dhe shitje me hapësira që janë në harmoni me përdorimin e tregut ose, nëse nuk realizohet kjo, kryhen veprime për shuma të konsiderueshme në letra me vlerë

me ndjeshmëri tregtie të ngjashme në të cilën domosdoshmërisht ndikon tregtimi në letrat me vlerë në fjalë;
- çmimet e tregut të letrave me vlerë në fjalë janë gjithë kohës të disponueshme për të tretët dhe mbahen nga banka si evidencë justifikuese kur përpilohen llogaritë.

Banka duhet periodikisht të rishikojë klasifikimin e letrave me vlerë të tregtueshme dhe duhet në çdo rast të veprojë në këtë mënyrë, në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave.

Në vijim të këtij rishikimi ose të paktën pasi ato janë mbajtur për 6 muaj, letrat me vlerë të poseduara do të zhvendosen përgjithmonë nga letrat me vlerë të tregtueshme dhe do të regjistrohen në llogaritë si letra me vlerë të vendosjes ose letra me vlerë të investimit.

Letrat me vlerë të tregtueshme do të regjistrohen në llogaritë për datën e përftimit dhe me çmimin e tyre të përftimit, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përllogaritur.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrës, letrat me vlerë do të vlerësohen me çmimin më të fundit të tregut. Shuma e përgjithshme e diferencave që rezulton nga ndryshimet e çmimit do të regjistrohet në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve dhe regjistrimet kontabël përmbysen në ditën e parë të periudhës së re.

Kur letrat me vlerë riklasifikohen nga letra me vlerë të tregtueshme në letra me vlerë të vendosjes ose letra me vlerë të investimit, do të regjistrohen me çmimin e tregut mbizotërues në datën e transferimit.

3.2.2 LETRA ME VLERË TË VENDOSJES

Letrat me vlerë do të konsiderohen si letra me vlerë të vendosjes kur janë përftuar me synim mbajtjen e tyre për një periudhë prej më shumë se 6 muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë me të ardhura fikse për të cilat banka synon t'i posedojë deri në datën e maturimit dhe të cilat kënaqin rregullat që kanë të bëjnë me letrat me vlerë të investimit.

Letrat me vlerë të vendosjes, gjithashtu do të përfshijnë letra me vlerë të cilat nuk mund të regjistrohen as si letra me vlerë të tregtimit as si letra me vlerë të investimit, në veçanti:

- letra me vlerë të regjistruara më parë si letra me vlerë të tregtueshme dhe të transferuara si letra me vlerë të vendosjes;
- letra me vlerë të përftuara me synim rishitjen e tyre brenda një periudhe prej më pak se 6 muaj, por të riklasifikuara si të vendosjes për t'u shitur për shkak të mungesës së tregut likuid dhe të përhershëm për këto letra me vlerë;
- letra me vlerë me të ardhura fikse, të përftuara me synim që

të mbahen deri në maturim por për të cilat institucioni nuk ka burime financimi ose mbrojtjeje të specifikuara në pjesën që lidhet me letrat me vlerë të investimeve.

Letrat me vlerë të mbajtura për shitje do të regjistrohen për datën e përftimit dhe me çmimin e tyre të përftimit përjashtuar shpenzimet. Nëse ato ishin regjistruar më parë si letra me vlerë të tregtueshme, ato do të regjistrohen me çmimin e tregut që mbizotëron në datën e transferimit. Bankat do të paraqesin veçmas, nëse është e mundshme, në llogaritë e dhëna në anekset çdo interes të përllogaritur të regjistruar kur përftohen letrat me vlerë.

Kur çmimi i përftimit për letrat me vlerë me të ardhura fikse ndryshon nga çmimi i shitjes, banka mund të zgjedhë ose amortizimin e diferencës ose ta regjistrojë atë si të ardhur, nëse është e përshtatshme, përgjatë periudhës që mbetet për letrat me vlerë. Kur zgjidhet një metodë asaj duhet t'i përmbahemi përgjithmonë dhe duhet të zbatohet për të gjitha letrat me vlerë me të ardhura fikse të vendosjes. Regjistrimi kontabël i detajuar jepet në librin e ushtrimit.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave, do të krijohen fonde rezervë, sipas grupeve homogjene të letrave me vlerë të të njëjtit lloj, kundrejt humbjeve kapitale të parealizuara që rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël, të rregulluar nëse është e nevojshme me amortizimin dhe kthimin e diferencave, siç autorizohet në paragrafin paraardhës, dhe çmimit të tregut për letrat me vlerë; në lidhje me kategoritë e tjera të letrave me vlerë nuk duhet lejuar asnjë kompensim kundrejt fitimeve kapitale të regjistruara. Fitimet kapitale të parealizuara nuk do të regjistrohen. Me qëllim që të konsiderohen si të të njëjtit lloj, letrat me vlerë me të ardhura fikse duhet të kenë karakteristika homogjene në lidhje me ndjeshmërinë tyre ndaj ndryshimeve të normës së interesit dhe në lidhje me cilësinë e emetuesit, dhe letrat me vlerë me të ardhura të ndryshueshme të sigurojnë të drejta të njëjta.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave, institucionet do të përdorin nënllogari me qëllim që të regjistrohet interesi që është përllogaritur qysh nga përftimi i letrave me vlerë me të ardhura fikse.

3.2.3 LETRA ME VLERË TË INVESTIMIT

Letrat me vlerë me të ardhura fikse me një çmim shitjeje fiks do të konsiderohen si letra me vlerë të investimit kur ato përftohen me synim mbajtjen e tyre për një periudhë afatgjatë, në parim deri në maturitet.

Bankat të cilat regjistrojnë letrat me vlerë si letra me vlerë të investimit duhet të kenë burime të mjaftueshme për t'i siguruar ato:

- ose faktikisht për të poseduar letrën me vlerë për një periudhë afatgjatë, në veçanti duke siguruar fonde që në total

harmonizohen dhe cilësohen për financimin e këtyre letrave me vlerë;

- ose për të mbrojtur vetveten në të gjitha kohët kundrejt rënieve të vlerës së letrave me vlerë për shkak të ndryshimeve në normën e interesit me anë të transaksioneve me mjetet mbrojtëse që marrin formën e blerjeve ose shitjeve të kontratave të ardhme financiare për normat e interesit. Në këtë rast, karakteristikat e veprimeve shoqëruese do të jenë homogjene në lidhje me ndjeshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve të normës së interesit. Nëse veprimi mbrojtës është kryer me mjetet e instrumenteve të tregut në të cilin banka është likuide jo në mënyrë të mjaftueshme, pozicioni financiar i bankës duhet të jetë i tillë që të sigurohet se kjo pamjaftueshmëri do të kapërcehet. Këto kushte do të zbatohen për transaksionet mbrojtëse të kryera me anë të mjeteve të tilla si kontratat e ardhme financiare të tregtuara në tregjet e organizuara ose tregjet nëpërmjet banakut dhe për transaksionet mbrojtëse të kryera me anë të mjeteve të tilla siç janë kontratat e shkëmbimeve të normave të interesit.

Nëse banka nuk i ka burimet e përcaktuara më sipër për financim ose mbrojtje, letrat me vlerë do të regjistrohen si letra me vlerë të vendosjes.

Letrat me vlerë të investimit do të regjistrohen në datën e përftimit dhe me çmimin e përftimit, përjashto shpenzimet. Nëse ato ishin regjistruar më parë si letra me vlerë të tregtueshme ose të vendosjes, atëherë ato do të regjistrohen me çmimin e tregut që mbizotëron ditën e transferimit.

Kur çmimi i përftimit të letrave me vlerë me të ardhura fikse është më i lartë se sa çmimi i realizimit, diferenca do të amortizohet gjatë periudhës që mbetet për letrat me vlerë. Kur çmimi i përftimit i letrave me vlerë me të ardhura të pandryeshueshme është më i ulët se sa çmimi i realizimit, diferenca do të regjistrohet si e ardhur gjatë periudhës që mbetet për letrat me vlerë.

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, nuk duhet bërë asnjë shpenzim për fond rezervë kundrejt humbjeve kapitale të parealizuara që krijohen nga diferenca midis vlerës kontabël, të rregulluar për amortizimin dhe regjistrimin e diferencave të specifikuara më sipër, dhe çmimit të tregut të letrave me vlerë me të ardhura fikse, nëse nuk ka gjasa që banka të mos i mbajë këto letra me vlerë deri në maturitet për shkak të rrethanave të reja ose nëse ekziston rreziku i mosplotësimit të detyrimit nga emetuesi i letrave me vlerë; nëse vërehet ky rast, do të regjistrohet fondi rezervë në llogarinë 3138. Fitimet kapitale të parealizuara nuk do të regjistrohen në llogari.

Në çdo ditë kontabël të hartimit të pasqyrave banka do të përdorë nënllogaritë për të regjistruar tek të ardhurat interesat e përllogaritur midis pagesës të datës së fundit të interesit dhe datës së mbylljes.

3.3. RASTE TË VEÇANTA

3.3.1.VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË: SHITJET, HUADHËNIET, HUAMARRJET, MARRËVESHJET E RIBLERJES, MUNDËSITË E RIBLERJES DHE ANGAZHIME TË TJERA

Letrat me vlerë të përfshira në portofolin e letrave me vlerë të bankës mund të kenë zanafillën nga ose mund të transferohen në një bankë ose institucion krediti tjetër si rezultat i veprimeve të mëposhtme:

- një shitje ose blerje me marrëveshje riblerje,
- një shitje ose blerje pa të drejtë kërkimi,
- një shitje ose blerje me të drejtë kërkimi,
- një shitje ose blerje me një mundësi riblerjeje,
- një huadhënie ose huamarrje letrash me vlerë,
- letra me vlerë të dhëna ose të marra si një garanci për një kredi të një financimi.

Paragrafët e mëposhtëm trajtojnë parimet e kontabilitetit dhe rregullat e zbatueshëm për secilin nga këto veprime.

Shitja dhe blerja me një marrëveshje riblerjeje ("Repo")

Disa kontrata shitjesh mund të sigurojnë që shitësi të angazhojë veten për të riblerë letrën me vlerë me një çmim të përcaktuar (specifikuar) dhe në një datë të specifikuar ose brenda një periudhe të specifikuar. Kjo lloj kontrate është përdorur zakonisht nga shitësi për të fituar fondet në këmbim të aktiveve gjatë një periudhe të shkurtër kohe duke siguruar që shitësi ka si synim rifitimin e pronësisë mbi mjetin (aktivin). Zakonisht blerësi paguan interesa për fondet e marra (njësoj sikur të ishte huamarrje faktike) dhe ruan të drejtat mbi interesat ose të ardhurat që shoqërojnë letrën me vlerë.

Për këto arsye, ky transaksion nuk konsiderohet si një nxjerrje e aktivit jashtë përdorimit dhe letrat me vlerë, subjekt i kësaj kontrate, mbahen në librat e shitësit në kategorinë e tyre fillestare siç përcaktohet në paragrafët e mëparshëm. Të ardhurat nga shitja regjistrohen si një detyrim në llogarinë "letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes" (1215 në rastin e bonove të thesarit, 3421 në rastin e bonove jo të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore). Interesi i përllogaritur llogaritet mbi këtë detyrim sepse ato i detyrohen blerësit. Interesat e përllogaritur për letrat me vlerë (letër me vlerë me të ardhura fikse) kontabilizohet si edhe çdo letër tjetër me vlerë.

Angazhimi për të riblerë letrën me vlerë regjistrohet në llogarinë jashtë bilancit "letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose rifinancim".

Blerësi nuk do të regjistrojë letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjes së riblerjes në bilancin e tij dhe do të regjistrojë shumat e paguara si

një aktiv në llogarinë 34 "letra me vlerë e shitur sipas marrëveshjes së riblerjes".

Shitje pa të drejtë kërkimi

Shitja e letrave me vlerë pa të drejtë kërkimi do të konsiderohet si transferim i një aktivi kundrejt pagesës për të cilin blerësi ose shitësi në çdo rrethanë sapo të përfundohet shitja nuk mund të ushtrojnë ndonjë të drejtë kërkimi ndaj njëri-tjetrit. Ky është lloji mbizotërues i transaksionit për pjesën më të madhe të tregtimit, investimeve dhe disponueshmërisë për letrat me vlerë për shitje.

Letra me vlerë që është shitur është fshirë nga bilanci datën e transferimit faktik të saj. Diferenca neto midis vlerës kontabël të aktivit të shitur dhe të ardhurave të krijuara nga shitja regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave. Fondet rezervë për zhvlerësim, skontot dhe tepricën e interesave të përllogaritur të blerë në lidhje me aktivin e shitur fshihen nga pasqyra e llogarive të fitimeve dhe humbjeve.

Blerësi do të regjistrojë letrat me vlerë në bilancin e tij me shpenzimet e përftimit siç përshkruhet në paragrafët e mësipërm.

Shitje me të drejtë kërkimi

Një shitje me të drejtë kërkimi mund të konsiderohet si transferim i një aktivi kundrejt pagesës për të cilin blerësi mund të ushtrojë të drejtën e kërkimit kundrejt shitësit në rrethana të caktuara të dhëna në kontratën e shitjes. Trajtimi i zbatueshëm kontabël është i njëjtë me atë të përshkruar në paragrafët e mëparshëm. Përveç kësaj, shitësi duhet të regjistrojë angazhimin e tij për blerësin dhe blerësi duhet të regjistrojë angazhimin e marrë nga shitësi në llogarinë jashtë bilancit si "angazhime të tjera të marra ose të dhëna". Për të specifikuar këtë lloj veprimi mund të jetë e përshtatshme që në grupin e llogarive "angazhime të tjera" të krijohen nënllogari.

Ky angazhim mund të bëhet, për shembull, garanci e dhënë nga shitësi për blerësin kundrejt rrezikut të mosshlyerjes së detyrimeve nga emetuesi i letrave me vlerë.

Në datën e mbylljes, shitësi do të vlerësojë rrezikun që ekziston që garancia e tij të ekzekutohet dhe për këtë mund të regjistrohet një "fond rezervë për humbjet e mundshme në lidhje me angazhimin e dhënë". Blerësi do të vlerësojë rrezikun e mospërmbushjes së detyrimit nga emetuesi dhe mund të zhvlerësojë letrat me vlerë në përputhje me këtë, pasi të marrë në konsideratë garancinë e marrë dhe mundësinë për të realizuar këtë garanci.

Shitja me një mundësi riblerjeje

Disa kontrata i sigurojnë shitësit një mundësi riblerje të letrave me vlerë në një datë të caktuar ose brenda një periudhe të caktuar dhe me një çmim të caktuar.

Mund të jetë një praktikë profesionale që këto mundësi të ushtrohen gjithmonë. Në këtë rast trajtimi kontabël që do të zbatohet është "shitje me marrëveshje riblerjeje" i përshkruar si më sipër. Përveç kësaj shitësi duhet të vlerësojë vlerën e tregut të letrave me vlerë të shitura dhe regjistron një fond rezervë për të marrë parasysh diferencën midis vlerës së tregut të letrave me vlerë dhe marrëveshjen lidhur me çmimin e blerjes.

Nëse një praktikë e tillë nuk ekziston ose nëse ka rrezik që kjo mundësi të mos ushtrohet, trajtimi kontabël do të jetë i ngjashëm me atë të zbatuar për një shitje (letrat me vlerë janë fshirë nga bilanci dhe fitimi ose humbja kontabilizohet në pasqyrën e të ardhurave). Angazhimi i marrë nga blerësi do të regjistrohet jashtë bilancit tek "angazhimet e tjera". Blerësi do të regjistrojë një fond rezervë për diferencën midis vlerës kontabël në librin e tij në fund të vitit dhe çmimit të ushtrimit nëse kjo është më e ulët.

Huadhënia dhe huamarrja e letrave me vlerë

Huadhënia e letrave me vlerë përfaqëson një transaksion me anë të të cilit një bankë i jep hua disa letra me vlerë një banke ose një institucioni krediti tjetër. Letrat me vlerë të dhëna hua mbeten pronë e huadhënësit dhe mbahen në librat e huadhënësit në kategorinë e tij fillestare. Huadhënësi regjistron vlerën kontabël të letrave me vlerë të dhëna hua jashtë bilancit si "letra me vlerë të dhëna hua". Huamarrësi regjistron vlerën kontabël të letrave me vlerë të marra hua jashtë bilancit si "letra me vlerë të marra hua".

Nëse kolaterali depozitohet nga huamarrësi tek huadhënësi ky transaksion në para fizike regjistrohet në llogarinë "kolateral i marrë në lidhje me letrat me vlerë të dhëna hua" për huadhënësin dhe "kolateral i paguar në lidhje me letrat me vlerë të dhëna hua" për huamarrësin.

Letrat me vlerë të dhëna ose të marra si garanci për një kredi financimi

Nëse letrat me vlerë jepen si garanci për një kredi ose një financim të ndryshëm nga kuadri i veprimeve të përshkruara më sipër, këto letra me vlerë mbahen në bilanc dhe vlera e tregut e letrave me vlerë e dhënë si garanci jepet në llogarinë jashtë bilancit: Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose financim.

Nëse letrat me vlerë merren si garanci për një kredi ose një financim për një qëllim të ndryshëm nga ai i kuadrit të veprimeve të përshkruara

më sipër, këto letra me vlerë nuk regjistrohen në bilanc dhe vlera e tregut e letrave me vlerë e marrë si garanci jepet në llogarinë jashtë bilancit: Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose financim.

3.3.2. LETRAT ME VLERË ME INTERES TË PARAPAGUAR

Kur interesi parapaguhet, shuma emërore mund të tejkalojë shumën e lëvruar nga banka. Në rastin e shumës emërore regjistrohet në llogarinë e (kryegjësë) letrave me vlerë dhe interesi i parapaguar regjistrohet në një llogari të veçantë "të ardhura nga interesi i përllogaritur" si kredi në anën e mjeteve. Interesi i llogaritur për periudhën regjistrohet tek të ardhurat dhe zbritet nga shuma e interesit të parapaguar.

SEKSIONI 4:INTERESAT PJESËMARRËS DHE FILIALET

4.1 FUSHA E ZBATIMIT

Filialet përfaqësojnë pjesë pronësie (aksione etj.) në kapitalin e shoqërive të cilat banka ka për qëllim t'i mbajë për një periudhë të gjatë kohe dhe të cilat gjykohen si të dobishme për veprimtarinë e bankës. Në parim pjesa e kapitalit të poseduar duhet të kalojë 10%. Kur një bankë posedon më shumë se 50% të filialit, filiali konsiderohet në varësi të bankës.

Interesat pjesëmarrës janë investime në kapital ku pjesa e pronësisë përfaqëson më pak se 10% të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria ka një synim konstant për të ruajtur nivelin e pronësisë për një periudhë afatgjatë, shoqëria emetuese posedon pjesë të aksioneve të emetuara nga banka ose shoqëria i përket të njëjtit grup.

Përndryshe këto aksione klasifikohen si letra me vlerë të vendosjes (shih seksionin 3).

Një ndërmarrje e përbashkët është një sipërmarrje ku dy ose disa shoqëri vendosin të kryejnë veprimtari të përbashkët që rezulton nga një interes i përbashkët. Shoqëritë vendosin të ndajnë fitimet dhe humbjet. Në këtë rast aksionet e ndërmarrjes së përbashkët nuk klasifikohen si filiale por klasifikohen si llogari e përbashkët.

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

5.1	Interesat pjesëmarrës
5.1.1	Interesat pjesëmarrës
5.1.2	Ndërmarrjet e përbashkëta
5.1.8	Fonde rezervë për zhvlerësim
5.2	Filialet
5.2.1	Filialet
5.2.8	Fonde rezervë për zhvlerësim
9.0	Angazhime financimi
9.1	Garancitë
9.4	Angazhime të tjera

Plus llogaritë kundërparti jashtë bilancit:

Pasqyra e të ardhurave

6.0.5.3	Humbje nga shitja e interesave pjesëmarrës dhe letrave me vlerë të filialit.

6.5.5 Shpenzimet per fondet rezervë për amortizim për interesat pjesëmarrës dhe letrat me vlerë të filialeve.
7.0.2.3 Të ardhura nga interesat pjesëmarrës dhe letrat me vlerë të filialeve.
7.0.5.3 Fitime nga shitja e interesave pjesëmarrës dhe letrave me vlerë të filialeve.
7.5.5 Transferimi i fondeve rezervë për interesat pjesëmarrës dhe letrat me vlerë të filialeve.

4.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Vlera kontabël fillestare

Aksionet kontabilizohen me çmim blerjeje, domethënë, me çmimin me të cilin ato u përftuan ose me vlerën e përcaktuar nga afati i kontratës së përftimit. Shpenzimet e përftimit (siç janë komisionet apo kuotat konsultuese ose ligjore), nuk janë përfaqësuese të vlerës së tregut, regjistrohen drejtpërdrejt si shpenzime.

Vlerësimi

Në datën e mbylljes, duhet bërë përcaktimi i vlerës reale të aksioneve dhe interesit pjesëmarrës të filialeve dhe ndërmarrjeve të përbashkëta. Vlera reale përfaqëson vlerën, të cilën një drejtues përgjegjës dhe i informuar do të pranonte të paguante për të përftuar interesat ose aksionet. Për të kryer këtë vlerësim mund të merren parasysh elementet e mëposhtme:

- kriteret objektive (çmimet e bursës, pjesa e kapitalit pronar neto, kapitali pronar neto i korrektuar, rentabiliteti dhe kështu me rradhë);
- perspektivat (perspektivat e rentabilitetit, e shitjes, situata ekonomike dhe kështu me radhë);
- elemente subjektive (dobishmëria për kompaninë që posedon aksionet etj.).

Kur mund të parashikohet që vlera reale e përcaktuar në këtë mënyrë do të mbetet më e ulët se sa vlera kontabël neto për periudhë afatgjatë, duhet të regjistrohet fondi rezervë për amortizim.

Për pasojë, fondet rezervë të krijuara më parë të cilat nuk zbatohen më duke patur të dhënë një vlerësim më të favorshëm të vlerës reale, duhet të stornohen në fitim. Kur perspektivat e favorshme justifikojnë vendimin për të mos amortizuar vlerën kontabël të një interesi pjesëmarrës ose të aksioneve të filialeve ose ndërmarrjeve të përbashkëta është e qartë se duhet sfiduar një perspektivë e tillë dhe llogaritjet duhet të bëhen duke përdorur të njëjtën mënyrë me nivelin aktual të fitimit dhe objektivave dhe parashikimin e arsyeshëm.

Njohja e të ardhurave

Dividentët ose dividentët e ndërmjetëm kontabilizohen si "e ardhur nga interesat pjesëmarrës dhe letrat me vlerë të filialeve" për shumën neto të marrë (duke përjashtuar kreditimin taksor).

Dividentët dhe dividentët periodikë regjistrohen si fitim në datën që ato shpallen zyrtarisht nga organizmat ligjorë të kompanisë (mbledhja e aksionerëve, Këshilli i Drejtorëve).

Shitja dhe tërheqja

Diferenca neto midis çmimit të shitjes dhe vlerës kontabël të interesit pjesëmarrës ose aksionet e filialeve ose ndërmarrjes së përbashkët në datën e shitjes regjistrohet si "fitim nga shitjet e filialeve dhe interesave pjesëmarrës" kur është pozitive dhe si "humbje nga shitjet e filialeve dhe interesat pjesëmarrës" kur është negative. Vlera kontabël përpara fondeve rezervë llogaritet dhe përcaktohet në përputhje me metodën FIFO (Hyn i pari del i pari).

Çdo fond rezervë i krijuar më parë anulohet në pasqyrën e të ardhurave.

SEKSIONI 5: MJETET E TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA

5.1 FUSHA E ZBATIMIT

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kategorizohen në pesë grupe:

- Mjete të patrupëzuara.
- Mjete të trupëzuara që përdoren për veprimtarinë e përditshme.
- Mjete të qëndrueshme të mbajtura për investime.
- Mjete të qëndrueshme të mbajtura për operacione qiradhënieje.
- Mjete të qëndrueshme në proces.

Mjete të patrupëzuara

Në pjesën më të madhe ato përbëhen nga elemente të tilla që përfaqësojnë fondet tregtare, e drejta e qirasë, të drejtat e votës, licencat, patentat tregtare, teknikat, programet kompjuterike të përftuara ose të projektuara për përdorim të brendshëm.

Shpenzimet e nisjes dhe shpenzimet e paraveprimtarisë, nëse mendohet se janë të nevojshme për nisjen e biznesit, mund të kapitalizohen dhe llogariten si "mjete të patrupëzuara". Ato amortizohen përgjatë një periudhe pesëvjeçare me këste të barabarta.

Mjete të trupëzuara që përdoren për veprimtarinë e përditshme

Mjetet e trupëzuara përbëhen nga pronat, aparatet dhe pajisjet të cilat janë objekt i një të drejte pronësie dhe posedohen nga banka për prodhimin e shërbimeve të saj bankare.

Mjete të qëndrueshme të mbajtura si investime

Ato ndryshojnë nga dy kategoritë e para sepse nuk posedohen nga shoqëria për vete por mbahen si investime. Ndërtesat dhe trojet e blera nga pikëpamja e të qenurit të rishitshme kundrejt një fitimi, do të përfshihen në këtë kategori. Megjithatë, ndërtesat dhe trojet e blera nëpërmjet një procedure ligjore konsiderohen si rezerva.

Mjete të qëndrueshme të mbajtura për veprime qiraje (lising)
Shih seksionin 11

Mjete të qëndrueshme në proces

Mjetet e qëndrueshme të cilat nuk janë dorëzuar ose nuk janë vënë në shërbim ende dhe procesi i ndërtimit të të cilave është në progres, regjistrohen si "mjete të qëndrueshme në proces".

Pagesat dhe paradhëniet në vijim për furnitorët lidhur me mjetet e qëndrueshme të cilat ende nuk janë dorëzuar ose vënë në shërbim, regjistrohen në kategorinë mjete të qëndrueshme në proces. Shumat e paguara trajtohen si investime të periudhës dhe kontabilizohen si të ishin blerje (përftime) përfundimtare.

Mjetet e qëndrueshme në proces nuk amortizohen

Kur dorëzohen ose vihen në shërbim shuma gjithsej e regjistruar trajtohet si mjet i qëndrueshëm dhe riklasifikohet në kategorinë korresponduese të mjeteve të qëndrueshme.

Mjetet e qëndrueshme të përdorura në procesin normal të punës, cilado qoftë natyra e tyre, përcaktohen si "në përdorim për veprimtarinë e përditshme". Kur ato nuk përdoren për një qëllim të tillë, mjetet e qëndrueshme (kryesisht mjetet e trupëzuara) do të klasifikohen në një llogari të veçantë "mjete të qëndrueshme të mbajtura si investime".

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

5.3	Mjetet e qëndrueshme
5.3.1	Mjete të patrupëzuara
5.3.2	Mjete të trupëzuara të përdorura për veprimtarinë e përditshme
5.3.3	Mjete të qëndrueshme të mbajtura si investime
5.3.4	Mjete të qëndrueshme të mbajtura për veprimet e qirasë
5.3.5	Mjete të qëndrueshme në proces
5.3.7	Amortizimi
5.3.8	Fond rezervë për amortizimin e mjeteve të qëndrueshme

Pasqyra e të ardhurave

6.4	Shpenzime për amortizimin dhe fonde rezervë për mjetet e qëndrueshme
6.4.1.	Shpenzime amortizimi
6.4.2	Fonde rezervë për amortizim
4.4.4.4.	Humbje nga shitja e mjeteve të qëndrueshme
4.4.4.5.	Fitimi nga shitja e mjeteve të qëndrueshme

5.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Vlera kontabël

Mjetet e qëndrueshme kontabilizohen nga banka me dorëzimin e pajisjeve dhe mbahen në libra me koston historike, të quajtur, kosto e përftimit ose kosto prodhimi e një mjeti të prodhuar vetë.

Kosto e përftimit i korrespondon çmimit neto të blerjes plus shpenzimet e rastit që janë përfaqësuese të vlerës së tregut. Shpenzimet e rastit përbëhen nga shpenzimet që lidhen me përftimin, prej shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta duke ditur që këto lidhen me përftimin.

Shpenzimet e rastit përfshijnë:
- transportin
- detyrimet doganore
- shpenzime paraprake (përfshi pagat e punës)
- shpenzime të prishjes së një mjeti ekzistues kur paraprijnë menjëherë krijimin e një mjeti të ri
- TVSH dhe taksat e tjera të pazbritshme.

por nuk përfshijnë:
- shpenzimet e transferimit
- komisionet ligjore
- taksat e transferimit
- pjesën e shpenzimeve të përgjithshme
- çdo shpenzim që nuk përfaqëson vlerën e tregut
- TVSH e cila mund të zbritet.

Këto shpenzime (të ndryshme nga TVSH) përfaqësojnë shpenzime të cilat mund të kapitalizohen dhe të amortizohen për pesë vjet. Në këtë rast ato kontabilizohen si shpenzime që duhen amortizuar për disa vite në llogaritë e grupit të aktiveve të tjera (llogaria 4193).

Shpenzimet e përmirësimit të një mjeti kryesor (mirëmbajtja dhe riparimet aktuale) mund të kapitalizohen vetëm nëse shpenzime të tilla ndihmojnë të rrisin jetën e shërbimit të një mjeti ose vlerën e tij. Shpenzimet e përmirësimit të mjeteve të marra me qira regjistrohen si shpenzime. Nëse shpenzimet i kontribuojnë rezultateve në të ardhmen për disa vite, drejtuesit e bankës mund të vendosin të amortizojnë shpenzimet gjatë disa viteve, duke regjistruar shpenzimet në llogarinë 4193 "Shpenzime për t'u amortizuar për disa vite". Nëse në këtë rast nuk ka të tilla, ato do të ngarkohen si shpenzime për periudhën gjatë së cilës janë shkaktuar.

Amortizimi

Amortizimi, i cili është i detyrueshëm, është trajtimi kontabël i amortizimit jo të kthyeshëm të mjeteve të qëndrueshme.

Të gjitha mjetet e qëndrueshme amortizohen përveç truallit, mjeteve vlera e të cilave nuk bie me kalimin e kohës dhe mjeteve të qëndrueshme në proces të cilat ende nuk përdoren.

Mjetet e qëndrueshme amortizohen në përputhje me metodën lineare. Shpenzimet vjetore i korrespondojnë vlerës bruto të një mjeti të pjesëtuar me periudhën e tij të shërbimit. Ky shpenzim bie me përqindje të caktuara kohore në vitin e përftimit dhe transferimit.

Për pasojë, amortizimi i kontabilizuar në vitin e parë nuk i korrespondon një viti të plotë por një periudhe të kaluar midis datës që mjeti u vendos në shërbim dhe datës së përfundimit. Në mënyrë të ngjashme amortizimi i kontabilizuar vitin e fundit nuk i korrespondon një viti të plotë por një periudhe të kaluar midis datës së përfundimit dhe datës kur mjeti është nxjerrë jashtë përdorimit.

Normat e amortizimit përcaktohen në përputhje me jetën e dobishme normale dhe të parashikuar të mjetit.

Jeta mesatare e shërbimit të mjeteve të mbajtura për kohën e duhur zakonisht vlerësohet në përputhje me kriteret e mëposhtme: periudhës së parashikuar për daljen jashtë përdorimit, normën e parashikuar të përdorimit, jetën e mëparshme të dobishme për aktivet e dorës së dytë.

Organizmat publikë përcaktojnë amortizimin e periudhës së përdorimit të mallrave. Më poshtë jepet një tabelë treguese e periudhës së amortizueshme në përputhje me metodën e amortizimit linear, e cila zbatohet për mjetet e qëndrueshme të trupëzuara që përdoret në praktikat e përbashkëta ndërkombëtare:

Natyra e mjeteve të qëndrueshme	Periudha e amortizueshme
Truall	nuk amortizohet
Ndërtesa	jo më shumë se 50 vjet
Konstruksione	20 - 50 vjet
Instalime dhe pajime	10 vjet
Makineri, pajisje kompjuteri	3 - 5 vjet
Mobilime dhe të tjera	5 - 10 vjet

Në përputhje me metodën lineare, amortizimi regjistrohet nga data kur mjeti është vënë në shërbim. Megjithatë, është e mundur të zgjidhet data konvencionale e vendosjes në shërbim (fundi i muajit, fundi i tremujorit, mesi i vitit etj.).

Në përputhje me planin kohor të amortizimit të përdorur kur mjeti u vu në shërbim, amortizimi do të regjistrohet në bilanc, në zbritje të aktiveve përkatëse dhe në pasqyrën e të ardhurave si shpenzim.

Dëmtimi i mjeteve

Nëse përfitimi ekonomik i vazhdueshëm i një mjeti për bankën bëhet i dyshimtë dhe nëse rrethanat që shkaktojnë mungesën e përfitimit ekonomik nuk janë të përkohshme, për mjetin krijohet një fond zhvlerësimi me vlerën faktike të realizueshme neto të tij duke rënduar shpenzimet:

642 Fond rezervë për zhvlerësim.

Regjistrimi i bërë për shkak të dëmtimit vendos një bazë të re kostoje për aktivin. Shtimet vijuese të vlerës së mjetit nuk regjistrohen deri sa mjeti të shitet po qe se nuk zbatohet një metodë rivlerësimi të përgjithshëm.

Mendohet mjeti është dëmtuar kur ai nuk mund të përdoret më gjatë për përdorim për atë qëllim për të cilin u përftua, ose sepse mjeti nuk është funksional ose sepse teknologjikisht ka dalë jashtë përdorimit ose faktorët ekonomikë bëjnë të pamundur përdorimin e mëtejshëm të mjetit.

Vlera neto e realizueshme për mjetet e përmirësuara duhet të vërtetohet nga një i tretë i pavarur kur është e mundur dhe e përshtatshme. Mjetet e dëmtuara duhen rishikuar çdo vit për të përcaktuar nëse janë të nevojshme regjistrime të tjera.

Nxjerrja jashtë përdorimit

Fshirja (vlera e mjetit, amortizimi, fondi rezervë për amortizim) regjistrohet datën e nxjerrjes së mjetit jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga nxjerrja jashtë përdorimit e një mjeti kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave në të Ardhura të Tjera ose Shpenzime të Përgjithshme të Veprimtarisë.

7054 Fitime nga shitja e mjeteve të qëndrueshme
6054 Humbje nga shitja e mjeteve të qëndrueshme.

Fitime dhe humbje të tilla rezultojnë nga diferenca midis të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit (çmimi i shitjes) dhe vlera neto kontabël e mjeteve në datën e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Nxjerrja e mjeteve të qëndrueshme jashtë përdorimit duhet të përcaktohet ose nga fatura e shitjes ose nëse prishen nga një miratim i nënshkruar nga punonjësi i autorizuar.

Inventari i mjeteve

Mjetet e qëndrueshme të paraqitura në bilanc duhet të pasqyrojnë realitetin fizik të mjeteve. Një inventar fizik i mjeteve të qëndrueshme duhet kryer të paktën një herë në vit.

Diferencat midis inventarit kontabël dhe inventarit fizik duhet të regjistrohen në llogarinë e fitimit dhe humbjes dhe mjeti korrespondues fshihet ose i shtohet bilancit.

5.3 RASTE TË VEÇANTA

Rivlerësimi i mjeteve të qëndrueshme

Me qëllim që të merren parasysh efektet e inflacionit, vlera kontabël e mjeteve të qëndrueshme mund të llogaritet për të pasqyruar vlerën aktuale të tyre në monedhën e vendit.

Rivlerësimi kryhet vetëm kur ai autorizohet në mënyrë specifike nga një organizëm ligjor.

Kur mjetet e qëndrueshme rivlerësohen, duhet rivlerësuar një klasë e tërë mjetesh ose zgjedhja e mjeteve për rivlerësim duhet bërë në bazë sistematike. Kjo bazë duhet të raportohet në politikat e bankës.

Metoda e rivlerësimit trajtohet në rregullat ligjorë. Për të dhënë shembullin e regjistrimeve kontabël të shihen shembujt.

SEKSIONI 6: NDIHMAT

6.1. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo llogari trajton dhuratat e marra nga një bankë prej shtetit ose një organizate tjetër.

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

5.4 Ndihmat dhe financimi publik
5.4 1 Ndihmat
5.4 2 Pjesa e grumbulluar e ndihmave dhe e financimit publik transferuar tek të ardhurat

Pasqyra e të ardhurave

7.0.5.5. Pjesa e ndihmave dhe e financimit publik transferuar tek të ardhurat

6.2. PERKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Kur një ndihmë i korrespondon një mjeti (për shembull, ndërtesë, bono thesari), mjeti regjistrohet në bilanc me vlerën e tij të tregut në kohën e dhënies së ndihmës kundrejt kreditimit të një llogarie detyrimi të quajtur "Ndihma" (54). Vlera e tregut mund të përcaktohet duke përdorur vlerën faktike të saj të tregut ose çmimin e saj të blerjes nga dhuruesi nëse malli është dhënë i ri. Mjeti amortizohet si çdo mjet tjetër në bazë të vlerës së tregut të dhuratës dhe gjatë periudhës së mbetur të përdorimit.

Shuma e ndihmës së regjistruar si një detyrim kalohet si e ardhur gjatë të njëjtës periudhë kohe kur mjeti amortizohet. Regjistrimet kontabël janë:

Debi 542 Pjesa e akumuluar e ndihmave dhe e financimit publik të transferuar në të ardhura.

Kredi 7055 Pjesa e ndihmave dhe e financimit publik të transferuar në të ardhura

Kjo e ardhur neutralizon efektin e amortizimit në fitimin dhe humbjen e bankës e cila pasqyron përfitimin ekonomik të ndihmës për bankën.

Një ndihmë që bëhet e arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet tashmë të shkaktuara për qëllim të dhënies së mbështetjes financiare të menjëhershme për bankën pa shpenzime të tjera që lidhen me to, regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave të periudhës në të cilën ato u

bënë të arkëtueshme, si një zë jo i zakonshëm nëse kjo është e mundur.

Ndihmat, përshi ndihmat jomonetare me vlerë reale, nuk regjistrohen deri sa të ketë siguri të arsyeshme që banka do të jetë në përputhje me kushtet që i bashkëngjiten atyre, dhe të jenë marrë ato.

Një ndihmë që bëhet e pagueshme nuk kalohet tek të ardhurat.

Kur mjetet e qëndrueshme amortizohen plotësisht, gjendja kontabël e ndihmës është zero. Kur mjeti i qëndrueshëm që i korrespondon ndihmës rivlerësohet, llogaria "ndihma" rivlerësohet sistematikisht kundrejt rezervës së rivlerësimit.

SEKSIONI 7: BURIMET E PËRHERSHME DHE FONDET PËR RREZIQET DHE SHPENZIMET

Burimet e përhershme përfshijnë kapitalin e vet të aksionerëve dhe borxhin e varur.

7.1. KAPITALI I AKSIONERËVE

7.1.1 FUSHA E ZBATIMIT

Kapitali i aksionerëve përbëhet së pari nga kapitali aksioner i paguar nga aksionerët, primet e aksioneve, rezervat, fitimet e pashpërndara dhe fitimi (humbja) i vitit ushtrimor. Së bashku me burimet e jashtme të bankës të përfaqësuara nga detyrimet e saj, këto fonde marrin pjesë në financimin e bankës dhe përfaqësojnë, nga pikëpamja e analizës së bilancit, diferencën neto midis mjeteve dhe detyrimeve të bankës. Kapitali i vet i aksionerëve nuk përfshihet në borxhet financiare.

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

5.5.	Fonde rezervë
5.5.1	Fonde rezervë për rreziqet dhe shpenzimet
5.5.8	Fonde të tjera rezervë
5.7.1	Kapitali i paguar
5.7.2	Primet e aksioneve
5.7.3	Rezervat
5.7.4	Diferenca rivlerësimi
5.7.7	Fitimet (humbjet) e pashpërndara
5.7.8	Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor

Pasqyra e të ardhurave

6.5.7	Shpenzime të tjera për fonde rezervë
7.5.7	Transferime të tjera nga fondet rezervë

7.1.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Kapitali i paguar

Kapitali aksioner përfaqëson fondet e investuara në bankë nga aksionerët për periudhë kohore të pakufizuar. Përgjithësisht, ky kapital është i pakthyeshëm po qe se nuk vendoset nga asambleja e aksionerëve. Aksionet që përbëjnë kapitalin aksioner i japin poseduesve të tyre titullin (të drejtën) për të marrë pjesë në asambletë e aksionerëve për ndarjen e fitimeve të bankës dhe për të siguruar (përftuar) një pjesë të mjeteve kur likuidohet banka.

Kapitali i paguar përfaqëson vlerën emërore të aksioneve të emetuara dhe paguara faktikisht nga aksionerët. Ai mund të përfaqësohet, gjithashtu, nga diferenca neto midis kapitalit gjithsej aksioner të nënshkruar nga banka dhe sasisë së kapitalit aksioner të papaguar ende nga aksionerët.

Primet e aksioneve

Primet e aksioneve përfaqësojnë shumën e paguar nga aksionerët në tejkalim të vlerës emërore të aksioneve të emetuara nga banka.

Rezervat

Rezervat përfaqësojnë fitimet e pashpërndara të periudhave të mëparshme të cilat mbahen nga banka për periudhë afatgjatë dhe të cilat rezultojnë nga vendimet e organizmave kompetentë (siç janë asambletë e aksionerëve) ose nga zbatimi i rregullave specifikë statutorë dhe ligjorë.

Lëvizjet që ndikojnë rezervat kontabilizohen kur organizmi kompetent (domethënë., asambleja e aksionerëve) ka miratuar shpërndarjen e fitimit për këtë periudhë.

Rezervat ndahen në katër kategori:

- Rezerva ligjore është e detyrueshme për shkak të kërkesave rregullatore specifike dhe përgjithesisht rritet, kur është e mundshme, me një përqindje të caktuar të shpërndarjes së fitimit për periudhë.
- Rezerva rivlerësimi që përfaqësojnë kundërpartinë e rivlerësimit të mjeteve të qëndrueshme në kuadrin e rivlerësimeve vullnetare (ose të kërkuara ligjërisht) të bëra nga banka, me qëllim që të korrektohet vlera bartëse e mjeteve të saj për efekt të inflacionit.
- Rezerva statutore kreditohet me shuma të tilla, nëse ka, që mund të specifikohen në statutet e bankës.
- Rezerva të tjera përfaqësojnë çdo rezervë tjetër përbërja e së cilës është miratuar në asamblenë e aksionerëve.

Diferenca rivlerësimi

Diferenca e llogarisë së rivlerësimit ka të bëjë me kapitalin në valutë. Në mbyllje, kapitali në valutë do të vlerësohet me kursin fiks të mbylljes por do të mbahet me vlerën fillestare në bilanc (llogaria 571). Diferenca midis vlerës fillestare dhe vlerës aktuale regjistrohet si diferencë në llogarinë e rivlerësimeve (llogaria 574).

Fitimet e pashpërndara

Fitimet e pashpërndara përfaqësojnë pjesë të fitimeve të akumuluara nga periudhat e mëparshme të cilat nuk janë shpërndarë në rezerva

ose shpërndarë aksionerëve në formë dividentësh. Fitimi (humbja) e vitit ushtrimor nuk përfshihet në fitimet e pashpërndara.

Lëvizjet që ndikojnë fitimet e pashpërndara kontabilizohen kur organizmi kompetent (domethënë, asambleja e aksionerëve) ka miratuar sistemimin e të ardhurave të periudhës.

Fitime të pashpërndara negative rezultojnë nga humbjet e periudhave të mëparshme që tejkalojnë fitimet e pashpërndara të periudhave të mëparshme.

7.1.3 RASTE TË VEÇANTA

Rritja e kapitalit

Rritja e kapitalit regjistrohet si një datë nënshkrimi efektive. Nëse pagesat do të bëhen në datën vijuese, llogaria "kapital i nënshkruar i papaguar" (5712) debitohet dhe llogaria "kapital i nënshkruar" (5711) kreditohet. Llogaria "kapital i nënshkruar i papaguar" kreditohet kur bëhen pagesat. I njëjti parim zbatohet edhe për llogaritë "primet e aksioneve" dhe "primet e aksioneve të papaguara".

Kontabilizimi i rritjes së kapitalit ndryshon nga natyra e kontributeve të bëra nga aksionerët:

- kontributi në para fizike: rritja e kapitalit në para fizike kontabilizohet në datën faktike të nënshkrimit;
- kontributi në natyrë, përfshirja e rezervave ose llogarive rrjedhëse: në këtë rast, rritja e kapitalit kontabilizohet sapo organi kompetent i bankës (zakonisht asambleja e aksionerëve) të ketë miratuar vendimin për rritjen e kapitalit dhe mënyrat për ta bërë atë;
- rritja që rezulton nga pagesa e dividentëve me aksione (dividendi aksioner) nëse parashikohet nga rregullat bankarë: rritja e kapitalit kontabilizohet duke ndjekur periudhën në të cilën aksionerët ushtrojnë një mundësi të pagimit të dividentëve me aksione.

Reduktimi i kapitalit

Reduktimet kapitale mund të realizohen si më poshtë:

- shitja e një pjese të aksioneve;
- blerja nga banka e aksioneve të saj me qëllim asgjësimin e tyre;
- reduktimi i vlerës emërore të aksioneve.

Reduktimi i kapitalit kontabilizohet në datën në të cilën organizmat kompetentë të bankës miratojnë reduktimin.

7.2. BORXHI I VARUR

7.2.1 FUSHA E ZBATIMIT

Kjo llogari ka të bëjë me huamarrjet e bankës të cilat, në rast likuidimi, janë të dorës së dytë kundrejt shlyerjes (rimbursimit) së kreditorëve të tjerë (domethënë, huadhënësi nuk mund të shlyhet derisa të mos jenë shlyer kreditorët e tjerë). Këto "hua" shpesh u jepen aksionerëve të bankës. Nëse për to paguhet interes, interesat e përllogaritur duhet të llogariten mbi huamarrjet.

Grupi i lidhur i llogarive është:

Bilanci

5.6	Borxhi i varur
5.6.1	Borxhi i varur
5.6.9	Interesi i përllogaritur
4.1.9.3.	Shpenzimet për t'u amortizuar për disa vite

Pasqyra e të ardhurave

6.0.1.4	Shpenzime për interesa nga borxhet e varura
6.0.3.4	Shpenzime për komisione nga borxhet e varura

7.2.2 PARIMET KONTABËL

Borxhi i varur dhe interesi i përllogaritur si dhe shpenzimet për komisione regjistrohen si detyrime. Parimet kontabël janë të njëjta si për huamarrjet e tjera.

7.2.3 RASTE TË VEÇANTA

Çdo shpenzim i lidhur me emetimin e borxhit të varur, domethënë, shpenzimet e reklamës, shpenzimet e shtypjes së dëftesës dhe komisionet e tjera, mund të llogariten si më poshtë:

- si një shpenzim i periudhës në të cilën borxhi i varur është dhënë;
- ose si "shpenzime që do të amortizohen për disa vite". Në këtë rast periudha e amortizimit i korrespondon maturitetit të borxhit të varur dhe në çdo rast nuk do të kalojë 5 vjet.

Llogaria "shpenzime për t'u amortizuar për disa vite" duhet të përdoret, gjithashtu, për kontabilizimin e çdo primi emetimi (diferenca midis vlerës emërore të borxhit të varur të dhënë dhe shumës së parave fizike të marra faktikisht nga huadhënësi) dhe shlyerjeve të primeve (diferenca midis vlerës emërore të borxhit të varur dhe shumave faktike të shlyerjeve të bëra për huadhënësit) të lidhura me borxhet e varura.

Këto prime duhet të amortizohen në varësi të maturitetit të borxhit të varur të emetuar.

7.3. FONDE REZERVË PËR RREZIQE DHE SHPENZIME

Fondet rezervë për rreziqe dhe shpenzime janë çdo shumë e mbajtur (ruajtur) e gjykuar si e nevojshme për qëllime të sigurimit të çdo detyrimi ose humbjeje i cili ose ka të ngjarë të shkaktohet ose është e sigurt se do të shkaktohet por nuk është e sigurt se në çfarë shume ose në çfarë date.

SEKSIONI 8: MJETE DHE DETYRIME TË TJERA

8.1. FUSHA E ZBATIMIT

Ky grup llogarish përfaqëson mjetet dhe detyrimet e tjera të bankës që nuk lidhen drejtpërdrejt me transaksionet ndërbankare, huatë për klientët, mjetet e qëndrueshme, burimet e përhershme dhe kapitalin e vet të aksionerëve.

Në përgjithësi ato përfshijnë llogaritë e të tretëve me të cilët banka ka lidhje për mbështetjen e veprimtarive të saj si:

- furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të përgjithshme,
- debitorë të ndryshëm,
- llogaritë e pagave,
- rezervat.

Përveç kësaj, në këtë grup llogarish përfshihen të gjitha llogaritë që lidhen me:

- "Transaksionet si agjent": transaksione ndërmjetëse të kryera në emër të shtetit ose organizatave të tjera.
- "Llogaritë e marrëdhënieve": transaksione të kryera me degë, agjenci, zyrat.
- "Llogaritë pezull": transaksione tranzitore siç janë çeqe për arkëtim. pagesa në tranzit, pastrimi i marrëdhënieve.
- "Llogaritë e pozicionit": operacionet e këmbimit valutor.
- "TVSH".

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

4.1 Mjete të tjera
4.2 Detyrime të tjera
4.3 Transaksionet si agjent
4.4 Llogaritë e marrëdhënieve
4.5 Llogaritë pezull dhe të pozicionit
4.6 Tvsh.

8.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

8.2.1 MJETET

411. DEBITORË TË NDRYSHËM

Grupi përkatës i llogarive është:

4.1.1.1 Llogari për t'u arkëtuar të furnitorëve
4.1.1.2 Depozita garancie të paguara
4.1.1.3 Taksa për t'u arkëtuar
4.1.1.7 Debitorë të tjerë
4.1.8 Fonde rezervë për amorizimin e debitorëve të ndryshëm

4111 Furnitorë për t'u arkëtuar

Kjo llogari ka të bëjë me shumat që i detyrohen furnitorët (siç janë paradhëniet e paguara nga banka për furnitorët). Kjo situatë shpesh rezulton nga fakti që banka mund të kërkojë depozitë garancie.

4112 Depozita garancie të paguara

Kjo llogari ka të bëjë me depozitat e garancisë të lidhura me veprimtaritë jobankare siç janë një depozitë garancie për një qira.

4113 Taksa për t'u arkëtuar

Parapagesat për taksat mbi të ardhurat të bëra gjatë periudhës regjistrohen në debi të kësaj llogarie. Në datën e mbylljes gjendja (teprica) e kësaj llogarie duhet të paraqitet për neto kundrejt tepricës kreditore të llogarisë me qëllim që të përfaqësojë shumën për t'u marrë nga administrata taksore në lidhje me periudhën.

4117 Debitorë të tjerë

Çdo llogari tjetër për t'u arkëtuar, e cila nuk mund të klasifikohet dhe regjistrohet në llogaritë e përcaktuara në Planin e Llogarive, përgjithësisht regjistrohet në këtë llogari.

418 Fonde rezervë për amortizimin e debitorëve të ndryshëm

Kur ekziston rreziku që një llogari aktive të mos arkëtohet duhet regjistruar një fond rezervë për amortizimin. Banka duhet të kryejë të paktën një herë në vit një inspektim të debitorëve të tjerë për të vlerësuar mundësinë e arkëtueshmërisë së tyre dhe nëse gjykohet e nevojshme, për të vlerësuar fondet rezervë për amortizim të cilat duhen regjistruar.

412. INVENTARI

4121 Metalet e çmuara

Metalet e çmuara që mbahen në kasafortat e bankës ose jashtë saj regjistrohen në këtë llogari. Metalet e çmuara vlerësohen me vlerën e tyre reale për datën e bilancit. Vlera reale e metaleve të çmuara duhet përcaktuar duke përdorur kuotat e tregut nga tregjet ndërkombëtare ose vlerat e mundshme nga shitjet nëse nuk ekzistojnë kuotat e tregut.

4122 Mallra dhe furnizime

Në këtë llogari regjistrohen furnizimet dhe pajisjet e vogla. Ato hiqen nga llogaria 5325 "Mjete të qëndrueshme - pajisje zyre" sepse nuk mbahen në funksion të veprimtarisë së bankës. Për shembull, llogaria 4122 mund të përdoret kur një mall (kolateral) përftohet nëpërmjet një procesi ligjor për të mbuluar shlyerjen e një huaje të dyshimtë, dhe është në proces për t'u shitur.

4123 Trualli dhe ndërtesa të përftuara nëpërmjet procesit ligjor

Kjo llogari ka të bëjë me trojet dhe ndërtesat e përftuara nëpërmjet një procesi ligjor dhe që ka shërbyer si kolateral për huatë dhënë klientëve.

4127 Të tjera

Kjo llogari përfshin numizmatikën dhe kartëmonedhat që nuk janë më në qarkullim, të vlerësuara me vlerën e tyre të realizimit.

419 TË ARDHURA TË LLOGARITURA DHE SHPENZIME TË PARAPAGUARA

4191 Të ardhura të përllogaritura

Sipas kontabilitetit me bazë rrjedhëse (përllogaritje), të ardhurat nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera të njohura kur këto transaksione ose ngjarje ndodhin (dhe jo kur paraja fizike ose ekuivalentët e saj merren) për shembull, nëse banka kryen një transaksion i cili lidhet plotësisht ose pjesërisht me periudhën kontabile në fjalë, dhe nëse pagesa e këtij transaksioni do të bëhet në periudhën vijuese, banka duhet të llogarisë të ardhurat që lidhen me periudhën sipas një baze rrjedhëse dhe ta paraqesë në "Të ardhura të përllogaritura" si një aktiv në bilanc. Ky është rasti për shembull, për komisionet nga shërbimet bankare që mund t'i faturohen klientit në janar dhe që i përkasin dhjetorit.

4192 Shpenzimet e parapaguara

Shpenzimet e parapaguara përfaqësojnë shpenzime që janë paguar paradhënie për furnitorët dhe që i përkasin një periudhe të ardhme. Në këtë rast për shembull, për pjesën e qirasë paguar paradhënie për periudhën pasuese të datës së bilancit.

4193 Shpenzime për t'u amortizuar për disa vite

Disa shpenzime të kryera nga banka mund t'i përkasin transaksioneve të cilat sjellin përfitime për disa vite. Në këto rrethana, këto shpenzime mund të amortizohen përgjatë gjithë kohës së kryerjes së transaksionit nëse mund të përcaktohet rentabiliteti total i transaksionit. Në të kundërt,

nuk është gjë e mençur të kapitalizohen shpenzimet për një projekt, i cili nuk do të garantojë fitim në të ardhmen.

Shpenzime të tilla përfshijnë midis të tjerash komisionet e blerjes së mjeteve të qëndrueshme të pakapitalizuara, primet për emetimin e borxhit ose primet për shlyerjen e borxhit.

Për të llogaritur shpenzimet që do të amortizohen për disa vite, shpenzimet duhet të përcaktohen qartësisht dhe duhet me saktësi t'i përkasin transaksionit në fjalë.

8.2.2 DETYRIME TË TJERA

421 KREDITORË TË NDRYSHËM

4211 Furnitorët

Furnitorët përfaqësojnë detyrimin për furnizimet e përdorura për veprimet e ditës të bankës (energji elektrike, mjete të qëndrueshme etj.).

4212 Depozita garancie të marra

Kjo llogari ka të bëjë me depozitat e garancisë të lidhura me veprimtaritë jobankare. Garancia e marrë nga klientët ose bankat e tjera në lidhje me transaksionet bankare regjistrohet në llogaritë përkatëse të klientëve ose transaksioneve ndërbankare.

4213 Taksat për t'u paguar

Fondi rezervë për taksat mbi të ardhurat për periudhën regjistrohet në këtë llogari dhe në zërin korrespondues në pasqyrën e të ardhurave.

Të gjitha taksat e ndryshme nga taksat mbi të ardhurat të cilat nuk janë paguar duhet, gjithashtu, të përllogariten dhe regjistrohen në këtë llogari.

4214 Dividendët për t'u paguar

Dividentët e miratuar nga asambleja e aksionerëve duhet të regjistrohen në këtë llogari për sa kohë që nuk u paguhen aksionerëve. Ky regjistrim i bërë duke zbritur fitimin për t'u shpërndarë (rezerva plus fitimet e pashpërndara, plus fitimin e vitit ushtrimor, minus humbjen e vitit ushtrimor).

429 SHPENZIME TË LLOGARITURA DHE TË ARDHURA TË SHTYRA

4.2.9. Shpenzimet e llogaritura dhe të ardhurat e shtyra
4.2.9.1 Pagat për t'u paguar punonjësve

4.2.9.2 Shpenzime shoqërore për t'u paguar
4.2.9.3 Shpenzime të tjera për personelin për t'u paguar punonjësve
4.2.9.4 Operacione të qirasë financiare - të ardhura financiare të pafituara.
4.2.9.7. Të ardhura të shtyra dhe shpenzime të tjera të përllogaritura

Sipas kontabilitetit me bazë rrjedhëse, shpenzimet që i përkasin një transaksioni ose një ngjarjeje njihen si të tilla kur transaksioni përfundohet ose kur kjo ngjarje ndodh (dhe jo kur paraja fizike ose ekuivalenti i saj paguhet). Shpenzimet regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhës së cilës ato i përkasin. Për pasojë, shpenzimet e llogaritura përfaqësojnë shpenzimet e shkaktuara gjatë periudhës por të papaguara faktikisht në datën e hartimit të bilancit dhe regjistrohen si detyrim në bilanc.

Shpenzimet e llogaritura përfshijnë përgjithësisht pagat për t'u paguar punonjësve dhe shpenzimet shoqërore për t'u paguar.

Në përgjithësi, të ardhurat e shtyra përfaqësojnë fonde (ose para) të marra gjatë vitit, por të cilat i përkasin periudhave të ardhme.

8.2.3. VEPRIMET SI AGJENT

4.3 Veprimet si agjent
4.3.1 Sigurimi shoqëror
4.3.2 Fondi i asistencës
4.3.3 Llotaria
4.3.4 Administrimi fiskal
4.3.5 Doganat
4.3.7 Veprime të tjera si agjent

Këto llogari përdoren kur banka vepron si agjent për sigurimet shoqërore, fondin e asistencës, llotaritë, administrimin fiskal, doganat dhe për çdo organizatë tjetër publike ose parapublike. Ato mund të përdoren vetëm për transaksione ndërmjetëse. Ato hiqen nga llogaria e kategorisë 26 "Qeveria Shqiptare dhe administrata publike" sepse llogaria 26 përfshin transaksione të tjera siç janë huatë, huamarrjet.

Shumat paguar përfituesve regjistrohen në debi të llogarisë korresponduese ndërsa shumat e marra në emër të organizatës regjistrohen në kredi të kësaj llogarie.

Komisionet që përfaqësojnë shpërblimin që merr banka për shërbimin e ofruar për organizatën, kontabilizohen po në këtë llogari.

Në mbyllje, shumat e mjetit dhe detyrimit duhet të kompensohen kundrejt njera-tjetrës për secilën palë. Teprica e kësaj llogarie përfaqëson shumën neto që banka i detyrohet ose që do të merret nga organizata në zbatim të kontratës me agjentin.

8.2.4. LLOGARITË E MARRËDHËNIEVE

Kjo llogari ka të bëjë me veprimet midis drejtorive të përgjithshme dhe degëve, agjencive dhe zyrave bankare, midis vetë degëve, midis degëve dhe agjencive etj.. Këto janë të ashtuquajturat llogari "të kujtesës" të cilat duhet të kompensohen (paraqiten për neto) kundrejt njëra-tjetrës për paraqitjen e bilancit të bankës. Gjendja që mbetet duhet të jetë zero.

8.2.5. LLOGARI PEZULL DHE TË POZICIONIT

451 LLOGARI PEZULL

- 4511 Çeqe për arkëtim

Kjo llogari regjistron çeqe të dhëna institucioneve pastruese të marrëdhënieve gjatë periudhës midis datës kur çeqet u janë dorëzuar këtyre institucioneve dhe datës kontraktore për pagesë.

- 4512 Pagesat për t'u kryer

Llogaria "pagesa për t'u kryer" përdoret për të regjistruar pagesat e bëra por, për të cilat nuk është marrë konfirmimi i palës tjetër për transaksionin ose pagesa është marrë por nuk njihet përfituesi.

- 4513 Llogaritë e pastrimit të marrëdhënieve

Parimi i pastrimit të marrëdhënieve supozon zëvendësimin e pagesave shumëplanëshe nga bankat, për bankat nëpërmjet shlyerjeve në një llogari të vetme pastrimi marrëdhëniesh, të cilat kryhen nga një qendër pastrimi marrëdhëniesh.

Çdo çek i veçantë që duhet paguar regjistrohet në këtë llogari, e cila kompensohet tërësisht nga pagesa neto e marrë ose e paguar pas kompensimit me bankat e tjera.

- 4514 Pagesat me bankomat - llogari tranzitore

Kjo llogari regjistron paranë e paguar nëpërmjet një bankomati, një klienti nga një bankë tjetër gjatë periudhës midis datës kur paraja i jepet fizikisht klientit dhe rimbursimit kontraktor të parasë fizike nga banka debitore.

452 LLOGARITË E POZICIONEVE

Parimet e kontabilitetit që kanë të bëjnë me "Llogaritë e pozicioneve" trajtohen në seksionin 10 ("Veprimet me valutat").

8.2.6 TVSH

Grupi përkatës i llogarive është:

4.6.1 TVSH për t'u zbritur
4.6.2 TVSH për t'u marrë
4.6.3 TVSH për t'u mbledhur
4.6.4 TVSH për t'u paguar

Ky grup llogarish përfshin dy elemente të veçanta:

- TVSH për t'u zbritur
- TVSH për t'u mbledhur

- TVSH për t'u marrë
- TVSH për t'u paguar

TVSH për t'u zbritur është shuma e detyrimit të shtetit për shkak të të drejtave për të zbritur. TVSH e paraqitur në faturat e furnizuesit regjistrohet në këtë llogari.

TVSH për t'u mbledhur është sasia që i detyrohemi shtetit për shkak të faturimit të TVSH klientëve.

TVSH përgjithësisht deklarohet nga banka çdo muaj dhe shuma neto e TVSH-së mbledhur dhe TVSH-së për t'u zbritur duhet të paguhet në/ose të merret nga shteti.

Kur shuma e TVSH-së për t'u zbritur tejkalon sasinë e TVSH-së për t'u mbledhur, llogaria "TVSH për t'u paguar" debitohet.

Kur shuma e TVSH-së për t'u mbledhur tejkalon sasinë e TVSH-së për t'u zbritur, llogaria "TVSH për t'u marrë" debitohet.

SEKSIONI 9: VEPRIMET ME NORMAT E INTERESIT

9.1. FUSHA E ZBATIMIT

Grupi përkatës i llogarive është:

6.0.2.7	Shpenzime të tjera për veprimet financiare
7.0.2.7	Të ardhura të tjera nga veprimet financiare
9.5.	Angazhimet sipas instrumenteve financiare
9.5.1	Të marra
9.5.1.1	Shuma emërore
9.5.2	Të dhëna
1.1.1.1	Shuma emërore

9.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

9.2.1.KONTRATAT E MUNDËSIVE/ TAVANIT/ DYSHEMESË/ KOMBINUARA KUFIZUESE PËR NORMAT E INTERESIT

- Një mundësi e normës së interesit është një kontratë që i jep titullarit të drejtën, por jo detyrimin, për të blerë (kërkuar) ose shitur (vendosur) një marrëveshje për normën e interesit me një çmim të parapërcaktuar (çmim ushtrimi ose kontrate) gjatë një periudhe të përcaktuar kohe në një datë të caktuar.
- Një normë interesi tavan është një karakteristikë e llojit të mundësisë për të cilën blerësi paguan një çmim (prim) për të siguruar mbrojtje kundrejt një rritjeje në një normë të caktuar interesi mbi një nivel të caktuar. Në datën e caktuar në të ardhmen, nëse normat e interesit lëvizin mbi kufirin e pranuar, shitësi do të shlyejë blerësin për diferencën midis normës faktike të interesit dhe kufirit të pranuar deri në datën tjetër të referencës.
- Një normë interesi dysheme është një karakteristikë e llojit të mundësisë për të cilën shitësi merr një çmim (prim) për humbjen e të drejtës së tij për të marrë hua më lirë nëse normat e interesit të tregut bien nën një nivel të caktuar. Nëse normat e interesit lëvizin nën kufirin e pranuar, shitësi do të shlyejë blerësin për diferencën midis normave faktike dhe asaj të pranuar deri në datën tjetër të referencës.
- Një normë interesi e kombinuar kufizuese është një karakteristikë e llojit të mundësisë për të cilën titullari faktikisht kombinon një pozicion në blerje të normës tavan dhe në shitje të normës dysheme. Kështu një kontratë e tillë përcakton kufijtë e sipërm dhe të poshtëm të normave të interesit midis të cilëve mund të marrë hua titullari.

Vlera emërore e një marrëveshjeje të mundësisë së normës së interesit, normës tavan, dysheme dhe asaj të kombinuar kufizuese regjistrohet jashtë bilancit.

Primet e paguara ose të marra regjistrohen në bilanc ("36 Prime nga instrumentet financiare") për sa kohë që mundësia nuk ekzekutohet.

Diferenca e normës së interesit të paguar ose marrë në datën e maturimit regjistrohet si një e ardhur ose humbje në llogaritë 6029 dhe 7029 në pasqyrën e të ardhurave.

9.2.2 SHKËMBIMET E NORMAVE TË INTERESIT

Një shkëmbim norme interesi është një marrëveshje midis dy palëve për të këmbyer kushtet e tyre për të pasur mundësi veprimi në tregun financiar (domethënë, kushtet e investimeve dhe të huamarrjeve). Me fjalë të tjera, një marrëveshje e tillë përcakton normën e interesit që do të merret nga huadhënësi dhe normën e interesit që do të paguhet nga huamarrësi, e cila zbatohet mbi kryegjënë e pranuar nga të dyja palët për një periudhë të caktuar kohe.

Në praktikë, vetëm sasia neto e rezultuar nga ky këmbim është objekt i transferimit të fondeve midis dy palëve në datën e maturimit. Për pasojë, gjatë periudhës së zgjatjes së marrëveshjes së shkëmbimit të interesit, interesi neto që do të paguhet ose merret, përllogaritet dhe regjistrohet në llogarinë e bilancit "të ardhura/shpenzime për interesa të përllogaritur) dhe në pasqyrën e të ardhurave ("fitime ose humbje nga veprimet me instrumentet financiare").

9.2.3. MARRËVESHJET ME NORMË ME AFAT

Një marrëveshje me normë me afat (FRA- shqip MNA) është një marrëveshje midis dy palëve për të dhënë hua (ose për të marrë) në një datë të ardhme të pranuar (data e shlyerjes) kryegjënë, me një normë interesi fikse për një periudhë të caktuar kohe (zakonisht 3,6,9 dhe 12 muaj). Në datën e shlyerjes FRA ushtrohet me anë të pagesës së diferencës midis normës fikse të pranuar të interesit dhe normës së interesit të tregut në datën e shlyerjes, duke marrë parasysh kryegjënë dhe periudhën e pranuar nga palët.

Më fjalë të përgjithshme, të gjitha instrumentet financiare të sipërpërmendura (mundësitë, shkëmbimet, FRA) mund të ndahen në dy kategori kryesore: mbrojtëse dhe spekulative (ose tregtimi). Instrumentet financiare spekulative duhet të vlerësohen me vlerën reale të tyre duke përdorur ose metodën e zëvendësimit (vlerën që një i tretë është i gatshëm të paguajë për të zëvendësuar kontratën) ose metodën e detyrimit.

Instrumentet financiare të përdorura për mbrojtje të mjeteve dhe detyrimeve të tjera duhet të mbahen me kosto dhe fitimet e parealizuara duhet të njihen në mënyrë simetrike me mjetin ose detyrimin në fjalë që është objekt i mbrojtjes.

SEKSIONI 10: VEPRIMET ME VALUTAT

Për qëllime të paraqitjes së parimeve të përgjithshme, komentet bazohen duke përdorur si monedhë të huaj shembull, dollarin amerikan. Parimet zbatohen për çdo valutë. Për çdo monedhë mbahet libër i veçantë.

10.1. FUSHA E ZBATIMIT

Transaksionet në dollarë amerikanë duhet të regjistrohen në ditarin e dollarëve amerikanë. Ashtu si transaksionet në lekë, ditarët në dollarë amerikanë duhet të përqendrohen në Librin e Madh në dollarë amerikanë. Bilanci vërtetues i dollarëve amerikanë përmbledh tepricat e çdo llogarie dhe përdoret për përgatitjen e raporteve financiare.

Në mbyllje, bilanci, zërat jashtë bilancit dhe llogaritë e fitimeve dhe të humbjeve në dollarë amerikanë konvertohen në lekë dhe konsolidohet në pasqyrat në lekë.

Në librat në dollarë amerikanë, të gjitha llogaritë mund të përdoren në përputhje me natyrën e mjetit dhe detyrimit të mbajtur në valutë.

Grupi përkatës i llogarive në librat në lekë është:

Bilanci

4.5.2.1. Kundrallogaritë e këmbimit valutor në lekë (kundrejt valutave).
4.5.2.2. Llogaritë e pozicionit të këmbimit valutor në monedha të tjera (kundrejt lekut).
4.5.2.3. Llogaritë kundërparti të rivlerësimit të operacioneve valutore me afat.

Zërat jashtë bilancit

9.3. Transaksionet valutore
9.3.1. Valutë e blerë me afat
9.3.2. Valutë e shitur me afat
9.3.3. Shuma në lekë për t'u marrë kundrejt shitjes së valutave
9.3.4. Shuma në lekë për t'u dhënë kundrejt blerjes së valutave
9.3.5. Llogaria e rivlerësimit të operacioneve valutore me afat

9.3.8. Llogaria kundërparti e transaksioneve valutore
9.3.8.1. Llogaria kundërparti e valutës së blerë me afat
9.3.8.2. Llogaria kundërparti e valutës së shitur me afat
9.3.8.3. Llogaria kundërparti e shumës në lekë për t'u marrë kundrejt shitjes së valutave
4.4.4.4. Llogaria kundërparti e shumës në lekë për t'u dhënë kundrejt blerjes së valutave

10.2 PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

10.2.1. PARIMET E PËRGJITHSHME TË VEPRIMEVE VALUTORE

Një operacion valutor është një veprim në të cilin dy palë pranojnë të shkëmbejnë një shumë në Lekë kundrejt një shume në valutë (për shembull, dollari amerikan). Operacionet mund të pasqyrohen edhe në librat në lekë edhe në librat në dollarë amerikanë duke përdorur llogaritë lidhëse ose të pozicionit ("Kundërllogaritë valutore – dollarë amerikanë" "Kundërllogaritë valutore - lekë").

Llogaritë që përdoren për këtë mekanizëm specifik janë:

Shembulli 1. Banka A i ble 1000 dollarë amerikanë z. X kundrejt Lekut (kursi fiks: 1 dollarë amerikanë për 100 Lekë). Regjistrimet kontabël janë:

1112

Arka në dollarë amerikanë

D	K
1 000	

4522

Kundërllogaria valutore në dollarë amerikanë

D	K
	1 000

4521

Kundërllogaria valutore në Lekë (dollarë amerikanë)

D	K
100 000	

1111

Arka në Lekë

D	K
	100 000

Teprica e "Kundërllogarisë valutore në dollarë amerikanë" përshkruan pozicionin e këmbimit dhe rrezikun e pozicionit në dollarë amerikanë. Teprica e "Kundërllogarisë valutore në lekë" përshkruan koston në lekë të monedhës së huaj.

Rreziku i pozicionit valutor

Pozicioni në valutë është një aktiv ose pasiv neto në valutë. Ndryshimi në kursin fiks do të ndikojë në të ardhurat e bankës.

Të gjitha veprimet në valutë të huaj nuk nënkuptojnë automatikisht rrezik më të madh. Një veprim në valutë shkakton një rrezik nga pozicioni valutor në rast se ndryshon vlerën e aktiveve ose pasiveve neto. Për shembull, një hua e dhënë në dollarë amerikanë e cila rifinancohet nëpërmjet marrjes hua në dollarë amerikanë nuk rrit rrezikun sepse pozicioni neto në dollarë nuk ndryshon (mbetet po ai).

10.2.2. VEPRIME INVENTARI TË MBYLLJES

Në mbyllje, veprohet si më poshtë:

- *Gjendjet në dollarë amerikanë konvertohen në lekë*: gjendjet që mbahen në valutë konvertohen në Lekë duke përdorur kurset e mëposhtme të këmbimit:
- Llogaritë e bilancit dhe jashtë bilancit: kursin e ditës së mbylljes të përcaktuar në një treg valutor ndërkombëtar.
- Për llogaritë e fondeve të veta zbatohet në trajtim i veçantë: fondet e veta të mbajtura në valutë regjistrohen në bilanc me vlerë historike; megjithatë, diferenca midis vlerës historike dhe kursit të mbylljes regjistrohet në llogarinë "diferenca rivlerësimi" (574).
- llogaritë e fitimeve dhe humbjeve: kursin e këmbimit mesatar të përcaktuar në një treg valutor ndërkombëtar.
- *Konsolidimi i llogarive të librave në* lekë: gjendjet e konvertuara në lekë konsolidohen në bilancin provë në lekë.
- *Rivlerësimi i llogarive të pozicionit valutor dhe llogaritja e humbje/fitimit në valutë* (shih shembullin më poshtë): fitimi ose humbja në valutë rezulton nga krahasimi i shumës në llogarinë "llogaritë e pozicionit valutor" (të mbajtura në librat në valutë) të konvertuar me kursin e mbylljes dhe shumën në llogarinë "kundërllogaria në lekë e pozicionit valutor" (të mbajtura në librat në lekë). Regjistrimi i fitimit ose humbjes në valutë bëhet nga rivlerësimi i "kundërllogarisë në lekë të pozicionit valutor" (kosto e valutës) kundrejt llogarisë përkatëse në pasqyrën e të ardhurave (706 ose 606).

Kjo është një çështje teknike dhe nuk nënkupton ndonjë regjistrim kontabël (përveç kontabilizimit të humbjes ose fitimit nga këmbimi valutor).

Rivlerësimi i llogarive të pozicionit dhe llogaritja e fitimit/humbjes nga këmbimi valutor.

Në vijim të shembullit të mësipërm, nëse kursi mesatar në mbyllje është 1 dollarë amerikanë për 100 lekë, gjendjet në lekë (përfshi veprimet në lekë dhe dollarë amerikanë) do të jenë:

Tepricat në lekë
(përpara rivlerësimit të llogarisë së pozicionit valutor)

Debi		Kredi	
Arka në dollarë amerikanë:	110 000	Arka në lekë:	100 000
Kundërllogaria valutore në lekë (dollarë amerikanë):	100 000	Kundërllogaria valutore në dollarë amerikanë:	110 000
Totali:	210 000	Totali:	210 000

Fitimi ose humbja nga këmbimi valutor do të rezultojë duke krahasuar:

- shumën në "llogarinë e pozicionit valutor dollarë amerikanë" (librat në dollarë amerikanë) me kursin e datës së mbylljes (për shembull, 110 000)

- shumën e "Kundërllogarisë valutore në lekë (dollarë amerikanë)" (librat në lekë) (për shembull, 100 000)

Regjistrimi i fitimit ose humbjes nga valutat do të rezultojë nga rivlerësimi i "Kundërllogarisë valutore në lekë (dollarë amerikanë)" (kosto e monedhës së huaj), kundrejt pasqyrës së të ardhurave.

4521

Tepricat në lekë (bilanci)
Kundërllogaria valutore në lekë
(dollarë amerikanë)

D	K
10 000	

706

Tepricat në lekë (llogaria
fitim dhe humbje)
Fitimi / Humbja nga valutat

D	K
	10 000

Pasi të jenë bërë këto regjistrime kontabël, tepricat në lekë do të jenë:

Tepricat në lekë
(pas rivlerësimit të llogarive të pozicionit valutor)

Debi		Kredi	
Arka në dollarë amerikanë:	110 000	Arka në lekë:	100 000
Kundërllogaria valutore në lekë (dollarë amerikanë):	110 000	Kundërllogaria valutore në usd: Fitimi nga valutat:	110 000 10 000
Totali:	220 000	Totali:	220 000

Anulimi i llogarive të pozicionit

Pas rivlerësimit dhe llogaritjes së fitimit ose humbjes nga valutat, lidhja "llogari pozicioni" do të anulohet sepse nuk përfaqëson ndonjë mjet ose detyrim real. Tepricat në lekë do të jenë:

Tepricat në lekë
(pas fshirjes së llogarive të pozicionit valutor)

Debi		Kredi	
Arka në dollarë amerikanë:	110 000	Arka në lekë: Fitimi nga valutat:	100 000 10 000
Totali:	110 000	Totali:	110 000

10.2.3 VEPRIMET VALUTORE PA AFAT (ME KURSIN E DITËS (SFO)

Veprimet valutore pa afat janë veprime të blerjes ose shitjes së monedhës konkludimi i të cilave nuk shtyhet ose është shtyrë vetëm për vonesat standarde të tregut (zakonisht dy ditë pune). Veprimi regjistrohet në datë valutën. Veprimet valutore pa afat regjistrohen drejtpërdrejt në bilanc. Regjistrimet kontabël jepen në shembullin 1.

Megjithëse rekomandohet, nuk kërkohet regjistrimi i veprimeve jashtë bilancit. Megjithatë, në mbyllje, bëhet inventarizimi i veprimeve valutore të papërfunduara ende dhe angazhimet regjistrohen jashtë bilancit.

10.2.4 VEPRIMET VALUTORE ME AFAT (FFO)

Në bazë të kontratës për operacion valutor me afat, banka hyn në një marrëveshje oferte për të blerë ose shitur një shumë të caktuar valute me kurs të përcaktuar dhe në një datë të ardhme të dhënë.

Normalisht një bankë pranon një FFO për të mbrojtur veten kundrejt ndryshimeve të paparashikuara të monedhës.

Ato mund të jenë:

- FFO "mbrojtëse": FFO "mbrojtëse" përdoret për të mbuluar një transaksion tregtimi. Për shembull, një bankë së cilës do t'i shlyhet huaja prej 5000 dollarësh amerikanë brenda 60 ditëve mund menjëherë të hyjë në një kontratë me afat për të shitur 5000 dollarë amerikanë për një periudhë 60-ditore, duke fiksuar kështu vlerën në lekë të shitjes së saj. Një veprim i tillë nuk krijon "pozicion valutor".
- FFO "spekulative".

Kontrata e FFO nuk regjistrohet në bilanc derisa të bëhet pagesa ose të merret monedha. Megjithatë, angazhimi duhet të pasqyrohet jashtë bilancit.

Fitimi / humbja nga valutat që bartet (në plus osë minus) llogaritet duke krahasuar:

- vlerën e kontratës pa afat
- vlerën e kontratës duke përdorur kursin e përcaktuar të kontratës FFO.

Fitimi / humbja nga valutat që bartet (në plus ose minus) regjistrohet në llogari jashtë bilancit "935 llogaria e vlerësimit të veprimeve valutore me afat". Ky fitim ose humbje përfshihet në pasqyrën e të ardhurave prorata - temporis kundrejt llogarisë së bilancit "4523 Llogaria kundërparti e rivlerësimit të veprimeve valutore me afat".

10.2.5 HUA DHE HUAMARRJE NË VALUTË

Huatë/huamarrjet në valutë mund të financohen:

- ose me dollarë amerikanë: ky veprim nuk shkakton pozicion valutor, përveç marzhit të interesave midis huasë dhe rifinancimit. Nuk krijon rrezik valutor sepse çdo diferencë që lind nga konvertimi në lekë i huasë në fund të vitit do të kompensohet nga diferenca që krijohet nga konvertimi në lekë i llogarisë rrjedhëse në dollarë amerikanë. Regjistrimet kontabël janë të ngjashme me një hua të zakonshme në lekë por regjistrohen në ditarin në dollarë amerikanë.
- ose me lekë: ky veprim krijon rrezik valutor. Regjistrimet kontabël

do të prekin si ditarët në lekë ashtu edhe në dollarë amerikanë. Regjistrimet kontabël ndjekin të njëjtin model të përshkruar më sipër (9.2.1, shembulli 1).

Njohja e të ardhurave

Llogaritja dhe regjistrimi i interesave bëhen në përputhje me të njëjtat parime si interesat e përftuar nga një hua e zakonshme në lekë. Interesat në dollarë amerikanë regjistrohen në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve në dollarë amerikanë. Në fund të vitit interesat në dollarë amerikanë konvertohen në lekë, nëpërmjet procesit të përgjithshëm të inventarit për konvertimin e bilancit vërtetues nga dollarë amerikanë në lekë.

SEKSIONI 11: VEPRIMET E QIRASË (LISING)

1.1. FUSHA E ZBATIMIT

Një qira është një marrëveshje ku banka (qiradhënësi) i kalon klientit (qiramarrësit), në këmbim të qirasë, të drejtën të përdorë një mjet për një periudhë të pranuar kohe. Kështu, klienti shmang marrjen e një borxhi shtesë dhe mundet të ketë edhe përfitime taksore. Në fund të periudhës së qirasë, pronësia e mjetit mund ose jo t'i transferohet klientit.

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

2.0.5. Kontratat e qirasë financiare.
4.2.9.4 Operacionet e qirasë financiare - të ardhura financiare të pafituara.
5.3.4. Mjete të qëndrueshme të mbajtura për operacione qiraje.

Pasqyra e të ardhurave

6.0.4. Shpenzime nga operacionet e qirasë.
7.0.4. Të ardhura nga operacionet e qirasë.

11.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Qiraja financiare dhe operative

Ka dy lloje kryesore qirash:

- qira financiare: është qiraja që transferon pothuaj të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së një mjeti te klienti (qiramarrësi). Banka (qiradhënësi) vepron si një ndërmjetës financiar midis prodhuesit ose tregtarit dhe një klienti. Titulli mund të transferohet ose jo. Tipare thelbësore të qirasë financiare janë:
- në fillimin e qirasë vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë; përfshi çdo pagesë fillestare, është shumë e afërt (normalisht 90% ose më shumë) me vlerën reale të mjetit të dhënë me qira;
- klienti ka pak të ngjarë ose mund të mos jetë në gjendje të anulojë qiranë përpara fundit të afatit, i cili i përafrohet periudhës së dobishme të përdorimit të mjetit të dhënë me qira;
- qira operative: është çdo qira tjetër përveç asaj financiare.

Për qiranë financiare dhe operative zbatohen parime të ndryshme kontabël.

11.2.1. QIRAJA FINANCIARE

Regjistrimi fillestar

Një mjet i mbajtur sipas një qiraje financiare duhet të regjistrohet në bilancin e bankës jo si pronë, pajisje apo ndërtime, por si llogari për t'u arkëtuar. Këto qira trajtohen nga banka si shlyerje e kryegjësë dhe të ardhura financiare për t'u rimbursuar.

Regjistrimi fillestar i qirasë barazon investimin neto në qira. Investimi neto në qira përkufizohet si:

1. pagesa gjithsej minimale për t'u arkëtuar e qirasë, minus çdo shpenzim ekzekutues dhe fitim përkatës të përfshirë këtu (për shembull, shpenzimet e sigurimit); plus
2. çdo vlerë e mbetur e pagarantuar e pronës së dhënë me qira që i përllogaritet bankës; minus
3. të ardhura financiare të pafituara: mbivlera e pagesave totale të qirasë kundrejt kostos së pronës së dhënë me qira (minus çdo vlerë mbetëse) trajtohet si interes dhe duhet regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së qirasë.

Shih regjistrimet kontabël më poshtë

Shpërndarja e të ardhurave

Interesi i pafituar (4294) duhet të amortizohet gjatë periudhës së qirasë, është e preferueshme që edhe interesi të shpërndahet në përputhje me tepricën në rënie të investimit të pambuluar.

Metoda e përdorur për përftimin e fitimit nga qiraja bazohet në metodën lineare. Çdo periudhe i akordohet një pjesë e barabartë e fitimit.

Shih regjistrimet kontabël më poshtë.

Një metodë tjetër për përftimin e fitimit bazohet në shpërndarjen e fitimit në mënyrë që të jepet një normë konstante kthyeshmërie nga teprica e investimit. Për të llogaritur pjesën e fitimit që përftohet përdoren disa tabela. Megjithëse shuma e bilancit bazohet në investimin neto të qirasë, shpërndarja e të ardhurave në periudha kontabël të veçanta nuk duhet bazuar në këtë shumë, por, në vend të investimit në arkë, të jetë në qira. Dallimi është që investimi neto në arkë merr parasysh faktorë të tjerë, të cilët nuk merren parasysh në llogaritjen e investimit neto, siç janë: taksimi, pagesat për të rifinancuar qiranë etj..

Regjistrimet kontabël të qirasë financiare

Veprimet e qirasë financiare regjistrohen nga banka si më poshtë:

- Me blerjen e pajisjeve:

Debitohet 534	Mjete të qëndrueshme të mbajtura për veprime të qirasë
Kreditohet 1111	Arka

- Zbatimi i qirasë financiare:

Debitohet 2051	Kontratat e qirasë financiare
Kreditohet 534	Mjetet e qëndrueshme të mbajtura për veprime qiraje
Kreditohet 4294	Veprimet e qirasë financiare - të ardhura financiare të pafituara

- Paguhet kësti nga klienti:

Debitohet 1111	Arka (ose llogaritë rrjedhëse të individëve 2711)
Kreditohet 2051	Kontratat e qirasë financiare
Kreditohet 6045	Shpenzime sigurimi
Debitohet 4294	Veprimet e qirasë financiare - të ardhura financiare të pafituara
Kreditohet 7041	Të ardhura nga veprimet e qirasë.

11.2.2. QIRAJA OPERATIVE

Regjistrimi fillestar

Një mjet i mbajtur me qira operative duhet të regjistrohet në bilanc si pronë, pajisje dhe ndërtim në bilancin e bankën. Këto mjete regjistrohen në llogarinë:

534 Mjete të qëndrueshme të mbajtura për operacione qiraje.

Amortizimi i mjeteve të dhëna me qira duhet të bëhet në përputhje me politikën normale të amortizimit të qiradhënësit për mjete të ngjashme. Shuma e amortizueshme e mjetit shpërndahet sistematikisht për çdo periudhë kontabël gjatë periudhës së dobishme të përdorimit.

Shpërndarja e të ardhurave

Të ardhurat nga qiratë duhet të regjistrohen linearisht gjatë afatit të qirasë edhe nëse të hyrat nuk janë sipas kësaj forme. Të ardhurat regjistrohen në llogarinë:

704 Të ardhura nga operacionet e qirasë.

Përfundimi i qirasë

Nëse, në momentin e përfundimit të qirasë, qiramarrësi ble mjetin, mjeti hiqet nga bilanci i bankës. Çdo fitim apo humbje që barazon diferencën midis çmimit të shitjes dhe vlerës neto kontabël të mjetit duhet të regjistrohet.

Nëse, klienti nuk e ble mjetin, mjeti mbetet i regjistruar në bilancin e bankës. Nëse vlera reale (e tregut) e mjetit nuk është në përputhje me vlerën neto kontabël mund të regjistrohet shpenzim për zhvlerësim.

SEKSIONI 12: FAKTORINGU

12.1. FUSHA E ZBATIMIT

Faktoringu i borxheve është një metodë sipas të cilës klienti i transferon bankës (faktori) llogari të caktuara për t'u arkëtuar. Faktoringu përdoret për të përftuar financim, administrim shitjesh dhe mbrojtje nga borxhet e këqija. Karakteristikat kryesore të marrëveshjes së faktoringut janë:

- llogaritë specifike për t'u arkëtuar transferuar te faktori;
- faktori ofron një mundësi kredie sipas të cilës shitësi mund të tërheqë deri në një përqindje të caktuar të vlerës kontabël të borxheve;
- faktori ka përgjegjësi për kthimin e borxheve e cila e çliron klientin nga administrimi i këtij procesi.

Grupi përkatës i llogarive është:

Bilanci

2.8.5. Llogaritë e faktoringut.
2.8.5 Llogaritë e faktoringut - të disponueshme.
2.8.5. Llogaritë e faktoringut - jo të disponueshme.

12.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Llogaritë e arkëtueshme të cilat janë transferuar nga klienti te banka kontabilizohen si më poshtë:

- Debi 20 Hua standarde dhe paradhënie për klientët.
- Kredi 2851 Llogari të klientëve të tjerë - Llogaria faktoringu - e disponueshme: kur fondet duhet të merren sapo transferohen llogaritë për t'u arkëtuar;

ose

- Kredi 2852 Llogari të klientëve të tjerë - Llogaria faktoringu - jo e disponueshme:

kur fondet duhet të merren në një datë të mëvonshme të pranuar.

SEKSIONI 13: TRANSAKSIONE TË KONSORTIUMIT

13.1. FUSHA E ZBATIMIT

Transaksionet e konsortiumit janë veprime në të cilat bashkohen disa institucione krediti në një "grumbull" ose "konsortium", për t'i dhënë hua një klienti, për të ndarë rrezikun, paratë apo interesat e fituar në bazë të planit të financimit të pranuar bashkërisht.

13.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

Kur huatë jepen brenda një konsortiumi ose grumbulli të institucioneve të kreditit, çdo anëtar i këtij grumbulli duhet të regjistrojë në bilancin e tij vetëm pjesën e tij në operacionin e konsortiumit (huaja e financuar).

Kur, për një pjesëmarrës, pjesa e tij nga pikëpamja e rrezikut është më e madhe se sa pjesa e tij në financim, rreziku shtesë duhet të regjistrohet jashtë bilancit si "angazhim i dhënë".

Kur, pjesa e tij nga pikëpamja e rrezikut është më e vogël se sa pjesa e tij në financim, diferenca duhet të regjistrohet jashtë bilancit si "angazhim i marrë".

Njësoj si financimi, kur angazhimet ose garancitë jepen brenda një veprimi konsortiumi, çdo anëtar duhet të regjistrojë jashtë bilancit vetëm pjesën e tij të rrezikut përfundimtar. Drejtuesi i këtij grumbulli regjistron shumën totale.

SEKSIONI 14: PROCESI I INVENTARIT NË MBYLLJE

14.1. FUSHA E ZBATIMIT

Objektivi i procesit të inventarit të bërë në mbyllje është:

- t'i paraqesë regjistrimet kontabël në përputhje me realitetin ekonomik
- të mbyllë llogaritë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit (Pjesa 2).

Për këtë qëllim, nevojitet punë specifike për inventarin në çështjet e mëposhtme:

- Shpenzimet dhe të ardhurat e veprimtarisë, shpenzime dhe të ardhura të tjera.
- Shqyrtimi i cilësisë së rrezikut të kreditit.
- Fondet rezervë për rreziqet dhe shpenzimet.
- Letrat me vlerë (bono thesari, filiale, interesa pjesëmarrëse).
- Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme.
- Konvertimi në lekë i librave të mbajtur në monedha të huaja.

14.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

14.2.1. SHPENZIMET DHE TË ARDHURAT E VEPRIMTARISË, SHPENZIMET E SHTYRA DHE TË PËRLLOGARITURA, SHPENZIMET DHE TË ARDHURAT E TJERA

Në bazë të kontabilitetit me të drejta të konstatuara, shpenzimet që lidhen me një veprim ose ngjarje regjistrohen kur veprimi kompletohet ose kur kjo ngjarje ndodh (dhe jo në para fizike ose ekuivalenti i tij paguhet). Shpenzimet regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në raportet financiare të periudhës të cilës ato i përkasin. Për pasojë, shpenzimet e llogaritura përfaqësojnë shpenzimet e shkaktuara gjatë periudhës por jo të paguara faktikisht në datën e bilancit dhe regjistrohen si detyrim në bilanc.

14.2.2. SHQYRTIMI I CILËSISË SË RREZIKUT TË KREDISË PËR HUATË JO STANDARDE (HUATË NË NDJEKJE, NËNSTANDARDE, TË DYSHIMTA)

Seksioni 2, 2.2.2. për huatë jostandarde, huatë në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe fondet rezervë.

14.2.3. FONDE REZERVË PËR RREZIQE DHE SHPENZIME

Fondet rezervë për rreziqe dhe shpenzime duhet të vlerësohen për fundin e vitit.

Seksioni 7

14.2.4. BONO THESARI, LETRA ME VLERË, FILIALE, INTERESA PJESËMARRËS

Në datën e mbylljes duhet të bëhet vlerësimi i vlerës së tregut (reale) të bonove të thesarit, letrave me vlerë, filialeve dhe interesave pjesëmarrës.

Seksionet 3 dhe 4

14.2.5. MJETET E QËNDRUESHME TË AMORTIZUESHME

Në datën e mbylljes, duhet të regjistrohet amortizimi i mjeteve të qëndrueshme.

Seksioni 5.

14.2.6. KONVERTIMI NË LEKË I LIBRAVE TË MBAJTUR NË MONEDHA TË HUAJA DHE I LLOGARIVE TË POZICIONIT NË MONEDHA TË HUAJA

Seksioni 10.2.2.

SEKSIONI 15: KONSOLIDIMI

15.1. FUSHA E ZBATIMIT

Ka dy tipe konsolidimi:

- Konsolidimi i brendshëm: qëllimi është që të konsolidohen bilancet, llogaritë jashtë bilancit dhe të fitimeve dhe humbjeve të degëve në raportet përkatëse të drejtorisë së përgjithshme të bankës, me qëllim që të nxirren raportet financiare të bankës.
- Konsolidimi i jashtëm: qëllimi është që të konsolidohen pasqyrat e bankës me ato të filialeve, që veprojnë në vend ose jashtë.

15.2. PËRKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABËL

15.2.1. KONSOLIDIMI I BRENDSHËM

Paraqitja e pasqyrave të bilancit, jashtë bilancit dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës përfshin hapat e mëposhtëm:

- konsolidimi i pasqyrave të bilancit, jashtë bilancit dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të degëve me ato të drejtorisë së përgjithshme;
- anulimi i llogarive lidhëse "llogaritë e marrëdhënieve" sepse ato nuk përfaqësojnë ndonjë mjet ose detyrim real. Këto llogari duhet të kompensohen.

Këto veprime konsolidimi janë të një natyre të pastër teknike dhe nuk shkaktojnë regjistrime kontabël.

15.2.2. KONSOLIDIMI I JASHTËM

Tre metodat e konsolidimit janë:

- filialet në të cilat ushtrohet kontroll tërësor (duke poseduar drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se 50% të të drejtave votuese të shoqërisë) do të konsolidohen sipas metodës së përfshirjes së plotë:

Të gjitha llogaritë e mjeteve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave konsolidohen me llogaritë e të njëjtës natyrë të bankës. Në mbyllje, vlera kontabël e filialeve është shpërndarë në grupin e llogarive të konsoliduara. Pjesa e grupit të vogël në kapitalin e vet të aksionerëve dhe në fitim e humbje të shoqërisë pasqyrohet si një detyrim (si kapital i vet aksioner ose fitim e humbje).

Kur vlera e filialeve është shpërndarë dhe ajo është pak më e madhe ose më e vogël se vlera e aksioneve në kapitalin e vet aksioner të shoqërisë, mund të pasqyrohen diferenca nga konsolidimi.

- filialet që posedohen bashkërisht nga disa shoqëri do të konsolidohen sipas metodës së përfshirjes proporcionale:

Të gjitha llogaritë e mjeteve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave konsolidohen, në përputhje me përqindjen e aksioneve në kapitalin e shoqërisë, me llogaritë e të njëjtës natyrë të bankës. Në mbyllje, vlera kontabël e filialeve shpërndahet në grupin e llogarive të konsoliduara. Asnjë aksion i ndonjë grupi të vogël në kapitalin e vet aksioner dhe në fitim e humbje të filialit nuk pasqyrohet në bilanc.

Një diferencë konsolidimi mund të pasqyrojë vlerën e filialeve e cila është më e madhe ose më e vogël se vlera e aksioneve në kapitalin e vet aksioner të shoqërisë.

- shoqëritë në të cilat ushtrohet influencë e konsiderueshme (duke poseduar drejtpërdrejt ose tërthorazi 20% të të drejtave votuese të shoqërisë) do të trajtohen me metodën e kapitalit pronar:

Vlera kontabël e filialeve zëvendësohet në bilancin e konsoliduar nga aksionet e bankës në kapitalin e vet aksioner të shoqërisë.

PJESA 2: PARAQITJA E REGJISTRIMEVE BAZË KONTABËL

LISTA E VEPRIMEVE

Për të regjistruar veprimet bankare kryesore është hartuar një listë me 10 lloje veprimesh.

Secili nga veprimet trajtohet në një seksion.

Çdo lloj veprimi përbën një seri veprimesh elementare të përshkruara (totali 39):

Lista e seksioneve

Numri në kllapa tregon numrin e veprimit elementar të paraqitur në secilin seksion.

1. Arka (monedha e vendit) (3)
2. Veprimet me klientët në monedhën e vendit (6)
3. Sistemi bankar i vendit (4)
4. Tregu i brendshëm i parasë (8)
5. Valuta (6)
6. Degët (2)
7. Mjetet e qëndrueshme të bankës (3)
8. Veprimet jashtë bilancit (4)
9. Fitimi dhe humbja (2)
10. Ndihma dhe dhurata nga organizatat publike (1)

SEKSIONI 1: VEPRIMET E ARKËS (MONEDHA E VENDIT)

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 1 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. tërheqje e bërë nga klienti;
2. depozita e bërë nga klienti;
3. depozita e bërë nga klienti në drejtorinë e përgjithshme për llogarinë e tij në degë.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

1.1. TËRHEQJET

D	K	Ditari (drejtoria e përgjithshme)
2711		Llogari rrjedhëse – individët
	1111	Arka, kartëmonedha në lekë

1.2. DEPOZITAT

D	K	Ditari (drejtoria e përgjithshme)
1111		Arka, kartëmonedha në lekë
	2711	Llogari rrjedhëse – individët

1.3. DEPOZITAT E BËRA NGA KLIENTËT NË DREJTORI TË PËRGJITHSHME PËR LLOGARINË E TYRE NË DEGË

D	K	Ditari (drejtoria e përgjithshme)
1111		Monedha metalike dhe kartëmonedha në lekë
	441	Llogari marrëdhëniesh – Dega A

D	K	Ditari (Dega A)
441		Llogari marrëdhëniesh – Drejtoria e Përgjithshme
	2711	Llogari rrjedhëse – individët

SEKSIONI 2:VEPRIMET ME KLIENTËT NË MONEDHËN E VENDIT

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 2 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. tërheqje e bërë nga klienti në formën e transferimit në një bankë tjetër
2. transfertë e marrë nga një bankë në favor të klientit
3. hua dhënë klientit
4. këst i paguar nga klienti
5. shlyerje e huasë
6. të drejtat me cilësi të keqe (borxhe të dyshimta)

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

2.1. TËRHEQJET E BËRA NGA KLIENTI NË FORMËN E TRANSFERTËS PËR NJË BANKË TJETËR

D	K	Ditari
2711		Llogari e klientit - llogari rrjedhëse e individit
	13	Llogari rrjedhëse me bankat

2.2. TRANSFERTAT E MARRA NGA NJË BANKË TJETËR NË FAVOR TË KLIENTIT

D	K	Ditari
13		Llogari rrjedhëse me bankat
	2711	Llogari e klientit - llogari rrjedhëse e individit

2.3. HUA DHËNË KLIENTIT

D	K	Ditari
2131		Hua afatgjatë për individin
	2711	Llogari rrjedhëse e individit

Kur klienti i merr paratë e tij:

D	K	Ditari
2711		Llogari rrjedhëse e individit
	111	Arka

2.4. KËST I PAGUAR NGA KLIENTI

Në mbyllje interesat e përllogaritur regjistrohen:

D	K	Ditari
2039		Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë
	70121	Interesat për huatë dhënë individëve

Kur klienti paguan këstin:

D	K	Ditari
2711		Llogari rrjedhëse e individit
	2031	Hua afatgjatë dhënë individit
	2039	Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë

2.5. SHLYERJE E HUASË

2-5.1. Shlyerja nëpërmjet llogarisë rrjedhëse

D	K	Ditari
2711		Llogari rrjedhëse e individit
	2031	Hua afatgjatë dhënë individit
	2039	Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë

2-5.2 Shlyerje në para fizike

D	K	Ditari
1111		Kartëmonedha dhe monedha metalike në lekë
	2031	Hua afatgjatë dhënë individit
	2039	Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë

2.6. TË DREJTA ME CILËSI TË KEQE (HUA TË DYSHIMTA)

Me vlerësimin e rrezikut të kredisë, në rastin kur një hua konsiderohet si e dyshimtë, regjistrimet kontabël në lidhje me transferimin e shumës (kryegjësë dhe interesit të përllogaritur) së huasë në kategori të ndryshme, janë si më poshtë:

D	K	Ditari
2431		Hua afatgjatë dhënë individit (e dyshimtë)
	2131	Hua afatgjatë dhënë individit (standarde)
2439		Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë (e dyshimtë)
	2139	Interesa të përllogaritur për huanë afatgjatë (standarde)

Regjistrimet kontabël në lidhje me fondet rezervë janë si më poshtë:

D	K	Ditari
6524		Shpenzime për fondet rezervë për huatë e dyshimta
	248	Fonde rezervë për huatë e dyshimta

SEKSIONI 3: SISTEMI BANKAR I VENDIT (NË MONEDHËN E VENDIT)

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 3 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. tërheqje ndërmjet institucioneve financiare duke përdorur llogaritë e tyre në bankën qendrore;
2. tërheqje ndërmjet institucioneve financiare të vendit duke përdorur llogaritë e korrespondentëve të tyre;
3. depozita në bankën qendrore;
4. përllogaritja e interesave.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

3.1. TËRHEQJET NDËRMJET INSTITUCIONEVE FINANCIARE DUKE PËRDORUR LLOGARITË E TYRE NË BANKËN QENDRORE

3-1.1. Në rastin e një huaje dhënë nga Banka A në favor të Bankës B.

- Regjistrimet kontabël të Bankës A (huadhënësi) janë:

D	K	Ditari
151		Hua për bankat rezidente
	1121	Banka qendrore – llogaria rrjedhëse

- Regjistrimet kontabël të Bankës B (huamarrësi) janë:

D	K	Ditari
1121		Banka qendrore – llogaria rrjedhëse
	171	Huamarrje nga bankat

3-1.2. Në rastin e tërheqjeve të nxitura nga një klient i Bankës A në favor të një klienti të Bankës B.

- Regjistrimet kontabël të Bankës A (ku bëhet tërheqja) janë:

D	K	Ditari
2711		Llogari rrjedhëse e individit
	1121	Banka qendrore – llogaria rrjedhëse

Regjistrimet kontabël të Bankës B (përfituesi i shumës së tërhequr) janë:

D	K	Ditari
1121		Banka qendrore – llogaria rrjedhëse
	2711	Llogari rrjedhëse e individit

3.2. TËRHEQJET NDËRMJET INSTITUCIONEVE FINANCIARE TË VENDIT DUKE PËRDORUR LLOGARITË E KORRESPONDENTËVE TË TYRE

Regjistrimet kontabël të Bankës A (huadhënësi) janë:

D	K	Ditari
151		Hua për bankat rezidente
	1311	Llogari rrjedhëse në bankat rezidente

Regjistrimet kontabël të Bankës B (huamarrësi) janë:

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse në bankat rezidente
	171	Huamarrje nga bankat

3.3. DEPOZITA NË BANKËN QENDRORE

Në rastin e transferimit të parave:

D	K	Ditari
11231		Llogari depozite në bankën qendrore
	1111	Arka – Lekë

Në rastin e transferimit nga llogaria rrjedhëse me bankën korrespondente:

D	K	Ditari
11231		Llogari depozite në bankën qendrore
	13	Llogari rrjedhëse me bankat

3.4. PËRLLOGARITJA E INTERESAVE

D	K	Ditari
1519		Hua për bankat rezidente - interesa të përllogaritur
	70113	Të ardhura nga interesat prej veprimeve me institucionet e kreditit

SEKSIONI 4: TREGU I BRENDSHËM I PARAVE

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 4 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. blerje të letrave me vlerë;
2. rivlerësimi (fitimi);
3. rivlerësimi (humbja);
4. shitje e letrave me vlerë (fitimi);
5. shitje e letrave me vlerë (humbja);
6. blerja e repo;
7. riblerja e repo;
8. kredia lombard.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

4.1. BLERJA E LETRAVE ME VLERË

Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme:

D	K	Ditari
311		Letra me vlerë të tregtueshme
	1311	Llogari rrjedhëse me bankat rezidente

4.2. RIVLERËSIMI (FITIMI)

Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme:

D	K	Ditari
311		Letra me vlerë të tregtueshme
	70221	Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme

Në rastin e letrave me vlerë të vendosjes nuk regjistrohet asnjë e ardhur.

4.3. RIVLERËSIMI (HUMBJA)

Në rastin e letrave me vlerë të tregtueshme

D	K	Ditari
60221		Humbje nga letrat me vlerë të tregtueshme
	311	Letra me vlerë të tregtueshme

Në rastin e letrave me vlerë të vendosjes

D	K	Ditari
602223		Shpenzime për zhvlerësimin e letrave me vlerë të vendosjes
	3128	Fonde rezervë për zhvlerësim

4.4. SHITJA E LETRAVE ME VLERË (FITIMI)

Në rastin e letrave me vlerë të vendosjes

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse në bankat rezidente
	702221	Fitime nga shitja e letrave me vlerë të vendosjes
	312	Letra me vlerë të vendosjes

4.5. SHITJA E LETRAVE ME VLERË (HUMBJA)

Në rastin e letrave me vlerë të vendosjes

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse në bankat rezidente
60221		Humbje nga letrat me vlerë të tregtueshme
	311	Letra me vlerë të tregtueshme

4.6. BLERJE REPO

Regjistrimet kontabël të Bankës A (huadhënësi) janë:

D	K	Ditari
12141		Bono thesari të blera me marrëveshje riblerjeje
	1311	Llogari rrjedhëse në bankat rezidente

Regjistrimet kontabël të Bankës B (huamarrësi) janë:

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse në bankat rezidente
	12151	Bono thesari të shitura me marrëveshje riblerjeje

4.7. RIBLERJE REPO

Regjistrimet kontabël të Bankës A (huadhënësi) janë:

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse në bankat rezidente
	12141	Bono thesari të blera me marrëveshje riblerjeje
	7015	Interesi i marrë në letrat me vlerë të blera me marrëveshje riblerjeje

Regjistrimet kontabël të Bankës B (huamarrësi) janë:

D	K	Ditari
12151		Bono thesari të shitura me marrëveshje riblerjeje
6015		Shpenzime për interesa për letrat me vlerë të blera me marrëveshje riblerje
	1311	Llogari rrjedhëse në bankat rezidente

4.8. KREDIA LOMBARD

Kontabilizimi i kredisë lombard (një hua e garantuar me letra me vlerë) pasqyron dy procedurat e mëposhtme që duhet të kryhen nga banka:

- huaja duhet të regjistrohet në një llogari bilanci;
- vlera emërore e letrave me vlerë të dhëna si garanci për huanë duhet të regjistrohet në një llogari jashtë bilancit.

D	K	Ditari
2011		Hua afatshkurtër për individët
	1111	Arka në lekë
9283		Letra me vlerë të marra
	923	Letra me vlerë të marra si garanci për kredinë rifinancim/llogaria kundërparti

SEKSIONI 5: VEPRIMET ME VALUTAT

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 5 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:
1. blerje valute;
2. rivlerësim valute;
3. shitje valute;
4. depozita në valutë në një bankë korrespondente;
5. të ardhura të përllogaritura;
6. Pagesa.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

5.1. BLERJE VALUTE

5-1.1. Në para fizike

Regjistrimet kontabël në librat e valutës janë:

D	K	Ditari në valutë
1112		Arka në valutë
	4522	Llogaria e pozicionit valutor

Regjistrimet kontabël në librat në lekë janë:

D	K	Ditari në lekë
4521		Kundërllogaria valutore në lekë
	1111	Arka në lekë

5-1.2. Në llogari rrjedhëse

Regjistrimet kontabël në librat e valutës janë:

D	K	Ditari në valutë
132		Llogari rrjedhëse në bankat jorezidente
	4522	Llogaria e pozicionit valutor

Regjistrimet kontabël në librat në lekë janë:

D	K	Ditari në lekë
4521		Kundërllogaria valutore në lekë
	131	Llogari rrjedhëse në bankat rezidente

5.2. RIVLERËSIMI I VALUTËS

Në rastin e fitimit:

D	K	Ditari në lekë
4521		Kundërllogaria valutore në lekë
	706	Fitimi nga valutat

Në rastin e humbjes:

D	K	Ditari në lekë
606		Humbje nga valutat
	4521	Kundërllogaria valutore në lekë

5.3. SHITJA E VALUTAVE (FIZIKISHT)

Regjistrimet kontabël në librat në valutë janë:

D	K	Ditari në valutë
4522		Kundërllogaria valutore
	1112	Arka në valutë

Regjistrimet kontabël në librat në lekë:

D	K	Ditari në lekë
1111		Arka në lekë
	4521	Kundërllogaria valutore në lekë

5.4. DEPOZITA NË VALUTË NË BANKËN KORRESPONDENTE

D	K	Ditari në valutë
142		Depozita në bankën jorezidente
	1321	Llogari rrjedhëse në bankën jorezidente

5.5. TË ARDHURA TË PËRLLOGARITURA

D	K	Ditari në valutë
1429		Depozita në bankat jorezidente – të përllogaritura
	70112	Interesa nga veprimet me institucionet e kreditit

5.6. PAGESA

D	K	Ditari
1321		Llogari rrjedhëse në bankat jorezidente
	1429	Depozita në bankat jorezidente – të përllogaritura

SEKSIONI 6: VEPRIMET ME DEGËT

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 6 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. depozitim në drejtorinë e përgjithshme në kreditim të llogarisë së klientit të degës:
2. tërheqje në drejtorinë e përgjithshme në debitim të llogarisë së klientit të degës.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

6.1. DEPOZITIM NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME NË KREDITIM TË LLOGARISË SË KLIENTIT TË DEGËS

Regjistrimet kontabël në drejtorinë e përgjithshme:

D	K	Ditari (drejtoria e përgjithshme)
1111		Arka në lekë
	442	Llogari marrëdhëniesh - Dega A

Regjistrimet kontabël në degë:

D	K	Ditari (dega)
441		Llogari marrëdhëniesh - drejtoria e përgjithshme
	2711	Llogari rrjedhëse - individi

6.2. TËRHEQJE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME NË DEBITIM TË LLOGARISË SË KLIENTIT TË DEGËS

Regjistrimet kontabël në drejtorinë e përgjithshme:

D	K	Ditari (drejtoria e përgjithshme)
442		Llogari marrëdhëniesh - Dega A
	1111	Arka në lekë

Regjistrimet kontabël në degë:

D	K	Ditari (dega)
2711		Llogari rrjedhëse - individi
	441	Llogari marrëdhëniesh - drejtoria e përgjithshme

SEKSIONI 7: MJETET E QËNDRUESHME TË BANKËS

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 7 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. blerje;
2. amortizim dhe fond rezervë;
3. shitje.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

7.1. BLERJE

D	K	Ditari
5324		Mjete të trupëzuara - makineri e pajisje
	4211	Kreditorë të ndryshëm – furnitorë

7.2. AMORTIZIM DHE FOND REZERVË

Regjistrimet kontabël në lidhje me amortizimin vjetor të mjeteve të qëndrueshme janë:

D	K	Ditari
6412		Shpenzime amortizimi për mjetet e qëndrueshme
	537	Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme të përdorura për veprimtari

Regjistrimet kontabël në lidhje me zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme janë:

D	K	Ditari
648		Shpenzim amortizimi
	538	Fond rezervë për amortizimin e mjeteve të qëndrueshme

7.3. SHITJE

Në rast humbjeje:

D	K	Ditari
131		Llogari rrjedhëse në Bankën B
537		Amortizim i mjeteve të qëndrueshme të përdorura për veprimtari
6054		Humbje nga shitja e mjeteve të qëndrueshme
	5324	Mjete të trupëzuara - makineri e pajisje

Në rast fitimi:

D	K	Ditari
131		Llogari rrjedhëse në Bankën B
537		Amortizim i mjeteve të qëndrueshme të përdorura për veprimtari
	7054	Fitim nga shitja e mjeteve të qëndrueshme
	5324	Mjete të qëndrueshme - makineri e pajisje

SEKSIONI 8: LLOGARITË JASHTË BILANCIT

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 8 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. angazhime financimi të dhëna;
2. angazhime financimi të marra;
3. garanci e dhënë;
4. garanci e marrë.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

8.1. ANGAZHIME FINANCIMI TË DHËNA

D	K	Ditari
9011		Angazhime financimi të dhëna në favor të klientit
	90811	Angazhime financimi të dhëna në favor të klientit - llogaria kundërparti

8.2. ANGAZHIME FINANCIMI TË MARRA

D	K	Ditari
90822		Angazhime financimi të marra nga një klient - llogaria kundërparti
	9022	Angazhime financimi nga një klient

8.3. GARANCI E DHËNË

D	K	Ditari
9112		Garanci e dhënë në favor të një klienti
	91812	Garanci e dhënë në favor të një klienti - llogaria kundërparti

8.4. GARANCI E MARRË

D	K	Ditari
91822		Garanci e marrë nga një klient – llogaria kundërparti
	9122	Garanci e marrë nga një klient

SEKSIONI 9: FITIMI DHE HUMBJA

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Llogaria 578 (bilanci) balancohet nga llogaria 79 (fitimi i vitit ushtrimor) ose llogaria 69 (humbja e vitit ushtrimor).

Seksioni 9 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. shpërndarja e rezultatit në rast fitimi;
2. shpërndarja e rezultatit në rast humbjeje.

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

9.1. SHPËRNDARJA E REZULTATIT NË RAST FITIMI

D	K	Ditari
69		Fitimi i vitit ushtrimor
	578	Fitimi i vitit ushtrimor (bilanci)

Pasi aksionerët kanë miratuar shpërndarjen e fitimit:

D	K	Ditari
578		Fitimi i vitit ushtrimor (bilanci)
	577	Fitimet e pashpërndara
	5731	Rezerva ligjore
	4214	Dividentët për t'u paguar

9.2. SHPËRNDARJA NË RAST HUMBJEJE

D	K	Ditari
578		Humbja e vitit ushtrimor (bilanci)
	79	Humbja e vitit ushtrimor

Pasi aksionerët kanë miratuar shpërndarjen e deficitit:

D	K	Ditari
577		Fitimet e pashpërndara
	578	Humbja e vitit ushtrimor (bilanci)

SEKSIONI 10:NDIHMAT DHE DHURATAT NGA ORGANIZATAT PUBLIKE

A. *LISTA E VEPRIMEVE ELEMENTARE*

Seksioni 10 jep një listë të veprimeve elementare si më poshtë:

1. ndihmat e marra

B. *REGJISTRIMET KONTABËL*

10.1. NDIHMAT E MARRA

- Me shpërndarjen e ndihmës (për shembull, ndihma e përdorur për të blerë makineri dhe pajisje):

D	K	Ditari
1311		Llogari rrjedhëse e rezidentit
	541	Ndihmat

- Me blerjen e pajisjeve

D	K	Ditari
5324		Makineri dhe instrumente
	131	Llogaria rrjedhëse në banka

- Shuma e ndihmës së regjistruar si detyrim paraqitet si e ardhur gjatë periudhës së mbetur të dobishme të përdorimit të mjetit. Në mbyllje, regjistrimet kontabël për amortizimin e mjetit dhe të ndihmës janë si më poshtë:

D	K	Ditari
641		Shpenzime amortizimi
	537	Amortizim i mjeteve të qëndrueshme

D	K	Ditari
542		Pjesa e akumuluar e ndihmave dhe financimit publik të transferuar tek të ardhurat
	7055	Pjesa e ndihmave dhe e financimit publik të transferuar tek të ardhurat

- Me përfundimin e amortizimit të ndihmës, regjistrimet kontabël janë si më poshtë:

D	K	Ditari
541		Ndihma
	542	Pjesa e akumuluar e ndihmave dhe financimit publik të transferuar tek të ardhurat

PJESA 3: RAPORTET FINANCIARE

PJESA 3.1: RAPORTET FINANCIARE VJETORE
PJESA 3.2: RAPORTET FINANCIARE PERIODIKE

PJESA 3.1: RAPORTET FINANCIARE VJETORE

Shprehja "raporte financiare" nënkupton bilancet, pasqyrat e të ardhurave ose llogaritë e fitimit dhe humbjes, zërat jashtë bilancit, pasqyrat e fluksit të arkës, shënimet dhe pasqyrat e tjera si dhe njoftimin shpjegues i cili konsiderohet si pjesë e pasqyrave financiare. Zakonisht, raportet financiare vihen në dispozicion ose publikohen një herë në vit dhe janë objekt i raportit të kontrollorit.

Drejtuesit e një banke mund të përgatisin raporte financiare për përdorim të brendshëm në një sërë mënyrash të ndryshme të cilat ia përshtatin më së miri qëllimeve të brendshme të drejtimit. Kur raportet financiare përgatiten për persona të tjerë, siç janë aksionerët, kreditorët, punonjësit dhe publiku i gjerë, ato duhet të jenë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNK").

Drejtuesit e bankës kanë për detyrë të përgatisin raportet financiare dhe t'i raportojnë ato me informacion të mjaftueshëm. Detyra e kontrollorëve është të formojnë një mendim dhe të bëjnë një raport për pasqyrat financiare.

Përdoruesit e raporteve financiare të një banke kanë nevojë për informacionin e duhur, të besueshëm dhe të krahasueshëm i cili t'i ndihmojë ata në vlerësimin e gjendjes financiare dhe rezultatit financiar të bankës dhe i cili u vlen atyre në procesin e marrjes së vendimeve. Për pasojë, me qëllim që t'u krijohet një ide më e qartë për veprimtarinë e bankës, raportimi në pasqyrat financiare ka nevojë të jetë i plotë, aq sa duhet, brenda kufijve të asaj se çfarë është e arsyeshme për t'u kërkuar nga drejtuesit.

Kërkesa të përgjithshme për raportimin e pasqyrave financiare

Përdoruesit duhet të jenë të aftë të krahasojnë raportet financiare të një banke në kohë, me qëllim që të përcaktojnë tendencat në gjendjen dhe rezultatin financiar të saj. Për pasojë, është e rëndësishme që pasqyrat financiare të japin informacion që i korrespondon periudhës paraardhëse.

Duhet raportuar i gjithë informacioni material i cili është i nevojshëm për hartimin e pasqyrave financiare të qarta dhe të kuptueshme. Nëse është e nevojshme, sasitë dhe klasifikimet e zërave duhet të

plotësohen me informacion shtesë për të qartësuar kuptimin e tyre. Zëra të konsiderueshëm nuk duhen përfshirë në ose nuk duhen kompensuar kundrejt zërave të tjerë pa bërë një ndarje të veçantë. Zërat e konsiderueshëm të përfshirë në mjetet e tjera, detyrimet e tjera dhe në fondet rezervë specifike e përllogaritjet duhet të raportohen veçmas.

Një bankë është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit dhe ndaj rreziqeve që lindin nga ndryshimet e kursit të këmbimit, lëvizjeve në normën e interesit, ndryshimeve në çmimet e tregut dhe nga mospërmbushja e detyrimit prej të tretëve. Këto rreziqe mund të pasqyrohen në raportet financiare në formën e analizës së maturiteteve, analizës së mjeteve dhe detyrimeve në valutë të bankës etj., por përdoruesit arrijnë të kuptojnë më mirë nëse drejtuesit i bashkëngjisin dhe një relacion shpjegues raporteve financiare i cili përshkruan mënyrat se si administrohen dhe kontrollohen rreziqet që shoqërojnë veprimtarinë e bankës.

Një bankë duhet të raportojë sasinë totale të detyrimeve të siguruara dhe natyrën dhe vlerën kontabël të mjeteve të lëna peng si garanci.

Zakonisht banka vepron si një kujdestar dhe përfshihet në veprimtari të tjera besimi që rezultojnë lidhur me mbajtjen ose vendosjen e mjeteve (pasurive) në emër të individëve, trusteve, planeve të përfitimit të pensioneve dhe institucioneve të tjera. Pavarësisht se kujdestaria ose ndonjë marrëdhënie tjetër e ngjashme është e mbështetur ligjërisht, këto pasuri nuk janë pasuri të bankës dhe për pasojë, nuk përfshihen në bilanc. Megjithatë, sasitë e mbajtura në emër të palëve të treta duhen raportuar.

Banka duhet të raportojë çdo përqendrim të konsiderueshëm të mjeteve, detyrimeve (dhe, nëse është e nevojshme, zërat jashtë bilancit). Raportime të tilla duhet të bëhen nisur nga zona gjeografike, klientët ose grupet industriale ose nga përqendrime të tjera të rrezikut.

Gjithashtu, është e dëshirueshme që drejtuesit të japin edhe një relacion shpjegues për mjedisin ekonomik në të cilin vepron banka (për shembull, normat mesatare të interesit, normat e inflacionit për periudhën etj.).

Raportimet në pasqyrat financiare të bankës, në pjesën më të madhe bëhen sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit Nr. 30. SNK Nr. 32 plotëson SNK Nr.30, për sa kohë që bëhet fjalë për instrumentet financiare. Kjo pjesë jep një shembull të pasqyrave financiare vjetore me raportimet specifike të kërkuara nga këto standarde, në lidhje me bankat si edhe raportimin e përgjithshëm të kërkuar nga SNK të tjera.

BANKA XYZ

RAPORTET FINANCIARE
(SHEMBUJ ME SHPJEGIME)

PËR 31 DHJETOR, N DHE N-1

Përmbajtja

Bilancet
*Pasqyrat e të ardhurave **
Zërat jashtë bilancit
Pasqyrat e fluksit të arkës
Shënime për pasqyrat financiare

BANKA XYZ

Bilanci

	Llogaritë		31 dhjetor	
AKTIVET (në K-LEKË)	nr.	Shënim	N	N-1
Arkat dhe Banka Qendrore		4		
• Arka • Banka qendrore	111 1121në1124 1127, 1128			
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore	12-1214-1224	5		
Hua dhe paradhënie neto për inz kreditit		6		
• llogari rrjedhëse • depozita • hua • të tjera	13 14 15 18, 19			
Hua dhe paradhënie neto për klientët		7 dhe 9		
• llogari rrjedhëse • hua dhe paradhënie standarde • hua të pakthyera në afat • hua në ndjekje • hua nënstandarde • hua të dyshimta • hua të humbura • të tjera	27 20 21 22 23 24 25 28, 29			
Hua dhe paradhënie neto për Qeverinë Shqiptare dhe administratën publike	261, 262, 266, 267, 268, 269	8 dhe 9		
Letrat me vlerë		10		
• letra me vlerë me të ardhura të pandryshuara • letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme • të tjera	31 32 351, 361			
Letrat me vlerë dhe bono thesari të blera sipas marrëveshjes së riblerjes	1214, 153, 341(A)	10		
Interesat pjesëmarrës dhe filialet		11		
• Interesat pjesëmarrës • Filialet	51 52			
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve				
• Sigurimet shoqërore • Asistenca • Administrimi fiskal • Të tjera	431 432 434 433,437			
Mjetet e qëndrueshme (neto)		12		
• mjete të patrupëzuara • mjete të qëndrueshme në funksion të veprim • mjete të qëndrueshme të investimit • mjete të qëndrueshme për operacione qiraje • mjete të qëndrueshme në proces	531 532 533 534 535			
Mjete të tjera	41, 44, 45, 46			
Aktivet gjithsej				

BANKA XYZ

Bilanci

	Llogaritë		31 dhjetor	
DETYRIMET DHE KAPITALI AKSIONERËVE (në K-LEKË)	nr.	Shënime	N	N-1
Detyrimet ndaj bankës qendrore		4		
• llogari rrjedhëse • depozita të marra • huamarrje • të tjera	1121 1125 1126 1128			
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit jobanka qendrore		13		
• llogari rrjedhëse • depozita • huamarrje • të tjera	13 16 17 18			
Detyrimet ndaj klientëve		14		
• llogari rrjedhëse • llogari depozite • të tjera	271 272, 273 28			
Borxhi ndaj Qeverisë Shqiptare dhe organizatave publike	261, 263, 264, 265	8		
Letrat me vlerë dhe bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	1215, 342			
Borxh i përfaqësuar nga letrat me vlerë	33	15		
Ndihma dhe financim publik	54			
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve				
• sigurimet shoqërore • asistenca • administrimi fiskal • të tjera	431 432 434 433, 437			
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	55	16		
Borxh i varur	56			
Detyrime të tjera	42,44 45,46 35,36			
Detyrime gjithsej				
Kapitali i aksionerëve		17		
• kapitali • primet e aksioneve • rezervat • rezerva rivlerësimi • diferenca rivlerësimi • fitimet/humbjet e pashpërndara • fitimi (humbja)i vitit ushtrimor	571 572 573 5732 574 577 578			
Kapitali gjithsej i aksionerëve				
Pasive gjithsej				

Shih shënimet shoqëruese

BANKA XYZ
Pasqyra e të ardhurave

	Llogaritë		31 dhjetor	
PASQYRA E TË ARDHURAVE (në K-LEKË)	nr.	Shënime	N	N-1
Të ardhura nga interesat				
• për veprimet me thesarin dhe ndërbankare • për veprimet me klientët • interesa për letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjes së rishitjes • të tjera	7011 7012 7016 7019			
Shpenzime për interesat				
• për veprimet me thesarin dhe ndërbankare • për veprimet me klientët • interesa për letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes • për borxhet e përfaqësuara nga letrat me vlerë, borxhet e varura dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së rishitjes • të tjera	6011 6012 6016 6013, 6014, 6015 6017			
Të ardhura/Humbje neto nga interesat				
Të ardhura nga operacionet financiare				
• Të ardhura nga bonot e thesarit • Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë • Të tjera	7021 7022 7023 deri 7029			
Humbje nga operacionet financiare				
• Humbje nga bonot e thesarit • Humbje nga transaksionet me letrat e tjera me vlerë • Të tjera	6021 6022 6023 deri 6029			
Fitimi /Humbja neto nga veprimet financiare				
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë				
• Të ardhura nga operacionet e qirasë • Shpenzime për operacionet e qirasë	704 604			
Fitimi/Humbja neto nga komisionet				
• Të ardhura nga komisionet për veprimtarinë huadhënëse • Të ardhura nga komisionet për shërbimet bankare • Shpenzime për komisione për veprimtarinë huamarrëse • Shpenzime për komisione për shërbimet bankare	7031/2/5 7036 6031/2/3/4/5 6036			
Fitimi/Humbja neto nga veprimtaritë e tjera bankare				
• Të ardhura nga veprimtaritë e tjera bankare • Shpenzime nga veprimtaritë e tjera bankare	705 605			
Fitimi/Humbja neto nga veprimtaria valutore				
• Fitimi nga veprimtaria valutore • Humbja nga veprimtaria valutore	706 606			
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare				
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë				
• kosto e personelit • taksa përveç taksave mbi të ardhurat • shpenzime për shërbime të jashtme	61 62 63			
Të ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për fonde rezervë				
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	64 - 74			
Humbjet neto dhe shpenzimet për fondin rezervë për llogaritë e dyshimta, letrat me vlerë dhe zërat jashtë bilancit				
• Shpenzime/transferime neto për fondet rezervë statistikore • Shpenzime/transferime neto për fonde rezervë për huatë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura • Shpenzime/transferime neto për fonde rezervë për bonot e thesarit dhe letrave të tjera me vlerë të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore • Shpenzime/transferime neto për fonde rezervë për letrat me vlerë të ndryshme nga bonot e thesarit • Shpenzime/transferime neto për fonde rezervë për interesat pjesëmarrës dhe filialet • Shpenzime/transferime neto për fonde të tjera rezervë • Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	651-751 652-752 653-753 654-754 655-755 657-757 656			

Fitimi/Humbja neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme				
• të ardhura të jashtëzakonshme • shpenzime të jashtëzakonshme	76 66			
Taksat mbi të ardhurat	67			
Fitimi (Humbja) e vitit ushtrimor	69 ose (79)			

BANKA XYZ

Zërat jashtë bilancit

	Llogaritë		31 dhjetor	
ZËRAT JASHTË BILANCIT (në K-LEK)	nr.	Shënime	N	N-1
Angazhime të dhëna				
Angazhime financimi				
• Në favor të institucioneve të kreditit • Në favor të klientëve	9011 9012			
Garanci të dhëna				
• Në favor të institucioneve të kreditit • Në favor të klientëve	9111 9112			
Angazhime për letrat me vlerë				
• Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose rifinancim • Letra me vlerë për t'u marrë • Letra me vlerë të dhëna hua	924 922 926			
Angazhime të marra				
Angazhime financimi				
• Nga institucionet e kreditit • Nga klientët	9021 9022			
Garanci të marra				
• Nga institucionet e kreditit • Nga klientët	9121 9122			
Angazhime për letrat me vlerë				
• Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose rifinancim • Letra me vlerë për t'u dhënë • Letra me vlerë të marra hua	923 921 925			
Veprimet valutore				
• Monedha të blera me afat • Monedha të shitura me afat • Shuma në lekë për t'u marrë kundrejt shitjes së valutave • Shuma në lekë për t'u dhënë kundrejt blerjes së valutave • Llogaria e vlerësimit të veprimeve valutore me afat	931 932 933 934 935			
Angazhime të tjera				
• të dyshimta • të tjera	941 942			
Angazhime sipas instrumenteve financiare				
• të marra • të dhëna	951 952			

BANKA XYZ

Pasqyrat e flukseve të arkës

	Llogaritë		31 dhjetor	
PASQYRAT E FLUKSEVE TË ARKËS (në K-LEKË)	nr.	Shënime	N	N-1
Aktivitete të veprimtarisë së përditshme				
Fitimi (Humbja) i vitit ushtrimor	69 (79)			
• (Rritje në interesat për t'u arkëtuar)	(i)			
• Rritje në interesat për t'u paguar	(ii)			
• Fonde rezervë	65-656			
• (Transferim nga fondet rezervë)	74+75			
• Amortizimi	64			
• Fitimi nga shitja e mjeteve të qëndrueshme	7054			
• Efekti i zërave të tjerë të përllogaritur dhe të shtyrë	419, 429			
Fluksi hyrës neto në para nga aktivitetet e veprimtarisë së përditshme (A)				
Rritja (rënia) në bonot e thesarit dhe bonot e tjera të përshtatshme për rifinancim me bankën qendrore	12			
Rritja (rënia) në huatë dhe paradhëniet për institucionet e kreditit	13(A),14, 15, 18(A), 19,			
Rritja (rënia) në huatë dhe paradhëniet për klientët	27(A), 20 deri 25, 28(A), 29			
Rritja (rënia) në huatë dhe paradhëniet për Qeverinë Shqiptare dhe organizatat publike	26			
Rritja (rënia) në letrat me vlerë të tregtueshme dhe letrat me vlerë të vendosjes	311, 312, 32, 34(A), 35(A), 36(A)			
Rritja (rënia) në mjetet e tjera	41, 43(A), 44(A), 45(A), 46(A)			
(Rritja) rënia në detyrimin ndaj institucioneve të kreditit	13(P), 16, 17, 18(P)			
(Rritja) rënia në detyrimin ndaj klientëve	271(P), 272, 273, 28			
(Rritja) rënia në borxhet e përfaqësuara nga letrat me vlerë	33, 34(P), 35(P), 36(P)			
(Rritja) rënia në detyrimet e tjera	42, 44(P), 45(P), 46(P), 35(P), 36(P)			
(Rritja) rënia në ndihmat dhe financimin publik	54			
(Rritja) rënia në borxhin e varur	56			
Fluksi neto hyrës i arkës nga aktivitetet e veprimtarisë së përditshme (B) [= (A) +/- ...]				
Taksimi				
• Pagimi i taksave mbi të ardhurat	67			
Veprimtaritë investuese				
• (Blerja e letrave me vlerë të investimit)	313, 1213			
• (Blerja e interesave pjesëmarrëse dhe filialeve)	511, 521			
• Shitje e letrave me vlerë të investimit	313, 1213			
• Shitje e interesave pjesëmarrës dhe filialeve	511, 521,			
• Dividentët e marrë	7023, 7024,			
• Blerje të mjeteve të qëndrueshme	53-537			
• Shitje e mjeteve të qëndrueshme	53-537			
Fluksi hyrës neto i arkës përpara financimit (C) [= (B) +/- .....]				
Veprimtaritë e financimit				
(emetimi i aksioneve të reja të zakonshme) dividentët e paguar	571			
Fluksi dalës neto i arkës nga veprimtaritë e financimit (D) [(c) +/- ...]				
Rritja neto e arkës dhe gjendjeve në bankat qendrore				

Arka dhe bankat qendrore në fillim të vitit	111, 1121(A) deri 1124(A), 1127(A), 1128			
Arka dhe banka qendrore në fund të vitit	111, 1121(A) deri 1124(A), 1127(A), 1128			

(i) Llogaritë e interesave për t'u arkëtuar i korrespondojnë llogarive të interesave të përllogaritur, të klasifikuar si aktive (A) siç janë 11219, 11229, 11239, 11259, 11269, 12129 etj..

(ii)Llogaritë e interesave për t'u paguar i korrespondojnë llogarive të interesave të përllogaritur, të klasifikuar si pasive (P) siç janë 11219, 11259, 11269, 12159, 1319, 1329 etj..

BANKA XYZ
SHËNIME PËR RAPORTET FINANCIARE

31 dhjetor, N dhe N-1

1. Përshkrimi i veprimtarisë

Duhet thënë emri i bankës, vendi i licencimit, data e përgatitjes së bilancit dhe periudha që pasqyrojnë raportet financiare. Gjithashtu, duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i natyrës së veprimtarisë së bankës dhe monedhat me të cilat janë hartuar raportet financiare, nëse një gjë e tillë nuk kuptohet. Për shembull:

Banka XYZ ("Banka") është regjistruar me numër XX në Bankën e Shqipërisë si kompani aksionere e tipit të mbyllur më (data e regjistrimit). Bankës i është dhënë licenca më (data e licencës). Më (data e regjistrimit), Banka është regjistruar në Bankën e Shqipërisë si kompani aksionere e llojit të hapur . Banka është një bankë tregtare që i shërben ndërmarrjeve shtetërore, ndërmarrjeve private dhe individëve. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës është në Tiranë dhe ka 10 degë të lokalizuara në rajonin e Tiranës.

Banka jep hua për klientët dhe pranon depozita nga personat juridikë dhe fizikë të lokalizuar së pari në Tiranë dhe rajonin e saj.

2. Baza e përgatitjes

Me qëllim që të krijojnë një ide të përgjithshme, përdoruesit e raporteve financiare kanë nevojë të sigurojnë informacion mbi standardet kontabël të përdorura për përgatitjen e raporteve financiare. Për pasojë, shënimet për raportet financiare përgjithësisht jepen duke treguar rregullat, të cilët drejtojnë standardet kontabël të zbatuara, siç janë SNK ose Standardet Kontabël Shqiptare. Kur raportohen raportet financiare duhet të jepet qartë çdo devijim nga standardet kontabël të zbatuara nga banka. Për shembull:

Banka mban regjistrimet e saj dhe përgatit pasqyrat e saj financiare në Lekun Shqiptar, në përputhje me kontabilitetin shqiptar dhe legjislacionin taksor. Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur për të dhënë gjendjen financiare, rezultatet e veprimeve dhe fluksin e arkës në përputhje me SNK, me përjashtim të atyre zërave të trajtuar në paragrafët e mëposhtëm.

Aktualisht Shqipëria po përjeton nivele të larta inflacioni. Sipas SNK Nr. 29, "Raportimi financiar në ekonomitë me inflacion të lartë", raportet financiare duhen rregulluar për të pasqyruar efektet e rënies së fuqisë blerëse të lekut. Këto rregullime nuk janë bërë. Raportet financiare janë përgatitur sipas kostos historike, të modifikuara për të pasqyruar rivlerësimin e mjeteve të qëndrueshme. Sipas statistikave

zyrtare të qeverisë, inflacioni i përgjithshëm i çmimit për periudhat N dhe N-1 ishte përkatësisht XX% dhe XX%.

BANKA XYZ
SHËNIME PËR RAPORTET FINANCIARE

3. Përmbledhje e parimeve kontabël më të spikatura (vazhdim)

Politikat kontabël përfshijnë parimet, bazat, konventat, rregullat dhe procedurat e zbatuara nga drejtuesit në përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve financiare. Politikat më të spikatura kontabël të përdorura nga banka janë një pjesë përbërëse e raporteve financiare dhe duhet të raportohen për të kuptuar më mirë shifrat e paraqitura në bilanc dhe pasqyrën e të ardhurave.

Nuk ka një listë të vetme të politikave të pranuara të cilave duhet t'i referohen përdoruesit dhe politikat e ndryshme kontabël, që janë aktualisht në dispozicion për t'u zbatuar mund të krijojnë raporte financiare me pamje që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, pavarësisht se bazohen në të njëjtat ngjarje dhe kushte.

Më poshtë paraqiten shembuj të fushave në të cilat ekzistojnë politikat kontabël dhe për pasojë, kërkojnë raportim në lidhje me trajtimin e përdorur:

- *regjistrimi i llojeve kryesore të të ardhurave,*
- *vlerësimi i investimeve dhe letrave me vlerë,*
- *dallimi midis atyre transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera që rezultojnë në regjistrimin e mjeteve dhe detyrimeve dhe ngjarjeve të tjera, të cilat vetëm sa krijojnë angazhime dhe elemente të paparashikueshme,*
- *baza për përcaktimin e humbjeve nga huatë dhe paradhëniet dhe për fshirjen e huave dhe paradhënieve të paarkëtueshme nga bilanci,*
- *baza për përcaktimin e shpenzimeve për rreziqet e përgjithshme nga veprimtaria bankare dhe trajtimi kontabël i shpenzimeve të tilla,*
- *qëllimi i përmbledhjes së të dhënave (konsolidimi) dhe politika,*
- *amortizimi dhe zhvlerësimi i mjeteve të qëndrueshme dhe mjeteve të trupëzuara, në veçanti duke u bazuar në periudhën e tyre të përdorimit,*
- *rivlerësimi i mjeteve të qëndrueshme,*
- *konvertimi ose kthimi i zërave të mjeteve/detyrimeve dhe të ardhurave/shpenzimeve në valuta të huaja duke përfshirë sistemimin e fitimeve ose humbjeve nga këmbimet,*
- *qiratë,*
- *taksat mbi të ardhurat,*

- *ndihmat e dhëna nga qeveritë ose organizmat e tjerë ndërkombëtarë ose publikë,*
- *veprimet e mbrojtjes ose të tregtimit me instrumentet financiare,*
- *planet e pensionit dhe përfitimet e tjera në këtë fushë.*

Çdo ndryshim në politikat kontabël i zbatuar nga banka gjatë periudhës, duhet të raportohet duke treguar dhe ndikimin përkatës të tyre në raportet financiare.

BANKA XYZ
SHËNIME PËR RAPORTET FINANCIARE

3. Përmbledhje e parimeve kontabël më të spikatura (vazhdim)

Shembuj të raportimit të politikave kontabël:

Konvertimi i valutave

Mjetet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj konvertohen me kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë përkatësisht për 31 dhjetor, N (usd 1 = lekë XX) dhe N-1 (usd 1 = lekë XX). Transaksionet në valutë regjistrohen me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga konvertimi dhe diferencat e kurseve përfshihen në raportet shoqëruese të të ardhurave.

Aksionet në valutë janë përfshirë në raportet financiare shoqëruese me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e emetimit.

Mjetet e qëndrueshme të blera në valutë konvertohen me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e blerjes.

Leku nuk është monedhë e konvertueshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Brenda saj kurset zyrtare të këmbimit përcaktohen parimisht nëpërmjet tregtimit në (*emri i vendit të këmbimit*). Ndikimi i zhvlerësimit të Lekut në mjetet dhe detyrimet monetare neto nuk është përcaktuar. Struktura e mjeteve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor N dhe 31 dhjetor N - 1, midis lekut shqiptar dhe monedhës së huaj paraqitet në shënimin 20.

Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme mbahen kryesisht për qëllime të investimit afatshkurtër dhe raportohen me vlerën e tregut dhe çdo ndryshim në vlerë gjatë periudhës pasqyrohet në pasqyrat e të ardhurave si një rregullim (korrektim) i të ardhurave nga interesat.

Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes mbahen për qëllime të investimit afatshkurtër dhe afatmesëm dhe raportohen me koston ose vlerën e tregut më të ulët.

BANKA XYZ
SHËNIME PËR RAPORTET FINANCIARE

3. Përmbledhje e parimeve kontabël më të spikatura (vazhdim)

Letrat me vlerë të investimit
Letrat me vlerë të investimit barten në bilanc me kosto. Fondi rezervë për letrat me vlerë të investimit krijohet për të mbuluar rrezikun e mospërmbushjes së detyrimit nga ana e emetuesit të letrave me vlerë.

Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë

Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë bazohen në vlerësimin e fundit të vitit nga ana e drejtuesve për tepricën e huave dhe përfaqësojnë shumat e vlerësuara në datën e përgatitjes së bilancit të humbjeve të mundshme që mund të pësohen. Fondet rezervë përfshijnë vlerësimet në lidhje me humbjet e mundshme nga huatë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura.

Huatë kalojnë në gjendjen kur nuk u llogaritet interesi kur vihet në dyshim arkëtueshmëria e plotë e kryegjësë ose e interesit. Interesat që janë përllogaritur më parë por nuk janë arkëtuar stornohen dhe ndërpritet procesi i përllogaritjes së mëtejshme të interesave dhe regjistrimit të tyre si të ardhura nga interesat.

Fonde rezervë për rreziqet dhe shpenzimet.

Fondet rezervë për rreziqet statistikore nga huatë bazohen në informacionin statistikor nga vitet paraardhëse në lidhje me humbjet nga huatë standarde dhe në ndjekje.
Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga angazhimet dhe elementet e paparashikuara, përfaqësojnë vlerësimin e bërë për të mbuluar humbjet e mundshme nga garancitë e dhëna.

Interesa pjesëmarrës dhe filialet

Interesat pjesëmarrës dhe filialet raportohen në raportet financiare shoqëruese me koston ose vlerën reale më të ulët.

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara që përdoren për veprimet e

